

Gusht 2019
Numri: 137
E përnuajshme

Revistë edukative-kulturore - www.revistaetika.com

ETIKA

Shqipëri: 200 Lekë
Kosovë: 1.5 Euro
Maqedoni: 90 Den
Evropë: 7 Euro

RRUGA PËR NË MEKË



revistaetika



progresibotime



BASHKËSIA ISLAME E KOSOVËS
Këshilli i Bashkësisë Islame në Gjakovë
dhe
SHOQATA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE
DHE KULTURORE E STAMBOLLIT



KONKURS

Medreseja e Madhe në Gjakovë është qendër e cila mundëson krahas mësimëve obligative të shkolles fillore, të vazhdoj mësimet për memorizimin e Kur'anit.

- Në vitin e parë, leximi i Kur'anit dhe përgaditje për memorizimin e Kur'anit.
- Në vitin e dytë dhe të tretë vazhdon mësimin e Kur'anit përmendësh.

APLIKIMI:
TË JETË NË KLASËN 5, 6, 7.



Shkollimi është FALAS!

Info:
049 284 123 dhe 044 586 330

Hafizat e Kosovës 

Afati i regjistrimit është prej datës 01 Korrik - 1 Shtator
Përparësi do të kenë ata të cilët kanë sukses të lartë, pastaj sipas rradhës së aplikimit.

O njerëz, frikësojuni Zotit dhe respektojeni atë, bëhuni të njerëzishëm dhe të drejtë ndaj vetes dhe ndaj të tjerëve. Kjo është dita e fljimeve në emër të Allahut. Vërtet gjaku juaj, nderi juaj dhe pasuria juaj janë të shenjta për ju, derisa të takoheni me Krijuesin tuaj...

Ruani, respektoni dhe nderoni vlerën e perso - nalitetit dhe të dinjitetit njerëzor.

Njeriu është vepër madhështore e Allahut dhe mjerë për atë, që e përçmon nderin dhe dinjitetin e veprës së Allahut.

O njerëz, ju pashmangshëm do t'i ktheheni Allahut të Amshueshëm dhe Ai do t'ju thërrasë në përgjigjësi për veprat dhe punën tuaj.

O besimdrejtë, dijeni se ka përfunduar koha e mosdijes dhe e traditave të këqija, të cilat i kanë sjellë aq fatkeqësi gjinisë njerëzore. Unë jua kam treguar rrugën e shpëtimit, në të cilën duhet ecur.

Sendet që u janë lënë amanet ruani si tuajat dhe kthejani ato besnikërisht dhe me kohë atij që i përkasin.

Gjakmarrja është e ndaluar...

Fajdeja dhe kamata janë të ndaluara...

O besimdrejtë! O njerëz! Frikësojuni Ditës, e cila vërtet do të vijë, kur të gjithë do të paraqiteni para Allahut, Gjykatësit të Vetëm Suprem, (ditën) në të cilën ju pret drejtësia absolute!

O ju që do të vdisni! Duajeni dhe dëgjojeni Zotin, Krijuesin e materies dhe jo-materies, i Cili krijoi mashkullin dhe femrën, prej të cilëve u zhvillua e tërë gjinia njerëzore!

Frikësojuni Allahut, me ndihmën, prehjen dhe mëshirën e të Cilit të gjithë jemi udhëzuar! Ne jemi të vdekatarë...

Respektojeni faqet tuaja! Përbushni detyrat dhe obligimet, të cilat ekzistojnë ndërmjet burrit dhe gruas si dhe ndërmjet prindërve dhe fëmijëve!

Xheneti është nën këmbët e nënës.

Ruajuni nga prostitucioni, tradhtia bashkëshortore dhe xhelozia. Prostitucioni dhe tradhtia bashkëshortore janë mëkat i rëndë, ndërsa xhelozia shpie kah përçarja në martesë.

O besimdrejtë, qëndroni larg ngatërresave dhe përgojimit!

Le të jenë të mallkuar në të dy botërat ata që u bëjnë shpifje grave të ndershme!

Nëse ndjeni se ndaj grave tuaja ju është dobësuar dashuria, mos nxitoni (në shkurorëzim), por mendoni mirë, sepse Allahu nëpërmjet këtij sprovimi ju udhëzon në rrugët e fatit të ri dhe të madh, me të cilin dëshiron t'ju përgëzojë. Mos kërkonte shkurorëzim pa shkaqe të arsyeshme, sepse prej të gjitha gjërave që Allahu ka lejuar, më së tepërmi urren shkurorëzimin.

O besimdrejtë, kur e caktoni dhe e ndani ndërmjet vetes trashëgiminë, bëhuni të drejtë dhe përbahuni Librit të Zotit. Ruajeni pasurinë e të miturve e të paafteve!

Fëmija i takon atij, në shtratin e të cilit është lindur.

Kush pohon se i takon tjetërkujt përveç prindit, atë do ta zërë mallkimi i Zotit.

Nuk i lejohet gruas të japë diçka nga pasuria e burrit të vet pa lejen e tij.

Borxhi duhet paguar, ndërsa sendi i huazuar duhet kthyer. Dhuratat duhet kthyer me dhuratë. Kush hyn dorëzanë për dikë, obligohet me përgjegjësi për dorëzani.

O besimdrejtë, dijeni dhe mos harroni se të gjithë myslimanët janë vëllezër. Ju jeni plotësisht të barabartë në të drejta dhe detyra. Arabi ndaj joarabit nuk ka kurrfarë përparësie, e kjo vlen edhe për të ziun ndaj të kuqit dhe për të kuqin ndaj të ziut, përveç në devotshmëri. Të gjithë ju jeni pasardhës të Ademit, ndërsa Ademi e ka prejardhjen nga dheu.

O myslimanë, kujdesuni, duajuni dhe ndihmohuni mes veti!

Islami dhe interesi i përgjithshëm le të jetë mbi ju dhe mbi interesin tuaj! Përkushtojani Islamit jetën tuaj...

Gusht 2019

VITI: XIII

NUMRI: 137

BOTUESI

Shtëpia botuese "Progresi"

DREJTOR

Albert Halili

KRYEREDAKTOR

Alban Kali

REDAKTOR

Zija Vukaj

PËRKTHYES

Albert Halili

Fatmir Sulaj

Ilir Hoxha

DIZAJN

Bledar Xama

ADRESA

Rr: Studenti; Sheshi "2 Prilli"

Shkodër; Shqipëri

MOBILE

+355 67 340 6182

E-MAIL

rev.etika@gmail.com

WEBSITE

www.progresibotime.com

KOSOVË

Rr: Ardian Zurnaxhiu; pn. Ralin

Prizren; Kosovë

Mob: +377 45 639 143

Prishtinë; Kosovë

Mob: +377 44 566 577

MAQEDONI

Drvarska 28; Stara Carsija

Skopje; Makedonija

Mob: +389 7145 6003

ABONIMI VJETOR

Shqipëri: 2000 lekë

Kosovë: 15 Euro

Maqedoni: 900 Denar

Evropë: 80 Euro

Ju bëjmë të ditur se materialet e sjella në redaksi pavarësisht nëse botohen apo jo nuk i kthehen autorit. Koha e botimit të një materiali përcaktohet nga redaksia. Honoraret e shkrimeve autoriale ose përkthimeve duhet të vini t'i tërhiqni pranë Shtëpisë Botuese "Progresi" ose pranë zyrate të përfaqësimit në Kosovë dhe Maqedoni.

Përmbajtja



18



10

Amaneti dhe tradhëtia
Ali Riza Temel




Udhëtimi i përjetësisë
Osman Nuri Topbash

34



12



24

**Mos u përpiq ta mbash këtë botë mbi supe,
nuk mund ta mbash!**
As. doç. dr. Abdullah Ajgyn

**5 Sikur po dëgjojmë Resulullahun
në Arafat...**

Ahmet Tashgetiren

8 Dëgjuam dhe u bindëm!

Doç. dr. Adem Ergyl

12 Punë copa-copa

Nuredin Jëlldëz

14 Puna është ibadet

Fejza Arpat

15 Paralajmërimi që të plas zemrën

Xhemal Nar

16 Pika ku duhet të përkushtohemi


Idris Arpat

20 Një udhëtim me Sheherazaden

Nuredin Nazarko

22 Surja Nisa

Xhafer Durmush



50

Ukbe Ibn Amri 26
Mustafa Erish
Ndeshmëria ndaj hallallit dhe haramit 28
B. Xhahit
Mbi librin "Njeriu - kjo genie e panjohur" 30
Edison Çeraj
Dashuria e lulesh për ujin 31
Ferudun Ozdemir
Një Ajet-Një Hadith 32

El-Gafur 42
Ilir Hoxha
Altruizmi 44
Sami Gëksyn
Kënaqësia e Zotit mbi çdo gjë tjetër 46
Ferit Piku
**Të rinjtë ngushëllohen me ëndrra,
të moshuarit me kujtime** 50
Elif Menxhet



**Feja dhe shoqëria
nga pikëpamja e sociologjisë së fesë**
Mr. Fatmir Hadri

Televizorët dhe të vetmuarit
Tuba Sekmen

48



Sikur po dëgjojmë Resulullahun në Arafat...

— Ahmet Tashgetiren —

Ishte viti i dhjetë i hixhretit, dita e 9-të e Dhul-hixhes, pra dita e Arafatit. 8 marsi i vitit 632 e.s. Islami kishte 23 vjet që po predikohej. 124 mijë sahabë gjendeshin prezentë në Arafat. I Dërguari i Allahut, (a.s.), u fliste myslimanëve me shprehje si: “Ndoshta këtej e tutje nuk do të takohem më me ju.” Domethënë, në zemër kishte filluar të ndjente flladet e “Lamtumirës”.

Sa ishte i plotë numri i njerëzve që atë ditë u kishte arritur thirrja e të Dërguarit të Allahut, (a.s.)? Mos vallë ky numër ishte vetëm 124 mijë? Këtë nuk e dimë. Le të themi se përafërsisht ka qenë aq.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), kërkon që fjalët e tij të arrijnë te çdo besimtar duke u shprehur: “Ata që gjenden këtu, le t’ua thonë atyre që nuk gjenden.” “Allahu e mëshiroftë dhe ia ndriçoftë fytyrën atij që i dëgjon fjalët e mia, i mëson përmendsh dhe ua transmeton njerëzve të tjerë!” Domethënë, Pejgamberi (a.s.), i thoshte këto fraza si një amanet që duhej mbartur te zemrat e tjera.

Kur flet Kurani Fisnik, flet për të gjitha kohërat. Kur flet i Dërguari i Allahut, (a.s.), flet për të gjitha kohërat. Nëse i Dërguari i Allahut, (a.s.), shprehet veçanërisht në formë amaneti të mbushur plot me ndjenjën e “Lamtumirës”, ajo fjalë duhet t’u transmetohet zemrave të të gjitha kohëve.

Tekstet që ne i njohim si “Hythja e Lamtumirës”, përbëhen nga fjalimet e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në Arafat dhe Mina. Ekzistojnë edhe tekste që vende-vende kanë disa ndryshime, por që mbartin të njëjtin kuptim. Tashmë këtu dëshirojmë të japim një pjesë prej këtyre teksteve, të cilat u drejtohen zemrave tona.

Prandaj le të supozojmë se gjendemi në Arafat dhe Mina... I Dërguari i Allahut, alejhi’s-salam, po na flet dhe ne po e dëgjojmë.

Çfarë do të bënim në një situatë të tillë? A nuk do ta rishikonim gjendjen tonë? A nuk do ta merr-

nim veten në llogari duke e pyetur: “A përputhet karakteri ynë me ‘kornizën e myslimanizmit’ që ka përcaktuar i Dërguari i Allahut, (a.s.)? Për këtë arsye, ejani ta mbartim në zemrat tona zërin e bekuar të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në mënyrë që t’i bashkëngjitemi karvanit të atyre “që do t’u ndriçojnë fytyrat”.

Ja korniza e drejtësisë që është e vlefshme për të gjitha kohërat:

“O njerëz! Dëgjojeni mirë fjalën time! Siç janë të shenjtat këto ditë, siç janë të shenjtë këto muaj, siç është i shenjtë ky qytet (Meka), kështu janë të shenjtat edhe jeta, pasuria dhe nderi juaj. Ato janë të mbrojtura nga çdo lloj dhunimi.”

Ja zëri i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), që i mbron besimtarët e të gjitha kohëve kundrejt devijimit dhe luftës civile:

“Sahabët e mi! Patjetër që do të shkoni te Zoti. Ai do t’ju marrë në llogari për veprat që keni bërë. Bëni kujdes dhe mos u ktheni në devijimet e vjetra dhe mos e vrisni njëri-tjetrin!”

Ja vendosmëria e Pejgamberit në lidhje me çështjen e kamatës, e cila është fatkeqësia e të gjitha kohëve:

“Dijeni se çdo lloj i kamatës është i ndaluar. Kështu ka vendosur Allahu, por paratë jashtë kamatës janë tuajat. As mos bëni padrejtësi, as mos e pranoni padrejtësinë.”

Ja paralajmërimi i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), në lidhje me dredhitë e pafundme të shejtanit, i cili është “armiku i njeriut”:

“O njerëz! Shejtani në këto toka tuajat e ka prerë shpresën se mund ta adhuroni, veçanërisht nga ata që falin namaz. Por përveç kësaj, ai do të jetë i kënaqur që t’i bindeni në sjelljet që i konsideroni si të vogla. Ai do të përpiket t’ju ngatërrojë dhe t’ju prishë marrëdhëniet. Atëherë mbrojeni fenë nga vepërimet e gabuara që i konsideroni të vogla!”

Rregulli në marrëdhëniet burrë-grua. Kjo është një çështje që ka pasur probleme në të gjitha kohët. Kur i Dërguari i Allahut, (a.s.), e ka vendosur këtë rregull, i ka cilësuar ato (gratë) si “amaneti i Allahut” dhe ka kërkuar “që të sillemi me to duke pasur frikë nga Allahu”... Prandaj duhet ta dëgjojmë dhe t’ua vëmë veshin këtyre fjalëve:

“O njerëz! Ju këshilloj që t’i respektoni të drejtat e grave dhe ta keni frikë Allahun në këtë çështje. Ju i keni marrë gratë si amanet i Allahut dhe e keni bërë hallall nderin e tyre me urdhrin e Allahut. Ju keni të drejta ndaj grave, por edhe gratë kanë të drejta ndaj jush.”

Nëse personalitetet tona do t’i formonim në bazë të kësaj kornize që ka caktuar i Dërguari i Allahut, (a.s.), edhe bota islame, edhe pjesa tjetër e njerëzimit, do të ishte në një gjendje krejt tjetër:

“A t’ju tregoj se kush është mysliman i vërtetë? Myslman i vërtetë është ai, prej gjuhës dhe dorës së të cilit janë të sigurt njerëzit e tjerë. A t’ju tregoj se kush është edhe besimtar i vërtetë? Besimtar i vërtetë është ai që njerëzit i besojnë në çështjen e pasurisë dhe jetës së tyre. A t’ju tregoj se kush është muhaxhir? Muhaxhir i vërtetë është ai që i lë gabimet dhe mëkatet. Ndërsa muxhahid i vërtetë është ai që lufton me nefsën për t’ju bindur Allahut.”

Ja parimet e drejtësisë universale për të cilat i Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka njoftuar para shumë shekujsh:

“Dëgjojini mirë fjalët e mia, në mënyrë që të jetoni në paqe me nder e krenari.

-Mos bëni padrejtësi! Mos bëni padrejtësi! Mos bëni padrejtësi!

-Mua mos më flisni për prejardhjet tuaja, por për veprat e mira tuaja.

-Armiku më i madh i Allahut është ai që e vret dikë pa ndonjë arsye ndërkohë që ai (i vrari) nuk ka pasur qëllim të keq, dhe ai që godet dikë ndërkohë që ai (i godituri) nuk e ka goditur.

-O njerëz! Secili prej jush do të ndëshkohet vetëm për shkak të fajit që ka bërë vetë. Fëmija nuk mund të ndëshkohet për atë që ka bërë babai. As babai nuk mund të ndëshkohet për atë që ka bërë fëmija.”

Ja qëndrimi i të Dërguarit të Allahut, (a.s.), kundrejt tentativave për të formuar standarde të dyfishta:

“O njerëz! Ndërrimi i muajve të shenjtë sipas dëshirës është vetëm mohim edhe më i madh i fesë. Mohuesit e fesë kështu deviojnë krejtësisht. Ata e konsiderojnë një vit hallall dhe një vit haram për ta ekuilibruar me numrin që Allahu e ka bërë haram. Në këtë mënyrë, e konsiderojnë hallall atë që Allahu

e ka bërë haram. Gjithashtu e konsiderojnë haram edhe atë që Allahu e ka bërë hallall. Tashmë koha (ky vit) është kthyer në gjendjen e vërtetë, si në ditën kur Allahu ka krijuar qiejt dhe tokën (këtë e tutje nuk do të ndryshohen). Në ditën kur Allahu ka krijuar qiejt dhe tokën, sipas caktimit të Tij, numri i muajve të Ai ka qenë dymbëdhjetë. Katër prej këtyre janë haram.”

Korniza e vëllazërisë që ka caktuar i Dërguari i Allahut, (a.s.)

“O njerëz! Besimtarët janë vëllazër. Askush nuk e ka hallall pasurinë e vëllait, pa pasur aprovimin e tij. O njerëz! Toka i përket Allahut dhe të Dërguarit të Tij. Unë jam urdhëruar që të luftoj me njerëzit derisa të thonë la ilahe il-lall-llah. Pasi ta thonë këtë fjalë të tevhidit, e kanë të mbrojtur gjakun dhe pasurinë e tyre. Ndërsa llogaria e tyre i përket Allahut. Mos i bëni padrejtësi njëri-tjetrit. Mos u ktheni në mohues të fesë pasi unë të mos jem më mes jush. Kini kujdes dhe mos u bëni si qafirët që vrasin njëri-tjetrin.”

Udhëzuesi i përhershëm që është vënë para nesh dhe me të cilin nuk do të deviojmë nëse e zbatojmë:

“Juve po ju lë diçka që, nëse kapeni fort pas saj nuk do të devijoni asnjëherë: Libri i Allahut dhe Suneti i të Dërguarit të Tij. Punoni me këto! Edhe Ehli Bejtin po jua lë amanet ju.”

Udhërrëfyeni njerëzor i pagabueshëm që mund t’ia shfaqim njerëzimit ne si besimtarë:



“O njerëz! Zoti juaj është një. Babai juaj është një. Njerëzit në Islam janë të barabartë. Të gjithë jeni fëmijët e Ademit. Ndërsa Ademi është prej dheut. Allahu Teala thotë: **“O njerëz! Me të vërtetë Ne ju kemi krijuar nga një mashkull dhe një femër. Ju kemi ndarë në popuj dhe fise, në mënyrë që të njiheni me njëri-tjetrin. Patjetër që më i mirë te Allahu prej jush është më i devotshmi prej jush...”** Arabi nuk ka ndonjë epërsi kundrejt joarabit, edhe i ziu nuk ka ndonjë epërsi kundrejt të bardhit, as i bardhi nuk ka ndonjë epërsi kundrejt të ziut, përveçse devotshmërisë. O xhemati i Kurejshve! Mos ejani me dynjanë të ngarkuar në qafat tuaja kur të vij në njerëzit Ditën e Gjykimit, sepse unë nuk mund t’ju mbroj kundrejt asnjë gjëje që mund t’ju vijë nga Allahu.

Ka tri cilësi, të cilat përderisa të gjenden në zemrën e besimtarit, ajo nuk ndjen urrejtje dhe armiqësi: Kryerja e veprës me shqetësim për hir të Allahut, të dëshiruarit e mirësisë për udhëheqësit myslimanë dhe vazhdimësia në xhematin e myslimanëve, sepse lutjet e myslimanëve i përfshijnë dhe i mbrojnë të gjithë ata që gjenden aty.”

Edhe marrëdhënien e drejtpërdrejtë me fenë e cakton i Dërguarit të Allahut, (a.s.):

“O njerëz! Kini kujdes nga ekstremizmi në fe. Ata që ishin para jush i ka shkatërruar ekstremizmi në fe.”

I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka caktuar parimin



kryesor në udhëheqje:

“O njerëz! Edhe nëse do të keni një udhëheqës nga Abisinia me hundë të prerë, dëgjojeni dhe bindjuni, përderisa të zbatojë librin e Allahut!”

E drejta e skllavit – E drejta e njeriut

“Aman respektojini të drejtat e skllavëve dhe mbrojtini ata (skllavërit)! Jepuni për të ngrënë prej atyre që hani vetë dhe jepuni për të veshur prej atyre që vishni vetë. Kur të bëjnë ndonjë faj që nuk mund t’ua falni, shitini. O robërit e Allahut, mos u bëni tortura atyre!”

Edhe pse ishte Pejgamberi ai që po dilte në Udhëtimin e Përhershëm...

I Dërguari i Allahut, (a.s.), pothuajse në fund të çdo fjalie, në formë dispozite thoshte: “Bëni kujdes! A ua predikova? O Allah, ji dëshmitar!” Gjithashtu pyeste: “Nesër do t’ju pyesin për mua. Çfarë do të thonin?” Ky ishte një “dokument garancie” që do ta çonte në audiencën Hyjnore kur të ndahej nga kjo botë dhe të dilte në udhëtimin e përhershëm ky njeri që mbartte mbi supe amanetin e “profecisë”, të cilin ia kishte dhënë Allahu (xh.sh.). Këtë e bën një njeri që Allahu Teala e ka lartësuar me profecinë. Pejgamberi thotë:

“Pas meje nuk ka pejgamber dhe pas jush nuk ka ummet. Adhurojeni Zotin, falini pesë vaktet e namazit, agjërojeni Ramazanin dhe bindjuni udhëheqësve tuaj, në mënyrë që të hyni në Xhenet.

Dijeni se pejgamberët lavdërohen me (numrin) e shumë të ummeteve të tyre. Prandaj, mos më turpëroni dhe mos ma nxini fytyrën! Unë do t’ju pres te dera e Burimit të Keutherit.”

Këtë duhet ta mbajmë mend mirë për të pasur gjithnjë parasysh se me çfarë ndjenje përgjegjësie duhet të veprojmë ne të cilëve na drejtohen këto fjalë të të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Pejgamberi ynë i nderuar ka shkuar te Allahu (xh.sh.), me dëshminë e të gjithë ummetit. Po ne me çfarë do të shkojmë? Kjo është e gjithë çështja.

Pra, të mos e turpërojmë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), i cili do të na presë në krye të Burimit të Keutherit dhe i cili na ka cilësuar “vëllezërit e tij” ne brezave që kemi ardhur pas tij... T’i mbartim në jetë këshillat e të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-salam, që janë amanete me të cilat çdo mysliman do të ndërtojë personalitetin e tij. Ta dëgjojmë të Dërguarin e Allahut, (a.s.), me një ndjeshmëri të pafundme.

Ta ndiejmë atë, ta ndiejmë atë, ta ndiejmë atë.

Zoti (xh.sh.), mos na ndaftë prej tij!

Amin!

DËGJUAM DHE U BINDËM!

— Doç. dr. Adem Ergyl —

Njeriu, me të gjitha aspektet e dukshme dhe të padukshme të tij, përgjatë gjithë historisë ka shfaqur qëndrime të ndryshme kundrejt mesazheve Hyjnore që e ftojnë atë për një jetë të pastër dhe plot gjallëri. Nëse poseduesit e këtyre veprimeve dhe sjelljeve mund t'i ndajmë në tri grupe kryesore: mohuesit e refuzuesit e fesë, hipokritët, besimtarët, edhe ndërmjet këtyre grupeve sigurisht që ekzistojnë ndarje të niveleve të ndryshme. Ne, në këtë artikull, veçanërisht do të shqyrtojmë faktin se si duhet të jetë “qëndrimi i besimtarit” në pikën “për t’ua vënë veshin mesazheve hyjnore”.

Para së gjithash, le t’ia vëmë veshin këtij paralajmërimi të Zotit (xh. xh.): ***“O ju që keni besuar! Bindjuni Allahut dhe të Dërguarit të Tij dhe mos ia ktheni shpinën, ndërkohë që e dëgjoni (të vërtetën)! Mos u bëni si ata që thonë “Dëgjojmë”, por nuk ia vënë veshin. Krijesat më të këqija para Allahut janë ato që janë shurdhdedhe memece (ndaj së vërtetës) e që nuk kanë arsye.”*** (Enfal, 20-22.)

Nëse e vëmë re, këtu ajete drejtohet besimtarëve dhe i informon ata për një rrezik të madh, i cili e fundos njeriun nga niveli njerëzor në kategorinë më të ulët të gjallesave. Ky rrezik është indiferentizmi dhe moskokëçarja, e shprehur në formën: njerëzit “nuk dëgjojnë” edhe pse veshët e tyre dëgjojnë. Thënë ndryshe, njeriu nuk i zbaton urdhëresat që dëgjon.

Me sa kuptohet, besimi, si një nder i madh dhe një mirësi Hyjnore, edhe pse është kusht i domosdoshëm në çështjen e paisjes së njeriut me humanizëm, prapë se prapë nuk është një kusht i mjaftueshëm, sepse vetëm të besuarit nuk e siguron dot njeriun nga rënia në këtë përfundim të dhimbshëm. Prandaj, zemra e besimtarit është e detyruar që vazhdimisht të dridhet me këtë shqetësim.

Disa njerëz i mbyllin veshët kundrejt ajeteve Hyjnore dhe paralajmërimeve profetike. Madje, për të mos dëgjuar, ka pasur edhe prej atyre që kanë hyrë nën petkat e tyre. Pa shikojeni këtë ankesë të Nuhut (a.s.):

“Sa herë, që i thirrja për t’i falur Ti, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloheshin me petkat e tyre, duke këmbëngulur me mendjemadhësi (në mosbesim).” (Nuh, 7.)

Ndërkohë ka pasur edhe prej atyre që edhe pse besonin dhe dëgjonin, bënin të kundërtën e asaj që dëgjonin. Në lidhje me njerëzit e tillë, Allahu Teala na njofton duke dhënë si shembull Beni Israilët: ***“Kur morëm besën tuaj dhe ngritëm mbi ju malin e Turit, thamë: “Merreni seriozisht atë që ju kemi dhënë dhe dëgjoni!” Ju thatë: “Ne dëgjuam, por kundërshtojmë!..”*** (Bekare, 93.)

Po, me gjuhë thoshin se kishin dëgjuar, por me veprat e tyre bënin të kundërtat e atyre që kishin dëgjuar. Gjendja e tyre u vlerësua si “Dëgjuam, por kundërshtojmë!..”, në audiencën e Zotit të Lartësuar.

Prej atyre që kanë pas besuar, ka pasur edhe të atillë që në vend që t’i zbatonin të vërtetat që dëgjonin, i devijonin ato dhe i shtrembëronin për shkak të interesave të tyre. Pra nuk vepronin siç kërkonte Allahu dhe i Dërguari i Tij, por sipas dëshirave vetjake të tyre. Në Kuranin Fisnik thuhet si më poshtë për gjendjet e tilla të besimtarëve që i patën

besuar Musait (a.s.):

“Vërtet shpresoni ju (besimtarë) se ata (hebrenjtë) do t’ju besonin ju, ndërkohë që disa prej tyre i dëgjonin fjalët e Allahut dhe, pasi i kuptonin, me vetëdije i shtrembëronin ato?!” (Bekare, 75.)

Ndërkohë, besimtarët e vërtetë nuk duhet të jenë të tillë. Ata nuk duhet të sillen si të verbër e të shurdhër kundrejt të vërtetave që dëgjojnë, por duhet t’ia vënë veshin me gjithë zemër Fjalës Hyjnore dhe thirrjes së të Dërguarit të Allahut, alejhi’s-salam, dhe pastaj duhet t’i pasojnë me bindje dhe nënshtrim të plotë, në mënyrë që t’i kryejnë veprat me të cilat ngarkohen. Allahu Teala shpreh domosdoshmërinë që besimtarët të posedojnë një moral dhe pjekuri të tillë:

“...Ata (Pejgamberi dhe besimtarët) thonë: “Ne dëgjojmë dhe bindemi. Faljen Tënde kërkojmë, o Zoti Ynë dhe te Ti do të kthehemi!” (Bekare, 285.)

“Le të gëzohen ata që shmangen nga adhurimi i idhujve e kthehen nga Allahu! Pra, jepu lajme të gëzueshme robërve të Mi, të cilët, pasi i dëgjojnë fjalët (që u thuhet), ndjekin atë që është më e mira prej tyre. Këta janë ata që Allahu i ka udhëzuar në rrugë të drejtë; këta janë mendarët.” (Zumer, 17-18.)

Këto ajete fisnike na tregojnë se sa i rëndësishëm është dëgjimi në arritjen e udhëzimit Hyjnor. Gjithashtu na njoftojnë se dëgjimi i vërtetë shkon përtej shqisave dhe plotësohet përmes përpjekjes për të kuptuar dhe zbatuar urdhrat. Nëse nuk përpiqemi ta kuptojmë atë që dëgjojmë, atëherë, në të vërtetë nuk kemi dëgjuar. Allahu Teala shprehet kështu për këtë të vërtetë:

“Ka prej atyre që të dëgjojnë. Por, a mund të bësh ti që të dëgjojnë të shurdhrit, të cilët s’kanë as mend?” (Junus, 42.)

Po, ata që nuk përpiqen të kuptojnë mesazhin Hyjnor dhe që hiqen sikur e kanë dëgjuar, në të vërtetë nuk e kanë dëgjuar. Po ta kishin dëgjuar me gjithë zemër, të vërtetat Hyjnore do t’i ndryshonin ata. Domethënë, baza e bindjes dhe pasimit është të kuptuarit e saktë të fjalës. Kjo është një e vërtetë që e shpreh edhe ky ajet fisnik: **“Vetëm ata që dëgjojnë (me sinqeritet) do t’i përgjigjen (ftesës tënde).”** (En’am, 36.)

Jo ata që bëjnë sikur dëgjojnë, por ata që dëgjojnë me gjithë zemër mund të takohen me të vërtetën që vjen nga Allahu i Madhëruar. Ajo që pritet prej besimtarëve para së gjithash është që ta arrijnë një cilësi të tillë dëgjimi. Po ashtu, ajo që pritet prej besimtarëve është shfaqja e përpjekjes për ta zbatuar atë që dëgjojnë dhe jo kërkimi i preteksteve apo i dredhive për të bërë sikur nuk kanë mundësi t’i zbatojnë. Allahu i Lartësuar i Cili është Rrahman dhe Rrahim do t’u hapë shumë shtigje të sigurta atyre që e bëjnë nijet, vendosin dhe përpiqen për të gjetur rrugën e vërtetë. Madje, do t’i udhëzojë ata

dhe do t’i bëjë të arrijnë te synimi i tyre.

Përfundimi që del prej të gjitha këtyre mesazheve hyjnore është ky: Hapi i parë i të dëgjuarit është që të themi “dëgjuam”, duke ia vënë veshin mesazhit me gjithë zemër. Hapi i dytë është të themi “e kuptuam”, duke i vënë në punë të gjitha aftësitë e të menduarit. Hapi i tretë është të themi “sigurisht që u bindëm”, duke vepruar sipas asaj që kemi kuptuar. Ndërsa hapi i katërt, që është edhe hapi i fundit, është që ta reflektojmë në jetë mesazhin Hyjnor, duke thënë “e ndoqëm Pejgamberin” pasi të shkojmë në gjurmët e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Ja, ky është qëndrimi që duhet të mbajë robi besimtar kundrejt ftesës së Allahut Teala dhe të Dërguarit të tij.

Tashmë me nijetin dhe vendosmërinë për të bërë një dëgjim të tillë, duhet ta dëgjojmë edhe një herë tjetër Kuranin Fisnik ajet pas ajeti. Po ashtu, duhet t’i dëgjojmë me një kënaqësi dhe mallëngjim të madh hadithet e Pejgamberit, i cili është i Dashuri i Allahut. Së fundi, të mos harrojmë ta dëgjojmë me gjithë shpirt edhe Hytben e Lamtumirës, që është mesazhi i tij i fundit për këtë ummet. Ne këtë lloj dëgjimi, individ mysliiman mund të gjallërohet dhe shoqëria islame mund të rimëkëmbet e të fitojë krenarinë.

Tani le t’ia vëmë veshim me gjithë shpirt dhe ta dëgjojmë përsëri një pjesë prej mesazheve të fundit të të Dërguarit të Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të:

“O njerëz! Siç janë të shenjtat këto ditë, siç janë të shenjtat këto muaj, siç është i shenjtë ky qytet (Meka), kështu janë të shenjtat edhe jeta, pasuria dhe nderi juaj. Çdo lloj dhunimi i këtyre është haram.

Nesër do të shkonin te Zoti juaj dhe absolutisht do të merreni në llogari për të gjitha gjendjet dhe veprimet tuaja të sotme. Prandaj, mos u ktheni në devijimet e vjetra pas meje dhe mos vrisni njëri-tjetrin.

Miq të e mi! Çdo lloj i kamatës është haram dhe gjendet nën këmbët e mia. As mos bëni padrejtësi, as mos pranoni që t’ju bëhet padrejtësi.

O njerëz! Respektojini të drejtat e grave!

O besimtarë! Mos bëni padrejtësi! Po ashtu, mos e ulni kokën kundrejt padrejtësisë! Mos i dhunoni të drejtat e njerëzve!

O njerëz! Zoti juaj është një. Edhe babai juaj është një. Të gjithë ne jemi fëmijët e Ademit. Ndërsa Ademi është prej dheut. Më i miri prej jush te Allahu është ai që ka më shumë devotshmëri kundrejt Tij. Arabi nuk ka ndonjë epërsi tjetër përveç devotshmërisë, kundrejt atij që nuk është arab.”

O Zoti ynë! Na e mundëso që të të përgjigjemi në atë mënyrë që Ti të jesh i kënaqur, duke thënë “dëgjuam dhe u bindëm” kundrejt të gjitha të vërtetave të cilat na ke ftuar nëpërmjet të Dërguarit Tënd të Nderuar, Muhamed Mustafasë (a.s.)! Mos na bëj prej atyre që thonë “dëgjuam por kundërshtojmë”!



Amaneti dhe tradhtia

— Ali Riza Temel —

Allahu Teala thotë në Kuranin Fisnik: ***“O ju që keni besuar! Mos e tradhtoni Allahun dhe të Dërguarin e mos i tradhtoni amanetet me vetëdije.”*** (Enfal, 27.)

Njeriu i cili e ka marrë përsipër amanetin Hyjnor, me vullnetin e tij të lirë ka pranuar që të bëhet rob i Allahut Teala. Si rezultat, ai ka marrë përsipër të zbatojë urdhrat dhe të largohet nga ndalesat Hyjnore. Kjo është një përgjegjësi që buron nga fakti i të qenit njeri. Moskryerja e kësaj përgjegjësie është tradhti ndaj amanetit.

Besimtar është ai njeri që të tjerët i zënë besë, sepse ka besnikëri dhe e mban premtimin. Imani/besimi dhe amaneti vijnë nga e njëjta rrënjë në arabisht. I Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: *“Ai (njeri) që të tjerët nuk i zënë besë, nuk ka fe.”* Cilësia më dalluese e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), ka qenë besnikëria. Për këtë arsye, atij i kanë pas thënë “Muhammedu’l-Emin / Muhamedi Besnik”.

Nëse një njeri fillon të tradhtojë Allahun dhe të Dërguarin e Tij, mund të bëjë tradhti edhe kundrejt njerëzve në nder, pasuri, siguri të jetës dhe në çdo gjë tjetër. Kjo gjendje mund të arrijë deri në tradhti ndaj të drejtave, ligjeve, atdheut, popullit dhe vlerave shpirtërore. Për shkak të kësaj, formohet një shoqëri në të cilën njerëzit nuk i besojnë njëri-tjetrit dhe siguria e besnikëria zhduken totalisht. Tradhtia e vërtetë është mungesa e respektit kundrejt Allahut dhe të Dërguarit të Tij, dhe harrimi apo nënvlerësimi i detyrës së adhurimit kundrejt Zotit (xh.xh.).

Tradhtia vjen në krye të cilësive më të këqija. I Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë: *“Ka dy cilësi që nuk mund të jenë në karakterin e besimtarit. Ato janë tradhtia dhe mashtrimi.”* (Ahmed ibn Hanbel, Musned,

5/252.) *“Mysliman është ai njeri që prej dorës dhe gjuhës së tij nuk kanë dëm myslimanët e tjerë. Ndërsa besimtar është ai që njerëzit i besojnë në çështjen e jetës dhe pasurisë.”* (Tirmidhi, Iman, 12.)

Myslimani nuk tradhëton askënd, sidomos Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Ai nuk mund ta tradhtojë vëllain e tij në fe. Nëse e tradhton, kjo quhet tradhti e madhe.

Kjo ngjarje tregohet si shkak i zbritjes së ajetit fisnik që e kemi dhënë në krye: Beni Kurejdha, të cilët ishin prej çifutëve, u bashkuan me politeistët e Mekës përgjatë luftës së Hendekut dhe tentuan t’i godisnin myslimanët pas shpine, duke e shkelur marrëveshjen e Medines që ishte bërë në vitet e para të hixhretit. Kur kalaja e tyre u rrethua nga i Dërguari i Allahut, (a.s.), ata u gjendën në vështirësi. Për këtë arsye, kërkuan marrëveshje. Ata vendosën kusht për marrëveshjen që gjykatës të ishte Sa’d ibn Muadhi. Ebu Lubabe, i cili shkoi për t’u takuar si përfaqësues i myslimanëve, kishte marrëdhënie interesi me disa çifutë. Ndërkohë, aty kishte edhe një pjesë të anëtarëve të familjes së tij. Për këtë arsye, atyre u tha se kishin zgjedhur gjykatësin e gabuar. U tha edhe se kjo do t’i çonte drejt vdekjes duke ua bërë me shenjë prerjen e fytit. Pastaj e konsideroi si tradhti kundrejt myslimanëve këtë që bëri dhe u pendua. Vetën e lidhi te shtylla e xhamisë dhe tha se nuk do të hante derisa të falej. Nëntë ditë qëndroi i lidhur dhe i uritur. Më së fundi, i Dërguari i Allahut, (a.s.), i tha se ai ishte falur dhe ia zgjidhi litarët me duart e tij. Ebu Lubabe kërkoi të falte të gjithë pasurinë e tij si dëmshpërblim. Pas sugjerimit të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), shpërndau vetëm një të tretën e saj.

Ka edhe prej atyre që thonë se ky ajet ka zbritur për Hatib ibn Beltean, i cili tentoi t'i lajmëronte fshehurazi Kurejshët për sulmin që i Dërguari i Allahut, (a.s.), do të bënte kundrejt tyre.

Cilido që të jetë personi për të cilin ka zbritur ajeti, e rëndësishme është që dhënia e sekreteve të shtetit armiqve, futja në vështirësi e të gjithë ummetit, prishja e vlerave humane e morale dhe tronditja e sigurisë në shoqëri, për interesa personale, asnjëherë nuk përputhen me humanizmin dhe myslimanizmin.

Njeriu është i pajisur me disa dobësi. Për këtë arsye thuhet se nuk ka njeri të pagabueshëm. Por ne kemi për detyrë që të mos insistojmë në gabim dhe t'i drejtohem pendimit. Pra, të pendothem si Ebu Lubabe që e ndëshkoi veten duke u lidhur në shtyllë. Ata që kanë shndërruar në cilësi të karakterit të tyrin mashtrimin, shtirjen dhe tradhtinë, nuk kanë asnjë lidhje me myslimanizmin.

Tradhtia ka ekzistuar në çdo kohë dhe në çdo fushë, edhe pse ajo është njëra prej cilësive më të këqija të njerëzimit. Shumë tradhti kanë ndodhur me dijeni apo pa dijeni, nga jashtë apo nga brenda. Ndërsa tradhtia më e keqe është ajo që bëhet me dijeni dhe nga brenda.

Shuplaka më e dhembshme është shuplaka që vjen prej mikut. Ky ummet në shumicën e rasteve është tradhtuar dhe ka marrë goditje nga brenda. Hipokritët, agjentët dhe filialet e tradhtisë që janë vendosur në strukturën e popullit dhe ummetit tonë si mikrobet e dëmshme në trup, gjithmonë kanë prodhuar përçarje dhe e kanë tronditur unitetin e popullit dhe të ummetit. Marrja e masave mbrojtëse kundrejt armikut të njohur është krejt e lehtë, por marrja e masave kundrejt tradhtive të atyre që hiqen si miq është jashtëzakonisht e vështirë.

Ana më e tmerrshme e kësaj çështjeje është se disa pseudomyslimanë e bëjnë tradhtinë duke pandehur se po bëjnë ibadet. Një tradhti e tillë buron ose nga injoranca, ose nga verbimi, që u shkakton syve përbindja e ndonjë interesi material.

Çdo gjë që fitohet nëpërmjet tradhtisë është e pavlerë sipas humanizmit dhe Islamit. Në Kuranin Fisnik thuhet: “Thua: *“A doni t’ju lajmëroj për ata që, më së shumti, humbasin nga punët e veta, për ata, për-pjekja e të cilëve ka qenë e kotë në jetën e kësaj bote, ndërkohë që mendonin se po bënin vepra të mira?”*” (Kehf, 103-104.)

Tradhtia ka mënyra dhe metoda të shumëllojshme. Tradhtia që bëhet duke shfrytëzuar ndjenjat e besimit dhe të mëshirës, veçanërisht kjo lloj tradhtie që mund të bëhet kundrejt miqve, është tepër e shëmtuar.

Sa krim i ulët dhe tradhti e rëndë është kryerja e këtyre veprimeve nën maskën e shërbimit fetar, duke e përdorur atë si mjet për t'i vrarë miqtë me duart e armiqve. Përdorimi i mundësive dhe burimeve njerëzore si lëmoshat, zekatet, kurbanet dhe vakëfet për

shkatërrimin a zhdukjen e ummetit, dhe dhurimi i këtyre burimeve atyre që janë armiq të këtij ummeti, në vend që të përdoren për rregullimin e ummetit e ndërtimin e brezave të rinj, është kulmi i tradhtisë. Kjo gjendje nuk është gjë tjetër veçse, siç shprehet edhe Muhamed Ikbali: “Shkatërrim i vetes dhe rregullim i të tjerëve.”

Këto organizata mafioze që veprojnë veçanërisht në petkun e fesë, besimit dhe xhihadit, me një fanatizëm të madh për grupet e tyre, duke sulmuar në fshehtësi, duke vjedhur pyetjet e provimeve dhe duke vënë maskën e shtirjes, po i neveritin të gjithë njerëzit që kanë ndërgjegje të pastër. Këto lloje grupimesh mallkohen nga të gjithë. Prej këtyre tradhtive që po bëhen në emër të fesë, po përfitojnë armiqtë dhe po humbasin miqtë.

Kamuflimi i këtyre veprimeve në formatin e xhihadit, është mashtrimi më i madh dhe më i ulët. Ne po i përjetojmë ditë pas dite vuajtjet dhe dhimbjet e këtyre tradhtive të brendshme dhe veprimeve të ulëta. Islamit është burimi i bashkimit, unitetit, vëllazërisë, singëritetit, besnikërisë dhe pastërtisë. Përdorimi i Islamit në anën e kundërt të tyre, futja e përçarjes dhe prishjes në shoqëri nëpërmjet intrigave të ndryshme, duke u shfaqur gjoja në rrugë të drejtë, dhe formimi i aleancave me armiqtë në plan të pasëm, janë ndër kurthet më tinëzore dhe të rrezikshme kundër vendit dhe ummetit.

Përdorimi i koncepteve fetare si Allahu, Kurani, Pejgamberi, engjëlli, ëndrra, frymëzimi, mrekullia etj., në zbatimin e kurtheve dhe kompleteve që burojnë nga injoranca, interesi, budallallëku dhe tradhtia, para së gjithash do të thotë degjenerim i këtyre koncepteve dhe ndryje e përçmim i vlerave të shenjta.

Njerëzit mashtrues që janë shfaqur si Mehdiu apo Mesihu nëpërmjet manipulimit të masave të gjera, duke pretenduar se kanë arritur pozita të mistershme e të paarritshme, gjithmonë kanë qenë fatkeqësi për ummetin dhe janë përdorur si vegla prej shefave të tyre.

Armiku më i madh i një të vërtete është fallsoja e saj, sepse ka ngjasim në pamjen e jashtme. Shkaku kryesor i mashtrimit është ky ngjasim. Floririn e vërtetë dhe atë fals mund ta dallojë vetëm një argjendar specialist. Për këtë arsye, ne e kemi për detyrë tu japim të gjithë individëve largpamësi dhe t'i bëjmë të kujdesshëm kundrejt mashtrimeve shkatërrimtare. Në këtë mënyrë, duhet ta nxjerrim shoqërinë nga naiviteti kurdo që të na jepet mundësia. Përderisa të mos rritet cilësia shoqërore dhe përderisa të mos konceptohen këto tradhti, është e pamundur të qëndrojmë në këmbë. Zoti e mbrojtë këtë popull dhe këtë ummet nga e keqja e tradhtive të brendshme dhe të jashtme. Amin!



PUNË COPA COPA

— Nuredin Jëlldëz —

Ne mund të bëjmë një llogari në lidhje me të djeshmen dhe të sotmen tonë, duke u nisur nga një histori që i atribuohet Nastradin Hoxhës. Hoxhës i kishin drejtuar një pyetje fshatarët e tij: “Çdo natë shohim një hënë të re në qiell. Vallë, çfarë bëhet me hënat e vjetra?” Këtyre njerëzve, që nuk e njihnin shkencën e astronomisë dhe që nuk kuptonin nga këto çështje të vështira, u kishte dhënë një përgjigje e cila i kishte bërë të heshtnin, por edhe të mendonin për gjëra të tjera të rëndësishme. U kishte thënë: “Hënat e vjetra i thejnë, i bëjnë copa-copa dhe i bëjnë yje.”

Ne si myslimanë nuk dyshojmë asnjëherë se nesër do të dalim në audiencën e Zotit (xh.xh.), dhe se do të japim llogari për çdo frymëmarrje të kësaj jete. Elhamdulillah që jemi besimtarë! Ne i zbatojmë rregullat e nënshtrimit ndaj Allahu Teala në këtë botë dhe besojmë se do të japim llogari në Botën e Përtejme. Tashmë, si domosdoshmëri e besimit tonë, kemi një pikë rreth të cilës duhet të mendojmë: Si duhet të ishin, si

janë dhe si duhet të jenë fjalët, premtimet dhe pohimet tona?

Çfarë do të bëhet me fjalët që kemi shqiptuar nëpër lutjet tona përgjatë haxhit apo umres, duke pasur për dëshmitarë engjëjt e Zotit (xh.xh.)? Disa prej këtyre fjalëve i kemi përdorur për t’u penduar. Disa të tjera i kemi përdorur për të pohuar apo premtuar. Sidoqoftë, këto fjalë i kemi përdorur me identitetin tonë prej besimtari dhe me perceptimin e njeriut të përkushtuar ndaj Zotit (xh.sh.). Vallë çfarë ka ndodhur me ato fjalë? Mos vallë engjëjt i kanë marrë, i kanë thyer copa-copa dhe i kanë bërë yje? Ne jemi ata të cilët duhet të bëhemi merak për fjalët që kanë dalë nga goja jonë, për materialet që kanë shkruar duart tona dhe për veprat tona. Pra, si do ta japim llogarinë për to?

Nëse nuk i bëjmë një llogari pjesës së jetës që ka kaluar, atëherë nuk mund ta vlerësojmë siç duhet pjesën tjetër që do të vijë. Ne e kemi të detyrueshme vetëllogaritjen dhe kontrollin e

gjendjes së premtimeve tona. Premtimet që ua kemi dhënë njerëzve, premtimet që ia kemi dhënë Allahut përgjatë lutjeve dhe premtimet e mëdha që kemi shprehur në momentin e parë kur kemi parë Qabenë... Të gjitha këto duhet t'i fusim në llogari. Madje edhe shpresat tona duhet t'i fusim në llogari.

Nëse gjërat që kemi shpresuar dje, nuk gjejnë vend në praktikën e jetës së sotme, atëherë do të thotë se ose shpresat tona, ose forma e jetës që bëjmë sot, është problematike. Xheneti që kemi shpresuar, veprat që kemi kryer në lidhje me këtë shpresë, mirësitë e tjera të Xhenetit, etj., padyshim që na reflektonin ne në ato momente, pra reflektonin besimin, ndjeshmërinë dhe pritshmëritë tona. Lutjet dhe kërkesat që i kemi parashtruar Allahut Teala për mëshirë, mbartnin cilësinë e veprave që kemi bërë si besimtarë. Termat si Xheneti, mëshira, mirësitë, etj. që përdornim dikur, mund të jenë fjalë që i kemi harruar, por ato akoma qëndrojnë të regjistruara te shënimet e engjëjve. Tashmë, çfarë ka ndodhur me akumulimin që formohej prej fjalëve të thëna, prej emocioneve të ndjera, prej atyre gjërave që kemi dhënë apo prej atyre që kemi marrë në Mekë, apo në shtëpi, si domosdoshmëri e identitetit tonë? Nëse i gjithë ky akumulim është shndërruar në copa-copa të mbledhura te një bohçe, atëherë do të thotë se jemi në humbje. Nëse muajt e kaluara sot kanë marrë formën e yjeve që shkëlqejnë nga larg, domethënë, nëse akumulimin tonë e kemi bërë copa-copa, atëherë duhet ta shpallim gjendjen e falimentit para se të shkojmë në vendin e llogarisë (në mënyrë që të përpiqemi për ndreqjen e situatës).

Kur jemi martuar, bashkëshorteve tona u kemi premtuar gjëra të bukura që shkëlqenin si hëna katërmëdhjetëshe. Mos vallë këto premtime duheshin harruar me kalimin e viteve? Apo ne nuk shohim ndonjë problem nëse premtimet i copëtojmë dhe i shndërrojmë në yje të vegjël? Premtimet që ua kemi dhënë fëmijëve, shokëve, miqve dhe të afërmve, sot nuk duhet të shndërrohen në buzëqeshje artificiale apo në shprehje

të bukura që i përdorim në raste festash. Nëse humbet veçoria prej besimtari, i cili konsiston në faktin se ai i beson llogarisë së fjalës dhe syrit, atëherë, do të thotë se jeta na ka copëtuar me çarqet e rrugëve të gabuara.

Një pohim i joni padyshim që ka dallim nga një pohim që ka dalë nga goja e një jobesimtari. Identiteti ynë na e bën të domosdoshme mbajtjen e fjalës. Atë nuk mund ta bëjmë copa-copa. Fjalët që kemi copëtuar (nuk i kemi mbajtur), apo që i kemi shndërruar, vjen një kohë që përbëjnë identitetin tonë të bërë copa-copa. Ne ndosh-ta mund t'i harrojmë, por engjëjt nuk harrojnë. Ne plakemi, por engjëjt nuk plaken. Ne mund të kotemi, por engjëjt nuk koten. Ne mund t'i pranojnë ato gjëra si të vogla, por engjëjt nuk

nënvlerësojnë asgjë. Ndërkohë, nuk duhet të harrojmë se ne gjithmonë gjendemi nën shoqërinë e engjëjve. Këta engjëj, që gjenden me ne, nuk e harrojmë pohimin tonë edhe pse mund të kalojnë shekuj të tërë, këta engjëj do ta sjellin atë "po-në" në vendin ku do të japim llogari, këta engjëj do t'i sjellin librat e veprave tona para nesh...Ja, ky është besimi ynë dhe baza që formon identitetin tonë.

Aq sa mendojmë të kërkojmë falje për mëkatet që kemi bërë, po aq duhet të kthehemi prapa dhe të rregullojmë fjalët, premtimet, madje edhe shpresat e coptuara, të cilat na e kanë tronditur identitetin tonë prej besimtari. Pra, duhet të kthehemi prapa dhe t'i rinovojmë

e rregullojmë gabimet tona.

Ne nuk mund ta harrojmë fjalën që i kemi dhënë Zotit (xh.xh.), me anë të lutjeve, shpresave dhe pendimeve. Ne nuk mund të harrojmë fjalët që u kemi dhënë njerëzve. Gjithashtu, nuk mund të shkelim as fjalët që i kemi dhënë vetes. Si mund ta pranojmë një njeri që shtyp vetveten? A nuk është e trishtueshme gjendja e një njeriu që dje e mbante në rend të ditës Xhenetin dhe mirësitë e tij, ndërsa tani kalojnë muaj pa i çuar ndër mend? Çfarë kemi bërë me ato imagjinata? Çfarë kemi bërë me ato shpresat? Çfarë kemi bërë me fjalët rreth shtetit Islam dhe jetës fetare që na çojnë në Xhenet? A nuk do të ishte mirë që të paktën të kërkojmë copat e tyre?

Nëse humbet
veçoria prej
besimtari, i cili
konsiston në
faktin se ai i beson
llogarisë së fjalës
dhe syrit, atëherë,
do të thotë se jeta
na ka copëtuar me
çarqet e rrugëve të
gabuada.

Puna është ibadet

— Fejza Arpat —

Çdo gjë që është krijuar në këtë univers e ka një qëllim. Çdo krijesë është e pajisur me të gjitha elementet e nevojshme për ta kryer detyrën e saj. Përse trupi ynë nuk përbëhet vetëm nga muskujt? Përse nuk përbëhemi vetëm prej kockave? Për lëvizjen e tyre në mënyrë të organizuar janë krijuar edhe kyçet. Gjithashtu janë krijuar edhe nervat, në mënyrë që të mundësohet kontakti ndërmjet organeve me urdhrin për të punuar që e jep truri. Trupi ynë ka një strukturë të programuar për të lëvizur. Po shpirti ynë? Si mund të jetë shfaqur në jetën tonë koncepti i pikëllimit dhe si mund të jetë formuar kjo zbrazëti në shpirtin tonë? Gjendjet depresive që formohen prej mungesës së aktivitetit, a nuk formohen edhe nga mosngopja e shpirtit duke punuar? Puna gjendet në natyrshmërinë e njeriut, në natyrshmërinë e myslimanit dhe është urdhër i Allahut (xh. xh.). Dallimi i myslimanit është se ai vepron sipas urdhrave të Allahut Teala. Ne duhet t'i shfaqim një jetë krejt të pastër Zotit të Madhëruar, i Cili na ka lartësuar duke na e dhuruar këtë dallim.

Ne si njerëz nuk mund të jemi pa mëkate. Në të vërtetë mbi një copë të bardhë menjëherë mund të dallohet një pikë e zezë. Njeriu i cili është krijuar me natyrshmëri të pastër dhe me privilegjin si krijesa më e nderuar, lind krejt i bardhë. Kjo është shfaqja e madhësisë së Islamit, e cila del në pah edhe një herë tjetër me vlerën që i jep krijesës më fisnike. Nëse nuk jetojmë sipas kësaj feje madhështore dhe shfaqim sjellje apo veprime që nuk janë në përputhje me kënaqësinë e Allahut Teala, ne vazhdimisht shtojmë pika të zeza në natyrshmërinë tonë të dëlirë. Nëse kemi për qëllim të bëhemi robër që i do Allahu (xh.xh.), qoftë edhe një pikë e zezë na bën të ndjejmë dhimbje në zemër. Nëse përpiqemi ta fshijmë pikën, atëherë ky është vetë

suksesi. Nganjëherë mund t'ia dalim mbanë për ta fshirë dhe nganjëherë jo. Por nëse nuk e ndjejmë në zemër shqetësimin e asaj pike të zezë, atëherë do të thotë se e kemi humbur natyrshmërinë e pastër. Myslimanit të vërtetë nuk i pëlqejnë veprat që janë në kundërshtim me natyrshmërinë. Ai shqetësohet nëse bën thashetheme, ndërsa ndjen dhimbje kur përgojon. Myslimani i devotshëm e ndjen deri

në thellësi të shpirtit dhimbjen e çdo momenti që e harron Allahun (xh.sh.). Prandaj, nëse nuk ndjeni ndonjë shqetësim në raste të tilla, kjo do të thotë se natyrshmëria juaj është sëmurë.

Ne si myslimanë sigurisht që do të pushojmë. Edhe pushimi që bën myslimani është adhurim. Pra, është adhurim nëse është lodhur duke punuar aq sa e ka merituar atë pushim dhe po e bën këtë për të punuar përsëri... Allahu nuk e ngarkon njeriun me një barrë që nuk mund ta mbartë. Përderisa të vazhdojmë të punojmë, do të fitojmë sevape edhe nga të ngrënët, edhe nga të fjeturit. Në fakt,

çështja duhet të jetë pak edhe më sublime se fitimi i sevapeve. Zemra jonë duhet të digjet si zemra e sahabëve, në mënyrë që të ketë synime edhe më të larta se sevapet. Nëse mendojmë për Allahun në veprimet tona dhe nëse nuk e harrojmë Zotin (xh. xh.), i Cili na do më shumë se kushdo tjetër, puna do të na japë kënaqësi si ushqimi i vaktit kryesor, pushimi do të na japë kënaqësi si ëmbëlsira pas ushqimit dhe gjumi do të na japë kënaqësi si një gotë me ujë të ftohtë që pihet pas ëmbëlsirës. Myslimani nuk mendon që ta mbarojë sa më shpejt punën dhe të rrijë i lirë. Në fakt, koha e pashfrytëzuar e shqetëson atë. Edhe nëse i pushon trupi, shpirti nuk i pushon asnjëherë. Nëse lodhet duke lexuar, del në ballkon, vështron mirësitë e Krijuesit, mahnitet prej tyre dhe qetësohet. Ai bën ibadet duke gatuar ushqimin, lexon ndonjë pjesë prej Kuranit Fisnik



dhe pastaj zhytet në ibadetet e tjera. Myslimani nxiton nga adhurimi në adhurim dhe nga puna në një punë tjetër.

“Një herë një burrë kishte blerë një kalë, por kali pas një kohe të shkurtër i kishte ngordhur. Burri dyshonte se kishte ndonjë problem në lidhje me ngordhjen e kalit. Për këtë arsye, shkoi te gjykatësi, por gjykatësin nuk e gjeti në zyrën e tij. Ditën e dytë përsëri shkoi, por prapë nuk e gjeti. Burri pastaj shkoi te veterineri për të mësuar të vërtetën. Veterineri i tregoi se kali kishte qenë i helmuar para se t’u shiste. Burri shkoi përsëri te gjykatësi dhe i tregoi për situatën. Gjykatësi e pyeti se përse nuk ishte paraqitur menjëherë. Burri i sqaroi se kishte shkuar, por se nuk e kishte gjetur në vendin e tij. Gjykatësi i tha: “Ke të drejtë. Nuk kam qenë këtu.” Pastaj u kthye nga sekretari dhe i tha: “Shkruaj! Paratë e kalit do të merren nga gjykatësi...”

Nëse madhështia e pozitës së punës që bëjmë perceptohet siç duhet dhe nëse punojmë me ndërgjegje, atëherë puna shndërrohet në adhurim.

Çdo krijesë e Allahut Teala është një kryevepër. Mbresat që lë te çdo shikues një pikturë që ka bërë piktori, janë të ndryshme. Një melodi që është krijuar nga një kompozitor ndikon në mënyra të ndryshme te dëgjuesit, edhe pse përbëhet nga nota të njëjta. Edhe fjalët e gjuhës së universit kuptohen në mënyra të ndryshme. Ne duhet të shikojmë milingonën, e cila bën gjëra të mëdha me trupin e saj të vogël dhe duhet të themi: “Duart tona duhet të jenë të ndershme dhe punëtore të paktën sa zemra jote.”



Paralajmërimi që të plas zemrën!..

— Xhemal Nar —

Një sahab shkoi te i Dërguari i Allahut, (a.s.), dhe i tregoi për disa mëkate që kishte bërë dhe pastaj u nis për të ikur. Papritur në mendje i erdhi diçka dhe u kthye menjëherë dhe e pyeti Resulullahun, (a.s.):

-O i Dërguari i Allahut! A më shikonte Allahu kur i bëja ato mëkate?

-Po.

Sahabi i nderuar u rrëzua përtokë pa thënë asnjë fjalë, për shkak të frikës dhe turpiti që ndjeu ndaj Zotit (xh.xh.), atij i plasi zemra dhe ndërroi jetë...

Po, duke qenë të shkujdesur ndaj Zotit, nuk mund të shkojmë larg. Nëse nuk pendohemi, mund të vdesim në atë gjendje. Sa gjë e shëmtuar është që të mendosh se të shohin njerëzit tek sa kryen një veprim, ndërkohë që nuk merr parasysh faktin se të shikon Allahu Teala.

Detyra më e madhe

“Islami” është feja e Allahut Teala. Sipas nesh, përveç Islamit nuk ka fe tjetër. Edhe nëse i thuhet fe një tjetre, kjo bëhet thjeshtë si mënyrë për t’u shprehur. Fetë e humbura në të vërtetë nuk janë fe, por janë rrugë të devijuara.

Fe, në mënyrën e të shprehurit të ditëve të sotme, nënkupton një mënyrë jetese, në të njëjtën kohë edhe sistem dhe rend.

Feja ka filluar me Ademin (a.s.), dhe është përsosur me profecinë e Muhamedit (a.s.). Feja çdo moment është e hapur ndaj ixhtihadit për shkak të ngjarjeve që ndodhin. Feja mund ta rinovojë veten. Për këtë arsye është plot gjallëri dhe dinamikë.

Islami është feja e vetme e pranuar te Allahu Teala, por disa persona pretendojnë se Islami nuk iu përgjigjet dot nevojave të shekullit. Nëse kjo nuk është demagogji, atëherë nuk është gjë tjetër përveçse injorancë. Njerëzit e tillë nuk njohin as veten, as Allahun Teala i Cili është Zoti i botëve. Mjerë për ta!

Prandaj detyra jonë më e rëndësishme si mysli-manë është zhdukja e injorancës, si nga vetja jonë, edhe nga të gjithë njerëzit e tjerë.

Pika ku duhet të përkushtohemi

— Idris Arpat —

Cilat janë detyrimet dhe kushtet në jetën tonë, si njerëz dhe veçanërisht si myslimanë? Cilat çështje janë shumë të rëndësishme dhe cilat mbartin më pak rëndësi? Njohja e këtyre përgjigjeve, sipas një mentaliteti islam, do ta lehtësonte dhe zbukuronte jetën, sepse zbatimi i Islamit është përjetim i natyrshmërisë sonë.

Dogan Xhyxheugllo pohon diçka të tillë:

“Ne si popull e ekzagjerojmë jashtë mase shoqërinë në sytë e fëmijëve. Këtë e bëjmë në formën: ‘Nëse vepron në këtë mënyrë, njerëzit do të thotë kështu e ashtu.’ Për shkak të kësaj edukate, njeriu i jep rëndësi të veçantë shoqërisë dhe fillon të veprojë sipas kërkesave të saj. Në vend që t’i themi fëmijës: ‘Njerëzit thonë kështu e ashtu.’, le t’i themi: ‘Si e ndjen veten pasi ke bërë këtë veprim?’ Pra, nëse do ta ftonim fëmijën për të dëgjuar zërin e ndërgjegjes së tij, do të ishte më e qëlluar.”

Kështu shprehet Dogan Xhyxheugllo. Për mendimin tim do të ishte më mirë sikur këtë pohim ta kishte çuar një hap më para dhe të ishte shprehur: “Si e ndjen veten para Allahut pasi e ke shfaqur këtë sjellje dhe e ke thënë këtë fjalë?”

Unë mendoj se kjo çështje ka lidhje të drejtpërdrejtë me bindjen tonë ndaj Zotit (xh.sh.). Për këtë arsye, ajo mbart shumë rëndësi. Prandaj mendoj se nuk ka shumë rëndësi se çfarë do të thonë njerëzit, madje nuk ka aspak rëndësi.

Nisur nga ky këndvështrim, ne duhet t’i shqyrtojmë edhe një herë aktivitetet tona tregtare dhe fushën e arsimit. Nëse u shkaktojmë dëm në ndonjë mënyrë njerëzve me

të cilët gjendemi së bashku, nëse jemi në pozitën e mësuesit-edukuesit, detyrimisht jemi të detyruar që ta marrim parasysh se çfarë thonë njerëzit. E njëjta gjë vlen edhe për pozitën e udhëheqësit.

Tani si myslimanë le ta shtjellojmë këtë çështje me një logjikë të qartë:

Kur të bëjmë nijetin, kur të themi diçka apo kur të kryejmë ndonjë vepër, shprehja “çfarë do të thonë njerëzit” duhet të gjendet në fund të çdo vendimi. Për ne e rëndësishme është se çfarë do të thotë Krijuesi i Lartësuar. Ne nuk ia kushtojmë adhurimin njerëzve, por Allahut Teala. Ajo që duhet të bëjmë nuk është t’i përshtatemi jetës, por ta përshtatim jetën me të Vërtetën. Njerëzit mund të na lavdërojnë apo të na ofendojnë, mund të na duartrokin apo mund të na shajnë. Kësaj duhet t’i qeshim dhe ta hedhim mbrapa. Ne nuk kemi për synim që të fitojmë vlerësimin e njerëzve, apo të presim prej tyre nderim dhe lartësim. Madje nuk mund ta kemi një synim të tillë. Këto janë gjëra boshe, ose thënë më drejtë, janë shirk i fshehtë. Edhe kur u shërbejmë njerëzve, prapë se prapë qëllimi ynë duhet të jetë kënaqësia e Allahut të Lartësuar. Çfarëdo që presim, duhet ta presim prej Zotit (xh.xh.). Kjo është një pavarësi e plotë kundrejt çdo gjëje përveç Allahut.

“Mos u preokupo me njerëzit o zemër,

Çfarë janë këto grindje të pakuptimta që po bën?

Asnjëherë mos mendo se çfarë thonë njerëzit,

Çdo gjë kalon, pra ç’është gjithë ky shqetësim?”

Sipas bindjes sonë, adhurimi i robit është kategorikisht i papranueshëm. Kur të jetë momenti i duhur, duhet të themi: “Le të thonë çfarë të duan.” – dhe të jetojmë ashtu siç mendojmë se është e drejtë. Asnjëherë nuk duhet të luajmë role, por duhet të jemi vetvetja gjithmonë.

Nëse u japim rëndësi atyre që thonë njerëzit, do të gjendemi në pozitë të vështirë gjithnjë. Çdo grup njerëzish mund të kenë pritshmëri të ndryshme prej nesh. Rolet që ata i shohin të përshtatshme, për ne mund të jenë ndryshe. Atëherë, sipas kujt duhet të veprojmë?

Nëse do t’ia kushtonim vëmendjen vetes dhe

ndërgjegjes sonë, do të ishte më e drejtë. Njeriu mund ta jetojë vetveten. Vetëm se këtu bëhet fjala edhe për ndjeshmëri të ndërgjegjes. Çfarë do të rregullonte kthimi te vetvetja i një njeriu që nuk e ka të mjaftueshme ndjenjën e përgjegjësisë? Çfarë do t’i thotë ndërgjegjja atij? Nëse ndërgjegjja është shuar, atëherë ky njeri mund të bëjë çdo ligësi dhe pastaj të shfaqë një sjellje psikologjike që reflekton normalitet.

Këto janë zgjidhje që i kanë gjetur njerëzit laikë. Nëse mbahet jashtë vëmendjes fjala e Allahut të Lartësuar, atëherë nuk na mbeten zgjidhje të tjera përveç atyre të njerëzve të tillë. Prandaj, le të vijmë te çështja se çfarë thotë Zoti (xh.xh.):

Allahu i Madhëruar thotë në suren Dharijat: “Unë i kam krijuar xhindët dhe njerëzit vetëm që të më adhurojnë.” “Ne jemi të Allahut dhe te Ai do të kthehemi.”

Nëse u japim rëndësi atyre që thonë njerëzit, do të gjendemi në pozitë të vështirë gjithnjë. Çdo grup njerëzish mund të kenë pritshmëri të ndryshme prej nesh. Rolet që ata i shohin të përshtatshme, për ne mund të jenë ndryshe. Atëherë, sipas kujt duhet të veprojmë?

Kjo përjasje është trokitje në një derë shumë të sigurt. Nëse poseduesi ynë është Allahu (xh.sh.), nëse çdo gjë pa përjashtim ia kemi borxh Atij, atëherë është shumë e rëndësishme nëse Ai i pëlqen apo jo ato që bëjmë. Për këtë arsye, bërja e nijetit të pastër, duke marrë për bazë vetëm kënaqësinë e Zotit (xh.xh.), para se të themi ndonjë fjalë apo para se të realizojmë ndonjë vepër, na del përpara si një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme. Atëherë, pika ku duhet të përkushtohemi është “kënaqësia e Allahut”. E kundërta e kësaj është shirk i fshehtë. Kur i Dërguari i Allahut, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të, u kthye nga Taifi, tha: “*Nëse Ti je i kënaqur prej meje, unë nuk u jap rëndësi këtyre vuajtjeve që po heq.*” Kjo do të thotë se “qëllimi ynë kryesor është kënaqësia e Allahut Teala”. Çdo gjë tjetër është detaj.

Të jesh rob i Allahut (xh.sh.), do të thotë të shpëtossh nga mendimet e tipit: “thonë, kanë thënë, do të thonë”. Përpjekja për ta shtuar mirësinë dhe për ta pakësuar ligësinë në jetë, duke marrë fuqi nga i madhi Zot, është një veprim prej myslimani.

Prandaj, ne duhet të bëhemi robër të asaj dere dhe të presim çdo gjë prej saj, sepse nuk ka dhe nuk mund të ketë nder dhe krenari më të madhe se kjo.



Ku je, O MËSHIRË!

— Salih Zeki Meriç —

Kjo është një klithmë. Një klithmë mëshire që jehon kundrejt kësaj bote së cilës i është prishur harmonia, ngaqë tokës i janë tharë ujërat, reve u është kthyer shiu në breshër dhe erërat nuk e dinë më se nga fryjnë... Kjo është një thirrje për njerëzit të cilët janë shkaktarët e ndotjes së deteve, e prishjes së ekuilibrave të mjedisit dhe shpimit të shtresës së ozonit, në këtë botë të moshuar të cilës ia kemi prishur natyrshmërinë. Kjo është një thirrje për të mposhtur urrejtjen dhe për të qëndruar të pastër si në ditën e parë kur kemi ardhur në këtë botë.

Ne e mirëkuptojmë ndjeshmërinë kundrejt balenave që ngecin nëpër brigje, fokave që vriten nëpër pole dhe majmunëve të Afrikës që po u shuhet lloji. Ndërkohë, asnjëherë nuk mund të rrimë duarkryq

dhe pa reagu për qindra mijëra njerëz që po shkatërrohen dhe po u derdhet gjaku duke u prerë fytyrë. Prandaj, pa bërë dallim feje apo race, të gjithë së bashku le të bëjmë një thirrje mëshire për gjallërimin e zemrave që gjenden nën pushtim.

Zëri ynë le të lartësohet jo nga rreshtat, por nga zemrat tona. Mëshira le të mos mbesë vetëm në rreshtat e poezive dhe në faqet e librave. Le të strehohemi te mëshira e Zotit (xh.xh.), për të rregulluar veten, qytetin dhe botën në të cilën jetojmë.

Ne besojmë se Zoti i Lartësuar ka mëshirë të pafundme. Ne besojmë se Ai na ka rrethuar me dhembshurinë dhe mëshirën e Tij. Ah sikur ta pranionim në zemrat tona të shkreta qoftë edhe një pikë

prej burimit të mëshirës së Allahut Teala, i Cili përsëri na e mban hapur derën e mëshirës, edhe pse ne e kundërshtojmë dhe bëjmë mëkate të panumërta kundrejt Tij! Ah sikur të kishte rënë në zemrën tonë qoftë edhe një pikë prej lotëve të bekuara të të Dërguarit të mëshirës, para se të na thahen krejtësisht burimet e syve tanë! Ah sikur zjarri i Qerbelasë, për të cilën vajtojmë dhe mbajmë zi, të na kishte shtuar jo urrejtjen e mllefin, por mëshirën e dhembshurinë! Ah sikur! Por ja që nuk i kemi marrë dot ato mësimet që duhej t'i merrnim. Nuk i dalluam dot farërat e përçarjeve që na janë hedhur në mesin tonë për vite të tëra. Nuk i kuptuam dot dredhitë e armiqeve me petk prej miku.

Sot njerëzimi ka arritur në probleme me dimensionet të tmerrshme. Njerëzit e kanë verbuar ndërgjegjen me barbarizma, tirani e egoizma, i kanë humbur ndjenjat dhe janë privuar nga mëshira. Tirania ka marrë përmasa universale. Njeriu pothuajse po e copëton, po e vret dhe po e zhdruk vetë llojin e tij. Vallë, cilat janë shkaqet që na kanë sjellë në këtë situatë kaq të tmerrshme? Vallë, cili është shkaku i kësaj tiranie dhe barbarizmi që vjen e rritet çdo ditë e më shumë?

Ne nuk po presim që këtë klithmën tonë ta degjojë shoqëritë që kanë fe tjetër, gjuhë tjetër dhe kulturë tjetër, të cilat i kanë nëpërkëmbur të gjitha llojet e vlerave njerëzore në emër të interesave të tyre në këtë botë të përkohshme. Ata që i kanë ndërtuar civilizimet e tyre mbi gjak dhe kolonizim, nuk mund të bartin një cilësi të tillë si mëshira. Për këtë arsye, le ta kthejmë pasqyrën nga vetja dhe të qajmë për gjendjen tonë. Pastaj, le të kërkojmë përgjigjen e pyetjes se çfarë po na ndodh ne fëmijëve të të njëjtave toka, të të njëjtës fe dhe të të njëjtës gjuhë. Tokat tona, të cilat i njohim si "gjeografi shpirtërore", të cilat zënë një vend të veçantë në zemrat tona, të cilat mbajnë erën e Islamit, të cilat janë djepi i qytetërimit dhe mbajnë veprat jashtëzakonisht të rëndësishme të njerëzimit, tashmë po mbulohen prej gjakut. Çfarë u ka ndodhur fëmijëve të këtyre tokave, të cilëve ua kanë ngritur shpatat kundër njëri-tjetrit dhe i kanë përlyer ato me gjakun e njëri-tjetrit? Kurdo që na kujtohet Shami Fisnik, Bagdadi, Kerkuka, Musuli dhe Kudsi, na zihet fryma, na venitet fytyra dhe na lotojnë sytë. Përse e kemi humbur thesarin që e quajmë mëshirë? Përse i kemi humbur zemrat që frikësoheshin dhe dridheshin nga frika prej Zotit? Përse i kemi humbur sytë që lotonin nga frika prej Allahut (xh.xh.)?

Mëshira pothuajse është varrosur në dhe. Mëshira ka humbur prej njerëzve që ndërgjegjet dhe sytë

i kanë të mbuluara me gjak dhe arrijnë të vrasin edhe vëllezërit e vet.

Ja pra, në këtë situatë janë tokat tona. Këto qytete jetime, që i quajmë toka shpirtërore, janë në gjendje mjaft të trishtueshme. Një zjarr i tiranisë, që na vjen turp ta shkruajmë dhe ta shprehim, i ka shndërruar në hi qytetet tona që dikur kanë qenë si në botën e përrallave. Dikur jehonin zërat e ëmbël të fëmijëve të pafajshëm që vraponin nëpër rrugët e këtyre qyteteve. Ndërsa tashmë kanë ngelur vetëm imagjinatat e nënave që qëndrojnë ulur me mbulesën e tyre para shtëpive të bardha që janë bërë vrima-vrima nga plumbat. Mëshira mishërohet në zogun që do ta ushqejë të voglin me sqepin e vet, në një pikë shi që i jep jetë një kokërr fare, në një dorë që ia përkëdhelë kokën jetimit. Përgjatë gjithë historisë së civilizimit tonë, jetimët që kanë kërkuar humanizmin nëpër gërmadha, i kemi pasur si vëllezërit tanë (i kemi ndihmuar). Gratë e përdhunara dhe shumë njerëz që u ishte marrë e ardhmja nga duart, kanë qenë vëllezërit dhe motrat tona (kanë gjetur ndihmë dhe mbështetje prej nesh).

Ne tashmë dalëngadalë po e humbasim komplet humanizmin. Për këtë arsye, nuk duhet të shohim rreth e rrotull apo të fajësojmë të tjerët, por le t'i kthehemi vetes me shkrimet dhe klithmat tona. Ndërkohë që nga njëra anë duhet të merremi me njerëzit që mendojnë dhe jetojnë si ne, në anën tjetër duhet të ndihmojmë me miliona njerëz që gjenden në vende të mjera dhe të kthyer në ferr. Ne duhet të preokupohemi me brezat dhe fëmijët tanë që po na i marrin nga duart.

Në tokat tona njerëzit po vrasin në mënyrë çnjerëzore dhe barbare muhaxhirët që strehohen te ata. Ky njeri qytetar që nuk di se çfarë është humanizmi, që nuk ka durim dhe që nuk mjaftohet me atë që posedon, ka dalë në pah pas kësaj atmosfere tiranie.

Ne duhet t'ia hapim dyert dhe dritaret kësaj bote, në mënyrë që t'i degjojim klithmat e fqinjëve që vijnë nga lart, apo nga poshtë. Ne duhet të dalim nga lagja jonë dhe të preokupohemi me njerëzit që jetojnë në skamje nëpër lagje të tjera. Prandaj, duhet të kemi një dritë që të na drejtojë te miliona njerëz që kanë nevojë për mëshirë. Kjo botë nuk përbëhet nga shtëpia, miqtë, bisedat fetare dhe xhamitë tona. Nëse nuk shqetësohemi dhe nuk përpiqemi për të ndërë hallin e kësaj bote në zemrën tonë, atëherë nuk mund të shkojmë më tutje se tek vetëmashtrimi nga atmosfera magjepsëse e kësaj bote.



Një udhëtim me Sheherazaden

(PJESA E KATËRT)

— Nuredin Nazarko —

Njeriu gjendet i rrethuar në këtë jetë nga shumëllojshmëri krijesash. Po ashtu gjendet i rrethuar edhe nga çfarë vetë ka ndërtuar në rrjedhën e kohës, qoftë trashëgimi apo e ndërtuar në aktualitet. Për të ndërë kënaqësinë e bukurive që rrethojnë njeriun nevojitet soditje me zemër e shpirt. Habia që shkakton ajo çfarë rrethon njeriun mund ta çojë edhe drejt shastisjes. Por ka bukuri ndaj të cilave zbehen bukuritë e tjera. E në kësi rastesh njeriu e ka të pamundur të mos magjepset. Është mëse normale që syri të dëshirojë të sodisë të bukurën tek çdo lloj krijese. Por duhet bërë kujdes që të mos mbivlerësojmë bukurinë që duket, përkundrejt asaj bukurie që syri nuk mund ta shohë, bukurinë e karakterit dhe vlerave. Mund të mahnitesh prej bukurisë fizike, por nëse brenda asaj bukurie gjendet kutia e hapur e Pandorës, a do ta vlerësoje po njësoj si dikënd që të mahnit me bukurinë e karakterit dhe personalitetit? Është situatë e vështirë për njeriun të mbajë qëndrim të drejtë në kësi situatash dhe aq më tepër të marrë vendime të drejta. Por nuk është e pamundur të qëndrojmë në kufijtë e drejtësisë. Njeriu duhet të mëkojë vetveten vazhdimisht me dituri që e kthjellon mbi realitetin e së bukurës,

vlerës së saj dhe kujt bukurie duhet më i dhënë më së shumti përparësi, që të mos mbetet si peshku në zall e për rrjedhojë të mbetet peng i zhgënjimit, trishtimit e dëshpërimit. Dashuria ndaj drejtësisë duhet të triumfojë ndaj ndjesive që të shtyjnë drejt bukurisë së zhdukshme. Durimi është në goditjen e parë. Nëse tejkalon këtë çast, pjesa tjetër bëhet më e lehtë. Vlerat janë të pazhdukshme, por që të mbërrish tek to nuk është dhe aq e lehtë, përndryshe shumica nuk do t'i shihte si tabu që duhen thyer, që duhen shembur. Të thyesh, të shembësh është më lehtë se të ndërtosh, prandaj vlerat nuk janë të gatshme të presin kësilloj mysafirësh. Mund të vendosësh të jesh në cilën anën të duash. Frytet e vendimeve nuk i shmang dot.

Jo gjithmonë njeriu ka mundësi t'i kryejë vetë punët e tij. Është domosdoshmëri pajtimi i punëtorëve. Por njeriu vuan nga tahmaja dhe për rrjedhojë mund të tregohet edhe i padrejtë me punëtorin në rastin e pagës për punën e kryer. Nuk vlerëson pagën e punëtorit sipas çmimit që ka kryerja e punës në raport me tregun e çmimit të asaj pune, por vlerëson pagën në bazë të gjendjes së punëtorit.

Ka plot e plot raste kur punëtori paguhet më pak nga sa meriton. Kësisoj kryhet padrejtësi. Pasuria e vënë mënjane më kësilloj mënyrash është pasuri padrejtësie. Edhe pse njeriu mendon se ka arritur të maksimizojë fitimin, është fitim prej djersës e gjakut të tjetërkujt. Në këtë lloj pasurie nuk mund të ketë bereqet e begati pavarësisht sasisë që krijohet. Është domosdoshmëri, detyrë themelore t'i jepet haku i punës së kryer çdokujt, pavarësisht statusit apo pozitës shoqërore që ka. Madje nëse njeriu i ka mundësitë le të paguajë edhe pakëz më shumë që të jetë krejt i qetë në drejtësinë e zbatuar. Haku i djersës është i rëndë. Kjo vlen për të gjitha punët, mendore apo fizike, të cilat nuk shkelin kufijtë moralë. Njeriu i drejtë nuk mund të paguajë kurrësi për punë që shkelin kufijtë moralë e as të pranojë të paguhet për të kryer të tilla punë. Të mjerë janë ata të cilët pasurohen me hakun e djersës së tjetërkujt. Nëse njeriu do që të përmendet me të drejtë, duhet të ruhet nga padrejtësitë ndaj krijesave dhe duhet të kujdeset në shkallë sipërore që të mos i mbetet borxhli askujt në hakun e vet.

Në rrjedhën e jetës njeriu has në ngjarje të cilat as që i kishte paramenduar se do të ishin bashkë-udhëtarë të tij. Çdo ngjarje sjell përjetime, sfida të cilat duhen trajtuar me durim. Vështirësitë krijojnë ngarkesë shpirtërore. Edhe njeriu më i duruar nuk mundet t'i mbajë të gjitha ngarkesat brenda shpirtit, duke mos ia shprehur askujt. Natyra njerëzore e ka të nevojshme bisedën, komunikimin e vazhdueshëm me tjetrin. Nuk mund të shmanget e të devijojë nga natyra e vet. Në çaste apo situata të caktuara ndjen nevojën e madhe të shprehet diku, të flasë me dikë, të nxjerrë nga thellësitë vështirësitë që e mendojnë. Njeriu e di që ndoshta dëgjuesi nuk do t'ia zgjidhë hallin, problemin në mënyrën që ai mendon se duhet zgjidhur, por e ndjen se shprehja është çlirim për të dhe ky çlirim është shërbimi më i mirë për gjendjen në të cilën ndodhet. Por nuk duhet harruar gjëja më e rëndësishme në këtë mes. Nevoja për bisedë, nxjerrje të ngarkesës shpirtërore jashtë vetes, nuk duhet të sjellë më shumë problem sesa zgjidhje. Problemet mund të shumëfishohen nëse i beson vështirësitë e tua tek njerëz që mund t'i përhapin. Jo çdo gjë mund t'i besohet çdokujt. Para se të vendosim për të nxjerrë nga thellësitë e shpirtit gjërat që na mendojnë, duhet të zgjedhim njerëzit që iu besojmë. Njerëzit e urtë e të mençur, me edukatë e moral të lartë janë ata të cilët nuk shpërdorojnë besimin që iu jepet. Ata dinë të ruajnë amanetin që iu besohet. E kush më mirë se veç tyre mund të kuptojë rëndësinë e ruajtjes së amanetit?

Prandaj kujdes kujt ia beson amanetet e shpirtit.

Ndodh që njeriu t'ia besojë amanetin njerëzve jo të duhur, që mund të shtiren si këshillues të drejtë. Do të mjaftonte një hatëmbetje, qejfmbetje dhe këta këshilltarë të rremë nuk do të hezitonin të të godisnin pikërisht më atë që iu ke besuar. Njerëzit e këtij soji të ulët nuk mund të veprojnë ndryshe. Në vend që njeriu të lehtësohet prej barrës që mban në shpirt mund të rëndohet edhe më tepër, nëse bie në rrjetën e të ashtuquajturve dashamirës. Më shumë e pësojnë njerëzit e ndjeshëm, ata të cilët preken edhe nga vështirësitë më të vogla, nga padrejtësitë më të vogla. Duke qënë se nevoja për t'u çliruar është e madhe nuk hetojnë aspak karakterin e "miqve" me të cilët ndajnë të fshehtat e tyre. Prandaj, para se të njeriu të bjerë në një gjendje edhe më të vështirë nga sa ishte, duhen përzgjedhur mirë miqtë, ata të vërtetë, me të cilët të mund të bashkëndash hallin, problemin, vështirësinë duke qënë i qetë dhe i sigurt që amaneti yt është në duar të sigurta.

Njeriu ka nevojë për njerëz që t'iu besojë. Atëherë duhen kërkuar këta njerëz. Nëse gjenden nuk duhen braktisur kurrësi, sepse e mira që vjen nga kjo besueshmëri s'ka të krahasuar.

Njerëzit shpesh e më shpesh flasin për gjëra të cilat as nuk u hyjnë në qese. Hyjnë në një botë thashethemesh e korkolepsen në fije merimangash llafazne, saqë edhe kur duan të dalin prej aty nuk munden. Nuk munden sepse duke u marrë çdo sekondë me këtë botë, të qënë aty kthehet në normalitet. Marrja dhe përhapja e fjalëve kthehet në ushqim të pazëvendësueshëm. Bashkë me të vërtetat ngjizen dhe shumë të pavërteta dhe produkti final është një çorbë ku nuk dihet më ç'është e vërtetë dhe çfarë nuk është e tillë. Kjo kategori njerëzish janë tepër negativë sepse më fjalët e tyre nxisin dyshime të pavend, inate dhe urrejtje ndërmjet njerëzve. Prandaj nuk është e udhës që njeriu i arsyeshëm të bjerë në këtë kategori njerëzish. Njeriu duhet të përpiqet për rregullimin e gjendjeve dhe jo në rëndimin e tyre.

Të qëndruarit larg thashethemeve, fjalëve pa bereqet është shenjë shumë pozitive. Kësisoj njeriu kthellohet edhe më shumë mbi mangësitë dhe të metat e vetvetes dhe ndan më shumë kohë për veten sesa për gjëra të cilat nuk i sjellin asgjë pozitive në jetën e vet. Sa më larg të kotës, aq më afër gjallimit të zemrës.

Surja NISA

— Khafer Durmush —

Surja Nisa është njëra prej sureve në të cilën më së shumti gjenden dispozitat ligjore dhe morale. Për këtë arsye, kjo sure ka filluar me të vërtetën që Allahu Teala shikon e dëgjon çdo gjë, në mënyrë që robërit (njerëzit) t'i kryejnë me sukses këto dispozita. Në suren Nisa, një vend i gjerë u jepet të drejtave të familjes. Krahës këtyre, shpjegohen edhe temat si ndarja e trashëgimisë, përgjegjësisë e gjykatësit, koprracia, shtirja, pendimi i pranuar, gusuli, tejemumi, bindja ndaj udhëheqësit të ligjshëm, përgatitja e Xhenetit për besimtarët dhe përgatitja e Xhehenemit për jobesimtarët. Gjithashtu shtjellohen edhe temat si mbajtja e amanetit, rëndësia e drejtësisë, inkurajimi për në xhihad, qëndrueshmëria e Kuranit Fisnik, paqëndrueshmëria e hipokritëve, përshëndetja e ndërsjelltë, ndëshkimi për vrasjen e njeriut, hixhreti kur të jetë i nevojshëm, si mund të falet namazi në luftë (namazi i frikës) etj.

Fakti që në këtë sure janë dhënë këshillat dhe direktivat e nevojshme për stabilitetin e familjes, e cila përbën themelin e shoqërisë, për mendimin tonë është i rëndësishëm. Fakti që janë shpjeguar dispozitat në lidhje me martesën dhe trashëgiminë, është i rëndësishëm. Fakti që është urdhëruar respektimi i të drejtave farefisnore duke u theksuar se burrat dhe gratë kanë ardhur nga e njëjta origjinë, është i rëndësishëm. Ndërkohë, dëshirojmë

të shprehemi se në suren Nisa janë dhënë edhe bazat e rëndësishme që sigurojnë pjekjen e personalitetit të myslimanit.

Abdullah ibn Abbasi, radijall-llahu anhumu, ka thënë: “ Tetë ajete që gjenden në suren Nisa janë më të mira për këtë ummet se të gjitha gjërat mbi të cilat lind dielli në lindje e perëndim.” Kur e kanë pyetur se cilat janë këto tetë ajete, ka dhënë këtë përgjigje:

1- **“Allahu dëshiron që t’ju sqarojë, t’ju udhëzojë në rrugën e të dërguarve të mëparshëm dhe t’ju pranojë pendimet tuaja. Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe i Urtë.”** (Nisa, 26.)

2- **“Allahu dëshiron që t’ju pranojë pendimet tuaja, por ata që jepen pas epsheve, dëshirojnë që të largoheni krejtësisht nga udha e drejtë.”** (Nisa, 27.)

3- **“Allahu dëshiron që t’ju lehtësojë (barrët), pasi njeriu është krijuar si një qenie e pafuqishme.”** (Nisa, 28.)

4- **“Në qoftë se ju u shmangeni gjynaheve të mëdha, që ju janë ndaluar, Ne do t’ju falim gabimet tuaja të vogla dhe do t’ju shpiem në një vend të nderuar.”** (Nisa, 31.)

5- **“Vërtet, Allahu nuk dëmton askënd asnjë grimë, por, nëse (dikush) bën mirësi, Allahu ia shumëfishon atë dhe i jep shpërblim të madh.”** (Nisa, 40.)

6- **“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.”** (Nisa, 48.)

7- **“Kush punon vepër të keqe ose e ngarkon veten me gjynahe, pastaj kërkon falje prej Allahut, do të gjejë se Allahu është Falës e Mëshirëplotë.”** (Nisa, 110.)

8- **“Përse t’ju ndëshkojë Allahu, nëse ju e falënderoni dhe e besoni?! Allahu është Mirënjohës dhe i Gjithëdijshtëm.”** (Nisa, 147.)¹

1. Ibn Kethir, Tefsiru'l-Kuran, I, 448.



Në librat e tefsirit, në fillim të çdo sureje gjenden transmetime që na inkurajojnë ta lexojmë atë me më shumë kënaqësi. Për këtë arsye, thënie e Abdullah ibn Abbasit (r.a.), ia vlen ta shtjellojmë, sepse na mëson se sa i vlefshëm dhe edukues është leximi i sures Nisa duke e kuptuar.

Nëse e lexojmë me kujdes, në ajetet për të cilat po flasim, na kujtohet mirësia e Zotit (xh.xh.), kundrejt nesh. Gjithashtu njoftohemi se hallalli dhe harami janë bërë të qartë për robërit e Allahut, në mënyrë që ata të ecin në rrugë të ndritur duke e ndarë të mirën nga e keqja. Pastaj thuhet se në këtë mënyrë barra na është lehtësuar dhe jeta është bërë e jetueshme. Ndër të tjera jepet përgëzimi se “atyre që largohen prej mëkateve të mëdha, do t’u mbulohen (falen) mëkatet e vogla”. Përveç shirkut, Allahu Teala do t’ia falë mëkatet kujt të dëshirojë. Po ashtu, jepet edhe sihariqi se ata që kërkojnë falje, pasi të bëjnë ndonjë gabim apo mëkat, do ta gjejnë Allahun shumë falës.

Tashmë le ta përmbledhim: Nëse e lexojmë suren Nisa në përgjithësi dhe ajetet që ka zgjedhur Abdullah ibn Abbasi (r.a.), në veçanti, pas një përgatitjeje shpirtërore dhe mentale, mund të ndjejmë se jemi të rrethuar nga të gjitha anët prej faljes dhe mëshirës së Allahut të Lartësuar. Ajetet që ka zgjedhur Abdullah ibn Abbasi (r.a.), mbarojnë me këtë fjali pyetëse: “Përse t’ju ndëshkojë Allahu, nëse ju e falënderoni dhe e besoni?” Prandaj, transmetimi në fjalë na bën ta lexojmë edhe me më shumë kënaqësi këtë sure fisnike.

A jemi gati ta lexojmë suren Nisa me një vetëdije të tillë? A jemi gati ta rishikojmë kohën që kemi kaluar me tilavetin/leximin e Kuranit Fisnik? A mund ta lexojmë fjalën e Allahut Teala me kënaqësi dhe t’ua bëjmë të dashur atë edhe të tjerëve?

Ne besojmë se leximi që bëhet

pas një përgatitjeje të veçantë, është krejt i ndryshëm nga çdo lloj leximi tjetër. Të mos harrojmë se vetëm pas një leximi të tillë mund ta arrijmë përsëri dëshirën për t’u pastruar nga cilësitë e këqija si koprracia, shtirja, etj., që përmenden në këtë sure. Ndoshta mund të ulemi dhe t’i bëjmë një llogari vetes, sepse pas saj mund të lindë dëshira për t’iu drejtuar pendimit të pranuar për të cilin inkurajohemi në këto ajete. Pastaj, abdestin, i cili është dera e hyrjes për te adhurimet, mund ta marrim me një vetëdije më të plotë. Si rezultat, fillojmë të bëhemi më të ndjeshëm ndaj pastrimit nga shenjat e hipokrizisë dhe në zemrat tona ndizet shpresa për të hyrë në Xhenet dhe për të parë bukurinë e Allahut Teala. Në këtë mënyrë, fillojmë t’i zbatojmë me vend dispozitat që Islami ka vendosur për drejtësinë. Për shkak të tyre, zemrave tona, familjeve tona dhe shoqërisë sonë, mund t’u vijë atmosfera e prehjes shpirtërore. Pastaj mund të bëjmë planet për t’i lexuar dhe kuptuar edhe suret e tjera, duke u përgatitur shpirtërisht e mendërisht.

Përse të mos përgatitemi?



Risku hallall është mbrojtës

Në ajetet e mëposhtme, të cilat mund t’i përmbledhim në këtë formë paralajmërimi: **“Kini kujdes ndaj kafshatave tua!”**, që iu drejtohet atyre që kanë besuar, thuhet: **“O njerëz! Ushqehuni me të gjitha ato gjëra të lejuara e të mira që gjenden në Tokë dhe mos ndiqni gjurmët e djallit, sepse ai është njëmend armiku juaj i hapur. Ai ju nxit vetëm në të këqija, në vepra të turpshme dhe të flisni për Allahun gjëra që nuk i dini.”** (Bekare, 168-169.)

Siç thuhet në veprën me titull “Ruhu’l-Bejan”: “Shejtani i mallkuar së pari e thërret njeriun në kufër dhe në shirk. Nëse nuk ia del, atëherë fillon t’ia bëjë të dashura mëkatet dhe ta thërrasë në bidate. Nëse nuk ia del as në këtë pikë, mundohet që ta zhysë në mëkate të mëdha. Nëse nuk ia del mbanë as këtu, përpiket që t’ia shfaqë si të parëndësishme mëkatet e vogla. Nëse nuk ia del mbanë as për këtë, atëherë përpiket ta preokupojë me punë të pavlefshme, në mënyrë që ta privojë nga sevapet. Nëse edhe për këtë nuk ia del dot mbanë, e drejton nga punët që kanë pak sevape, në mënyrë që ta ndalojë nga veprat e virtytshme”.²

Ne e dimë se djalli i mallkuar na inkurajon drejt së keqes, së shëmtuarës dhe mendimeve e shqiptimeve të frazave në lidhje me gjëra që nuk i dimë për Allahun Teala. Por gjithashtu e dimë se **“dredhia e shejtanit është e dobët”**. (Nisa, 76.) Faktori më i rëndësishëm që ia dobëson kurthet shejtanit, është të jetuarit brenda kornizës së hallallit, ndoshta është edhe kujdesi ndaj asaj që hyn dhe del nga goja.

Në komentimin e Kuranit Fisnik thuhet: “Allahu e ka krijuar shejtanin për t’i ndarë njerëzit e këqij nga njerëzit e mirë.” (Ruhu’l-Bejan, Botimet Erkam, vëll. 2, fq. 143.) Ajetet që përbëjnë temën tonë, na njoftojnë për mënyrat më të rëndësishme të kësaj ndarjeje.

2. Ruhu’l-Bejan, Botimet Erkam, vëll. 2, fq. 142.



N MOS U PËRPIQ TA MARRËSH KËTË BOTË MBI SUPE NUK MUND TA MBASH

— As. doç. dr. Abdullah Ajgyn —

Kjo botë për njerëzit është si arë për Botën e Përtejme. (Shura, 20.) Produktet që do të vjelim në Ahiret, janë në raport të drejtpërdrejtë me punimet në arën e kësaj bote. Vetëm mohuesit e fesë i japin përparësi kësaj bote, kundrejt Botës tjetër. (Ibrahim, 3.) Atij që kërkon mirësitë e kësaj bote, i jepen mirësitë e kësaj bote. Atij që kërkon mirësitë e Botës tjetër, i jepen mirësitë e Botës tjetër. (Al Imran, 145.) Ndërsa më e drejtë është që të kërkojmë edhe mirësitë e kësaj bote, edhe mirësitë e botës tjetër. (Bakara, 201.)

Katër karakteristika e çojnë njeriun në humbje: 1. Tharja e syve, domethënë, mungesa e ndjeshmërisë ndaj mëkateve. 2. Ngurtësimi i zemrës. 3. Tuli emel, domethënë, bërja e planeve për të fituar nga kjo botë sikur nuk do të vdesësh asnjëherë. 4.

Lakmia ndaj kësaj bote. Ndërsa dëshira që nefsi ka kundrejt pasurisë është krejt e natyrshme. (Al Imran, 14.) Çdo njeri e ndjen dashurinë ndaj kësaj bote, domethënë, dëshirën për të pasur vazhdimisht sa më shumë pasuri, pozitivitet. Këta janë faktorët e domosdoshëm të sprovës së kësaj bote. Vallë, kush do ta sakrifikojë Ahiretin dhe do të rendë pas fitimit të kësaj bote? Dashuria dhe lakmia ndaj kësaj bote, që gjenden në natyrën e njeriut dhe që patjetër duhen marrë nën kontroll, në të vërtetë nuk janë gjë tjetër përveçse një mashtrim. (Al Imran, 185; Lukman, 33.) Sepse jeta e kësaj bote përbëhet nga kënaqësi të përkohshme si loja, argëtimi, dëshira për të pasur pasuri dhe lavdërimet. (En'am, 32; Hadid, 20.) Ngaqë besimtarët e kuptojnë këtë të vërtetë, preokupimet e kësaj bote nuk i pengojnë

nga adhurimi i Allahut Teala. (Nur, 37.) Por disa njerëz dëshirojnë të posedojnë çdo gjë në këtë botë. Për këtë arsye, atyre nuk u mbetet gjë në Ahiret. Ndërsa disa të tjerë kërkojnë të mirat edhe të kësaj bote, edhe të botës tjetër. (Bakara, 200-201.)

Shembulli më interesant në lidhje me përfundimin e tmerrshëm të zhytjes në këtë botë dhe harrimit të Botës së Përtejme është Karuni. (Kasas, 76-82.) Ndërkohë, nuk duhet të harrojmë se nuk është aspak e lehtë mposhtja e dashurisë dhe lakmisë ndaj kësaj bote. Për këtë arsye, në Kuranin Fisnik dhe në Sunet gjenden shumë paralajmërime. Detyra e njeriut, i cili herët apo vonë do të lërë pas çdo gjë që posedon, është rregullimi i kësaj bote dhe i jetës së njerëzve të tjerë. Njeriu duhet t'i konsiderojë pasuritë, pronat dhe pozitat si mjete për ta bërë këtë rregullim. Ndërsa stili i jetës moderne, që ka ndikuar te të gjithë ne, e bën njeriun që të rendë sa më shumë pas kësaj bote, sepse në qendrën e stilit të jetës moderne gjendet "materializmi". Në këtë stil jete nuk ka aspak vend për shpirtëroren. Kur situata arrin në këtë nivel, nevojat dhe dëshirat shtohen pa fund. Lakmia ndaj kësaj bote, pangopësia dhe tamahu pothuajse i kanë bërë njerëzit skllëvër. Njerëzit janë dhënë jashtë mase ndaj kësaj bote dhe e kanë shkatërruar veten në Botën tjetër. Vitet e rinisë kalojnë me shpresat për të pasur një punë prestigjioze dhe më shumë të ardhura. Ndërsa në periudhën e pjekurisë më së shumti rendet pas jetës së kësaj bote për t'u martuar, për të blerë shtëpi, makinë, tokë e mobilie dhe për t'i shtuar mundësitë e kushtet vetes. Jeta po harxhohet në këtë mënyrë. Më së fundi vjen vdekja. Sistemi kapitalist në të cilin jetojmë, i ka bërë njerëzit robër të kësaj bote, të interesave, të pasioneve dhe të dëshirave të pafundme. Ndërsa Islami nuk pranon që njeriu të bëhet rob i dynjasë dhe i interesave materiale. Islami kërkon që njeriu të jetë i nderuar dhe kjo botë të jetë e nënshtruar ndaj tij.

Njeriun e lodhin dëshirat afatgjata e afatshkurtra dhe përpjekjet për të fituar çdo gjë në këtë botë, të cilat ia shtojnë atij shqetësimet, streset dhe vështirësitë. Si rezultat, njeriu mbetet në presionin psikologjik të dëshirave. Sëmundjet psikologjike në shekullin tonë kanë pësuar shtim të ndjeshëm. Dhënia e tepërt pas kësaj bote po shkatërron jo vetëm individët, por edhe ummetin, sepse dhënia pas kësaj bote e ka zhdukur sakrificën. Ndërkohë sakrifica është e domosdoshme për fisnikërinë e njeriut. Për-

ndryshe njeriu mund të bëjë vepra shumë të ulëta. Ata që u japin vlerë interesave të kësaj bote, e kanë të pamundur ta sundojnë këtë të fundit. Njerëzit e tillë në fakt janë nën sundimin e dynjasë. Prandaj edhe frenat e tyre janë në dorën e kësaj bote. Bazuar në këto që thamë, myslimanët në çdo vend dhe në çdo kohë duhet të jenë të rregullt dhe të ekuilibruar. Edhe për sa u përket interesave të kësaj bote gjithmonë duhet të jemi të ekuilibruar.

Sigurisht që myslimani duhet të ketë dëshirën për të poseduar pasuri. Në të kundërt njeriu nuk mund të marrë shije nga jeta dhe mund të humbasë dëshirën që të veprojë. Njeriu nuk duhet t'i konsiderojë këto pasuri si qëllim, por si mjete për të arritur qëllimin. Myslmani duhet ta dijë se kjo botë në të vërtetë është provizore dhe e pavlerë. Të gjithë e dimë se nuk ka asnjë njeri që i ka arritur të gjitha gjërat që ka dëshiruar dhe që pastaj ka ndërruar jetë. Për këtë arsye, myslimani duhet ta konsiderojë këtë botë si një hije peme nën të cilën udhëtari ulet e pushon dhe pastaj vazhdon rrugën e tij. (Tirmidhi, Zuhd, 44.) Myslmani nuk duhet të shfaqë tamah, por duhet të mjaftohet kundrejt të mirave materiale që posedon. Kjo mund të arrihet vetëm me vetëdije shpirtërore. Myslmani mund të posedojë çfarëdo lloj pasurie, por duhet ta shohë këtë të fundit jo si qëllim, por si mjet, dhe ta bëjë skllave e jo t'i bëhet skllav asaj. Ai mund ta përdorë këtë pasuri si të dëshirojë pasi t'i respektojë kufijtë e hallallit. Pra shkëputja e pjesës: "Puno për këtë botë sikur nuk do të vdesësh asnjëherë!", nga fjala e urtë e cila e plotë është: "Puno për Ahiretin sikur do të vdesësh nesër dhe puno për këtë botë sikur nuk do të vdesësh asnjëherë!", që është e njohur në popull, është mjaft problematike dhe e gabuar.

Si përfundim, dashuria ndaj kësaj bote nuk ka fund. Përderisa të mos edukohet, kjo ndjenjë nuk ka ndonjë pikë përfundimtare ngopjeje. Njeriu i kohës së sotme, i cili nuk është i vetëdijshëm për këtë, e ngarkon veten me një barrë tepër të rëndë. Ah sa shumë gjëra që ka në këtë botë, të cilat duhet të fitohen, zotërohen, bëhen, etj. Këtë tentativë mund të quajmë metaforikisht edhe marrja e kësaj bote mbi supe. Ndërkohë njeriu e ka të pamundur ta marrë mbi supë dhe ta mbartë këtë botë. Për këtë arsye, kanë thënë: "Mos u përpiq ta marrësh këtë botë mbi supe, sepse nuk mund ta mbartësh. Prandaj hipi ti asaj në kurriz, sepse ajo ty të mbart krejt lehtësisht."

Çdo njeri
e ndjen dashurinë ndaj
kësaj bote, domethënë,
dëshirën për të pasur vazhdimisht
sa më shumë pasuri, pozitë etj.
Këta janë faktorët e domosdoshëm
të sprovës së kësaj bote. Vallë,
kush do ta sakrifikojë Ahiretin
dhe do të rendë pas fitimit
të kësaj bote?

Ukbe ibn Amri

R A D I J A L L A H U A N H U

një sahab dijetar

Mustafa Erish

PËRSE I ÇOJMË SALAVATE DHE SELAME TË DËRGUARIT TË ALLAHUT, (A.S.)?

Ka disa motive që na inkurajojnë për t'i çuar salavate dhe selame të Dërguarit të Allahut, alejhi's-selam. Njëri prej këtyre është fakti se edhe gjithësia e lartëson atë, domethënë, i çon salavate. Një arsye tjetër është fakti se të gjithë engjëjt shfaqin respektin e tyre kundrejt tij, duke bërë lutje dhe duke kërkuar falje për të, domethënë, i çojnë edhe ata salavate.

Këto të vërteta i mësojmë nga Kurani Fisnik. Kur shohim që edhe Allahu Teala, edhe engjëjt e lartësojnë të Dërguarin, (a.s.), kuptojmë se e kemi për detyrë t'i çojmë salavate dhe selame. Mbi të gjitha, këtë detyrë e kryejmë me një dëshirë dhe pasion edhe më të madh kur ndjejmë mirënjohje dhe falënderim ndaj Profetit, i cili na ka nxjerrë nga errësirat në dritë dhe na ka treguar rrugën e

shpëtimit. Përveç të tjerash, kur mësojmë se Allahu i Lartësuar ka thënë: **“Çojini edhe ju salavate dhe selame atij!”**, i çojmë salavate Pejgamberit edhe në namaz, edhe kur dëgjojmë të përmendet emri i bekuar, edhe kur dëshirojmë të shprehim dashurinë e respektin tonë kundrejt tij. (Përkthimi dhe Shpjegimi i Rijazu's-Salihin, Hadithi nr: 1409.)

Ebu Mes'ud el-Ensari (r.a.), transmeton se i Dërguari i Allahut, alejhi's-selam, ka thënë: **“Në memorien e njerëzve ka mbetur një fjalë që nga pejgamberët e parë: Nëse nuk ke turp, bëj çfarë të duash!”** (Buhari, Enbija, 54, Edeb 78; Ebu Davud, Edeb, 6.)

Në shpjegimin e këtij hadithi fisnik janë shqyrtuar çështje shumë të rëndësishme në lidhje me ndjenjën e turpit. Ndjenja e turpit ka ekzistuar që me njeriun e parë. Që nga profetët e parë është theksuar rëndësia e kësaj ndjenje. Edhe pse një pjesë e urdhrave Hyjnore

që u jepej pejgamberëve kanë ndryshuar me kalimin e kohës, urdhri hyjnor në lidhje me ndjenjën e turpit nuk ka ndryshuar aspak. Të gjithë pejgamberët kanë këmbëngulur në rëndësinë e ndjenjës së turpit.

Këtë hadith fisnik është e mundur ta kuptojmë edhe si kërcënim. Nëse do ta konceptojmë si të tillë, atëherë kuptimi i hadithit është: “Bëj çfarëdo të keqeje që dëshiron. Një ditë do të japësh llogari për të.” Hadithit mund t’i japim edhe një kuptim tjetër: “Mendo mirë për atë që je duke bërë! Nëse vepra jote nuk është e tillë që duhet të turpërohesh nga Allahu dhe pastaj nga njerëzit, mund ta kryesh atë me gjithë prehjen shpirtërore. Nëse do të bësh diçka, nga e cila do të turpërohesh nga Allahu dhe pastaj nga njerëzit, atëherë absolutisht mos e bëj!” Ky hadith fisnik, me këtë kuptim të fundit, i jep njeriut një rregull mirësjelljeje. Nëse puna që do të bëhet do ta turpërojë njeriun në fund, atëherë robi duhet të largohet prej saj. Nëse nuk ka ndonjë gjë për t’u turpëruar, atëherë nuk ka ndonjë problem në kryerjen e saj.

Ndjenja e turpit është një cilësi e rëndësishme në ndarjen prej njëra-tjetrës të së mirës nga e keqja dhe të haramit nga hallalli. Një njeri që nuk ka turp mund të bëjë çdo lloj ligësie pa hezituari aspak. Prandaj është e domosdoshme që të edukohen njerëz të cilët njohin ndjenjën e turpit, në mënyrë që të formohet

një shoqëri e shëndetshme. Ndjenja e turpit është një urdhër Hyjnor dhe një rregull edukate që na e kanë sugjeruar të gjithë pejgamberët dhe ummetet. (Përkthimi dhe Shpjegimi i Rijazu’s-Salihin, Hadithi nr: 1848.)

Ngaqë Ebu Mes’ud Ukbe ibn Amr el-Bedri (r.a.), ishte një sahab dijetar, shpesh herë i bëheshin pyetje në lidhje me çështjet islame. Kishte edhe persona që kërkonin këshilla të veçanta prej tij. Të gjithë atyre që shkonin për ta vizituar dhe për t’i kërkuar ndonjë sugjerim, u jepte këtë këshillë të rëndësishme:

“Ju këshilloj që t’i përmbaheni xhematit, sepse Allahu i Lartësuar nuk do ta bashkojë këtë ummet në (diçka) të gabuar.” Në këtë mënyrë, ai i inkurajonte njerëzit që të rrinin të lidhur me xhematin. Ky sahab dijetar gjithmonë dëshironte që ummeti i Muhamedit (a.s.), të mos përçahej dhe të ishte i bashkuar. (Dhehebi, Sijeru a’lami’n-nubela, II, 493-496.)

Ebu Mes’ud Ukbe ibn Amr el-Bedri (r.a.), ndërroi jetë në Medinetu’l-Munevvera në vitin 42 hixhri, 662 e.s.

Allahu qoftë i kënaqur prej tij! Allahu na e mundësoftë të gjithëve që të përfitojmë nga dashuria, nga mënyrë se si e pasonte Sunetin e të Dërguarit të Allahut, (a.s.), nga dija, nga gjendja e bukur dhe nga morali i lartë i tij! Amin!

Të gjithë atyre që shkonin për ta vizituar dhe për t’i kërkuar ndonjë sugjerim, u jepte këtë këshillë të rëndësishme:

“Ju këshilloj që t’i përmbaheni xhematit, sepse Allahu i Lartësuar nuk do ta bashkojë këtë ummet në (diçka) të gabuar.”





NDJESHMËRIA NDAJ HALLALLIT DHE HARAMIT

për të arrirë lumturinë në të dy botët

— B. Xhahit —

Në Kuranin Fisnik thuhet: *“...Ata që ndjekin të Dërguarin Tonë, Profetin që nuk di shkrim e lexim, të cilin do ta gjejnë të shënuar në shkrimet e tyre, në Teurat dhe Ungjill. Ai do t'i urdhërojë ata të bëjnë vepra të mira dhe do t'i ndalojë nga të këqijat; do t'ua lejojë të mirat e do t'ua ndalojë të këqijat, duke i liruar nga barrët e rënda dhe vështirësitë që kanë pasur. Prandaj, ata që do ta besojnë, përkrahin dhe nderojnë atë, duke ndjekur dritën që është zbritur me të, pikërisht ata janë të fituarit.”* (A'raf, 157)

“Hallalli përfshin fushën e lirë që nuk është e ndaluar. Në fundin e hallallit është “mubahu” që ka sevap për atë që e bën dhe që nuk ka mëkat për atë që nuk e bën. Pastaj vijnë me radhë si “mustehabi”, “vaxhibi” dhe “farzi”. Hallalli mbaron aty ku mbaron edhe mubahu. Pas kësaj vjen “mekruhu” dhe “harami”. I Dërguari i Allahut, (a.s.), në lidhje me haramin, hallallin dhe me gjërat e dyshimta, na paralajmëron në këtë mënyrë:

“Në të vërtetë, hallalli është i qartë dhe harami është i qartë. (Por) ndërmjet këtyre ka disa gjëra të dyshimta (që nuk është e qartë nëse janë hallall apo haram) që shumë njerëz nuk i dinë. Nisur nga kjo, kushdo largohet prej këtyre gjërave të dyshimta, do të thotë se e ka shpëtuar fenë dhe nderin e tij. Po ashtu, kushdo që zhytet në këto gjëra të dyshimta, gjithmonë është ballë për ballë me mundësinë për të hyrë në haram. Kjo është si shembulli e çobanit që i kullot bagëtitë rreth një vendi që nuk duhet të hyjnë. Ato çdo moment mund të hyjnë në atë vend. Kini kujdes: Çdo sundues ka një kufi. Kini kujdes: Kufiri që ka vendosur Allahu janë haramet. Kini kujdes: Në trup ka një copë mishi. Nëse kjo copë mishi është e shëndetshme, i gjithë trupi është i shëndetshëm. Nëse ajo prishet, prishet i gjithë trupi. Kini kujdes: Kjo (copë mishi) është zemra.” (Buhari, Muslim)

Nëpërkëmbja e mirësive dhe të drejtave që Allahu Teala ua ka dhuruar njerëzve, është prej mëkateve më të rënda. Ndërkohë që Allahu i Lartësuar i fal

mëkatet e bëra kundrejt Tij, faljen e padrejtësive të bëra kundrejt robërve të Tij e ka lidhur me miratimin a tyre. I Dërguari i Allahut, (a.s.), e shpreh kështu rëndësinë e kësaj çështjeje:

“Kushdo që t’i ketë bërë ndonjë padrejtësi vëllait të tij në fe në lidhje me nderin apo pasurinë, le t’i marrë hallallëk atij para se të vijë dita e kiametit në të cilën nuk do të ketë florinj dhe argjende. Përndryshe, nëse ai ka vepra të mira, i merren prej sevapeve aq sa ka bërë padrejtësi (dhe i jepen atij që i është bërë padrejtësia). Nëse nuk ka vepra të mira, i merren mëkatet atij vëllait që i ka bërë padrejtësi dhe i ngarkohen këtij.” (Buhari, Mezalim, 10; Rikak, 48.)

Maja e të gjitha aktiviteteve dhe sjelljeve të paligjshme që janë në kundërshtim të plotë me të drejtat publike që ndodhin nëpër shoqëri anarkiste, del te nëpërkëmbja e e të drejtave të njeriut. A mund të ndodhnin këto nëpërkëmbje të të drejtave të individit dhe shoqërisë si krimet në popull, çfarëdo lloj dhune, çfarëdo lloj vjedhjeje, uzurpimi, thashe-themeve dhe përgojimeve sikur të konceptohej siç duhet pesha e këtyre mëkateve?

Transmetohet se i Dërguari i Allahut, (a.s.), si fjalë të fundit në lidhje me çështjen e të drejtave të njeriut, ka thënë që: *“Të keni kujdes ndaj namazit, të mbrohen të drejtat e grave, të trajtohen mirë punëtorët dhe të çohen në vendin e tyre amanetet...”* (Xhamiu’s-Sagîr, vëll. 3, fq. 188/3190.) Civilizimi Islam që i ka dhënë famë të gjithë historisë, është i mbushur plot me shembujt e pafundmë të personaliteteve, të cilët i patën ushqyer zemrat e tyre me këtë burim hyjnor dhe të cilët i patën respektuar të drejtat e njeriut si amaneti më i shenjtë. Disa prej këtyre mund t’i radhisim kështu:

Umeri, (r.a.), kur e filloi hytben para namazit të një xhumaje duke thënë: “Dëgjoni dhe binduni!” – një person nga xhemati e kundërshtoi në këtë formë: “O Kalif! Nuk të dëgjojmë dhe nuk të bindemi. Ti së pari na shpjego se si e ke bërë këtë rrobë që ke veshur. Unë dhe ti patëm marrë të njëjtën copë nga “bejtu’l-mal”. Mua nuk më doli një rrobë nga copa që mora. Ty si të doli?”

Kalifi ia bëri me shenjë birit të tij dhe i kërkoi që të përgjigjej. Biri i tij, Hazreti Abdullahu tha: “Po, nga copa që morëm nuk dilte një rrobë. Për këtë arsye, copën time ia dhashë babait. Në këtë mënyrë, bëri rrobën e tij.” Pastaj personi kërkoi ndjesë duke thënë:

“Në rregull o Emiru’l-Mu’minin! Tani të dëgjojmë dhe të bindemi.” Ky inspektim i dyanshëm u

shndërrua në sigurinë e vazhdimësisë pa shkëputje të sistemit. Madje, u bë kurorë në kokë si rregull i drejtësisë edhe në luftëra, në një formë që bota e atëhershme nuk e kuptonte.

Kur Kanuni Sulltan Sulejmani përparoi drejt perëndimit, një fshatar në Hungari i doli përpara dhe i tha se “një ushtar i kishte futur paratë e një bistaku rrushi, të cilin e kishte këputur në vreshtin e tij, në një copë dhe i kishte lidhur në hardhi. Për këtë arsye, i tha se kishte ngelur i mahnitur nga ky virtut i lartë dhe se dëshironte t’i shprehte falënderimet e tij për këtë”. Sulltani jep urdhër që të gjendet menjëherë ky ushtar dhe të sillet para tij. Kur ushtari doli në audiencën e sulltanit, ai e njoftoi se ishte përjashtuar nga ushtria. Kur fshatari pa se ushtari u ndëshkua në vend se të shpërblehej, pyeti i habitur për shkakun. Sulltani i dha këtë përgjigje: “Sikur të mos i linte paratë e rrushit, ndëshkimi i tij do të ishte ekzekutimi. Në këtë mënyrë u ndëshkua ngaqë nuk ka marrë leje nga i zoti i vreshtit.”

Hazreti Sami Efendi (k.s.), i cili ishte një mik i Zotit në të cilin u konkretizuan cilësitë profetike, dihet se kishte një ndjesi të madhe në çështjen e hallallit dhe haramit. Ai u shprehte se kalbi selim / zemra e pastër arrihet vetëm me kafshatë hallall. Kur hipte në tren, i përgatiste paratë të thyera për të bërë pagesën, në mënyrë që të mos i vononte njerëzit. Ky është një shembull domethënës që tregonte ndjesinë e tij në lidhje me këtë çështje.

Muaji i madhërishtëm i Ramazanit është një kohë e begatë dhe produktive për myslimanët, në mënyrë që ta edukojnë vullnetin e tyre brenda kornizës së ndjeshmërisë ndaj hallallit dhe haramit. Në hadithin fisnik thuhet se në këtë muaj të bekuar “hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe lidhen shejtanët e tërbuar”.

Një individ që e ka shpirtin e stolisur me ndjeshmërinë e hallallit dhe haramit, është e pamundur që të shkelë të drejtat e njeriut dhe të bëjë ndonjë krim. Nëse çdo individ e mbart këtë virtut, do të thotë se shoqëria do ta arrijë paqen me flladet e epokës së lumturisë. Ja, kjo është pikërisht kohë që të jep mundësinë për të shpëtuar nga ky qorrso-kak. Me disiplinën e agjërimit, ndjeshmërinë ndaj hallallit dhe haramit mund ta bëjmë sërish shtyllën themelore të jetës sonë shoqërore. Madje, duke kërkuar më të përsosurën dhe duke mbajtur agjërimitin “ehassu’l-havas” në të cilin zemrat i nënshtrohen kësaj discipline dhe i drejtohet plotësisht Allahut Teala. As shoqëria jonë, as bota Islame dhe as njerëzia nuk ka asnjë lloj shpëtimi tjetër përveç këtij.

...sepse, te njeriu, ajo qe nuk matet
është më e rëndësishme nga e matshmja.
(Alexis Carrel)

Mbi librin “Njeriu – kjo qenie e panjohur”

— Edison Çeraj —

Kur trajtohet një anomali/çrregullim i caktuar në trupin e njeriut, gjithmonë ka dhe duhet të ketë vend edhe për anën tjetër të medaljes: anën shpirtërore dhe mendore. Për aq sa jemi gjallë, të gjitha këto marrin e japin me njëra-tjetrën pa reshtur as një sekondë, duke lënë gjurmë mbi njëra-tjetrën, diku të dukshme, diku të ndjeshme.

Alexis Carrel na kujton se “ndarja midis cilësisë dhe sasisë u thellua edhe më shumë kur Descartes-i krijoi dualizmin e trupit dhe të shpirtit. Qysh atëherë shfaqjet e shpirtit u bënë të pashpjegueshme dhe materia u nda në herë e mirë nga shpirti; strukturat organike dhe mekanizmat fiziologjikë morën një rëndësi shumë më të thellë se mendimi, kënaqësia, dhimbja dhe bukuria”.

Kështu, mjekësia moderne i sheh dhe i trajton si të ndarë trupin, shpirtin dhe mendjen, ndërkohë që ato i takojnë një qenieje të vetme: njeriut, gjë që anashkalohet si pa të keq në një mënyrë kaq masive, dhe mbi të gjitha të mirëkonceptuar e të mirëmenduar.

Duke pasur parasysh këtë, është e padrejtë që këta “përbërës” bazë që bëjnë qenien njeri të studiohen dhe të trajtohen të ndarë, veçmas njëri-tjetrit, sikur nuk kanë asnjë lidhje ndërmjet tyre.

Alexis Carrel është nga ata autorë që na kujton për këtë të vërtetë të mënjeluar nga qytetërimi modern, në veçanti me librin *Njeriu – kjo qenie e panjohur*. Pavarësisht se është shkruar rreth një shekull më parë, shqetësimi i ngritur nga Carrel mbetet po ai, madje gjendja është rënduar edhe më shumë, pasi ka ardhur duke u skematizuar në “fusha kompetence” të ndara me bisturi.

Ky libër na kujton se jeta nuk është një fenomen, por një mrekulli, pavarësisht se, le të themi, edhe me fenomene përbrenda. Në një vështrim makro, Toka dhe jeta në të, sipas shkencave natyrore, nuk janë gjë tjetër përveçse një pikë mikroskopike në një univers të pafund, domethënë në një errësirë të pafundme. Ishte feja dhe *krijimtaria* artistike ajo që mbolli te njeriu vetëdijen se ai është qendra e universit, stolia e *krijimit*.

Mistikët do të na thonë vazhdimisht se çdo çrregullim në trupin e njeriut është pasojë e mëkateve, kurse mjekët do të thonë gjithnjë se çrregullimet shfaqen si pasojë e kequshqyerjes, ose e ajrit të ndotur, ose e mungesës së ushtrimeve fizike, ose e trashëgimisë gjenetike e kështu me radhë.¹

Por, e vërteta është se të dyja palët kanë të drejtën përkatëse, pavarësisht se në pamje të parë janë dy të vërteta që e përjashtojnë njëra-tjetrën, sidomos pas dualizmit që bëri Descartes-i mes trupit dhe shpirtit, gjë që e ndikoi ndjeshëm rrjedhën e mendimit perëndimor në përgjithësi.

Nuk ka rëndësi se çfarë quan “mëkat” një mistik apo një shkencëtar, ose kushdo tjetër, por çfarë është “mëkat” në vetvete, domethënë çfarë i kundërvihet jetës si të tillë. Pa dashur të bëjmë një histori të mëkatit, nuk kemi ndonjë zbulim të ri në këtë drejtim: mëkatet vazhdojnë të mbeten po ato që kemi trashëguar qysh prej kohësh që s’mbahen mend, më saktë: që në zanafillë. Tetë nga dhjetë Urdhëresat janë ndalesa.

Pra, nuk ka nevojë ta thotë dikush që, fjala vjen, të mashtrosh është mëkat, sepse vetë jeta si e tillë e provon këtë. Kështu, *mëkati* nuk është shpikje e ndonjërit, pavarësisht se ai bëhet krejtësisht absurd nëse nuk e lidhim me njeriun. “Mëkati”, ose “e ndaluara” është e kundërta e jetës dhe njëkohësisht prova e pashmangshme e lirisë, sepse njeriu zgjedh të bëjë mëkat ose jo, ose heq dorë prej tij, dhe në këtë mënyrë provon lirinë, pikërisht përmes aktit të zgjedhjes. Nuk ka zgjedhje kur çdo gjë është e lejuar, pra kur nuk ekziston ideja dhe përjetimi i të ndaluarës/mëkatit.

Çështja nuk është që mistikët dhe mjekët duhet të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin për të kuruar trupin e njeriut, apo vetë njeriun si të tillë, por që çdo mistik duhet të jetë pak mjek dhe çdo mjek ka nevojë të jetë pak mistik. Ata duhet të kujtohen se njeriu është më shumë se trup dhe më shumë se shpirt.

1. Vetëm këto janë mëkate sipas qytetërimit. Por, gjithsesi, një vetëdije e caktuar për mëkatin është e pashmangshme edhe në këtë rast, pavarësisht se me emra të tjerë, dhe si rrjedhojë edhe me një tjetër përmbajtje, që e zbret nga e shenjtja drejt profanes.

Dashuria e lules për ujin

— Ferudun Ozdemir —

Një ditë lulja dhe uji u takuan së bashku dhe vendosën të ndërtonin një miqësi të singertë. Koha kaloi natyrshëm dhe lulja lëshoi shtat në saje të ujit pa të cilin nuk mund të qëndronte. Miqësia e tyre dita ditës shtoej dhe lulja e kuptoi se tanimë ishte dashuruar pas ujit.

Përhapte anë e kënd aromë të mirë e shfaqte bukurinë e saj para ujit duke thënë: “Veç për ty e bëj këtë, o ujë!”

Me kalimin e kohës edhe uji fillon të ndjejë diçka për lulen, pandehu se edhe ai është dashuruar pas saj. Ditët e muajt ndoqën njëra-tjetrën dhe uji nuk po tregonte ndonjë interesim të madh për lulen prandaj filloi të mendojë: “A thua vallë edhe uji më do ashtu siç e dua unë?”

Me padurim lulja i tha:

“-Të dua shumë!”

“-Edhe unë të dua!” - u përgjigj uji.

Nuk kaloi shumë dhe lulja përsëri tha:

“-Të dua shumë!”

“-Edhe unë!” - u përgj përsëri uji.

Lulja u tregua e durueshme, priti, priti dhe përsëri priti, por erdhi një kohë që tashmë lulja nuk kishte më fuqi të përhapë aromë e bukuri dhe për të fundit herë tha:

“-Te dua shumë!”

“-Të thashë pra, edhe unë!- u përgjigj uji me një farë nënçmimi...”

Tashmë lulja ishte sëmurë... Kishte humbur aromën dhe bukurinë e dikurshme... Ndërsa uji i merakosur për gjendjen e saj priti me shpresën për ta riparë ashtu të bukur e të hijshme si dikur. Por pa dobi... Ishte e qartë që lulja po vdeste dhe për herë të fundit ajo bëlbëzoi:

“Me të vërtetë që unë të dua!”

Uji u pikëllua aq shumë nga kjo gjendje dhe thirri një doktor si të vetmen shpresë për t'i ardhur në ndihmë lules.

Pasi e vizitoi doktori tha që gjendja e lules është e pashpresë dhe nuk kishte mbetur më asgjë për të bërë... Uji u habit dhe kërkoi të mësonte të paktën arsyen e sëmurjes së të dashurës së tij, lules. Doktori i hedhi një vështrim ujit dhe i tha:

“Shiko or mik! Lulja nuk ka asnjë sëmundje. Ajo thjeshtë paska mbetur pa ujë!...”

Edhe pse shumë vonë uji e kuptoi që nuk kishte mjaftuar vetëm t'i thoshte lules: “Të dua...!”

Përktheu dhe përshtati: Elona SYTARI

"Por ju doni këtë jetë (kalimtare)
e për jetën tjetër nuk kujtoheni!"

(Kijame, 20-21)

Kurani nuk e mohon rëndësinë e të mirave materiale në rrugën e pjekurisë shpirtërore por as nuk e pranon si thelbësore duke përjashtuar botën shpirtërore. Kurani ka vendosur një ekuilibër ndërmjet shpirtërores dhe materies pa anashkaluar asnjërën. Si rrjedhojë e kësaj filozofie, Kurani i fton besimtarët të dëshirojnë të mirat tokësore dhe botës tjetër. Kurani i nxit besimtarët të përfitojnë nga të mirat e kësaj bote. Çdo e mirë në këtë botë është krijuar për njerëzit. Kurani e shpall të gabuar idenë e braktisjes së plotë të të mirave materiale. Por në të njëjtën kohë Kurani nuk lë pa theksuar edhe anën joshëse dhe të rremë të kësaj bote. Njeriu ka një lakmi të pashuar për të mirat e kësaj bote. Të mirat tokësore duke qenë tërheqëse dhe magjepsë mund të bëhen shkak që njeriu të largohet nga adhurimi i Allahut e për pasojë të humbë lumturinë e përjetshme. Kurani shpesh i tërheq vëmendjen besimtarëve për rrezikun që përbën lakmia e madhe mbas jetës së kësaj bote. Vazhdimisht u kujton atyre që të mos shesin jetën e përhershme në këmbim të mirave të përkohshme të kësaj jete. Kur nevojat materiale dhe biologjike janë dominante, njeriu në përgjithësi përvetëson një jetë hedoniste, të bazuar në kënaqësitë e kësaj bote duke e mohuar ose duke mos e marrë seriozisht botën e përtejme. Kënaqësinë e kësaj bote e bën moto të jetës së tij. Në periudhat kur kanë jetuar pejgamberët kanë dominuar vlerat shpirtërore dhe e gjithë jeta ishte rregulluar sipas këtyre vlerave. Ata nuk e konsideronin botën qëllim në vetvete por mjet për të arritur lumturinë e përhershme në xhenet duke mos lejuar në asnjë mënyrë që joshja e kësaj bote ti

pengonte nga adhurimi.

Sekularizmi është karakteristikë e natyrshme e atyre që nuk besojnë në botën tjetër. Sepse sipas tyre lumturia, gëzimi dhe kënaqësia është vetëm në këtë botë. Por kjo sëmundje prek edhe ata që besojnë siç e evidenton edhe Kurani me rastin e Jahudive të cilët nga njëra anë besonin se parajsën e meritonin vetëm ata kurse nga ana tjetër ishin më të dhënë mbas kësaj jete se sa idhujtarët. Fatkeqësisht sekularizmi ka prekur edhe myslimanët si një sëmundje epidemike. Kjo ndodh sepse praktikimi dhe zbatimi i ajeteve Kuranore në jetë është bërë diçka e rrallë. Njerëzit megjithëse besojnë në botën tjetër dhe shpërblimin në të, jetojnë në këtë botë sikur nuk besojnë në ekzistencën e saj. Nuk respektojnë normat Kuranore mbi të lejuarën dhe të ndaluarën. Preukopimet e kësaj botë i pengojnë nga kryerja e detyrimeve bazë të fesë islame. Kënaqësinë e kësaj bote e kanë pranuar si qëllimin e vetëm të kësaj bote. Njerëzit e sotëm sipas evidentimeve të Kuranit po digjen e përvëlohen në zjarrin e lakmisë dhe ambicieve për këtë botë duke garuar për të mbledhur sa më shumë pasuri me shpresën se ajo mund t'i bëjë të pavdekshëm. Myslmanët janë dhënë mbas kënaqësive të kësaj botë pa marrë parasysh as një vlerë islame duke u shndërruar në një turmë konsumatore. Allahu duke e ditur këtë dobësi të njeriut vazhdimisht i tërheq vëmendjen besimtarëve për rrezikun që përbën dhënia e plotë mbas kësaj bote. Kurani e konsideron thjesht një lojë dhe argëtim të çastit jetën në këtë botë, prandaj besimtarët nuk duhet të gënjehen nga kënaqësitë e përkohshme të kësaj bote.

Transmetohet nga En-Nu'man ibn Beshir (r.a.)
se Pejgamberi (a.s.) ka thënë:

*"Besimtarët në mëshirë, dashuri e miqësi me njëri-tjetrin
janë si një trup i vetëm, nëse sëmuret një organ
edhe pjesët e tjera të trupit shqetësohen
dhe mbarë organizmi vuan nga dhembjet, pagjumësia
dhe temperatura e lartë".*

Pejgamberi a.s i këshillon besimtarët të jenë të mëshirshëm, të dashur e dhembshur ndërmjet tyre duke i përngjasuar besimtarët me një organizëm të vetëm e të gjallë. Është e vështirë të gjesh një frazë që e shpreh në mënyrë kaq lakonike dhe të bukur gjendjen e besimtarëve me njëri-tjetrin. Përsëri në një hadith tjetër Pejgamberi a.s i ka përngjasuar besimtarët me një ndërtesë të cilët janë të lidhur me njëri tjetrin siç janë gërshetuar tullat me njëra tjetrën për të mbajtur ndërtesën në këmbë.

Kurani në ajete të ndryshme deklaron se besimtarët janë vëllezër të njëri-tjetrit. Muhamedi a.s arriti të bashkonte të gjithë arabët në një umet të vetëm duke zhdukur çdo lloj ndasie që cenonte bashkimin si dallimet fisnore, etnike etj. dhe për ta ruajtur e mbajtur gjallë vëllazërinë na këshilloi të kapemi fort mbas Kuranit dhe fjalës Profetike.

Bashkësisë islame është e detyruar të jetë si një gërshetim organik. Vëllazëria ndërmjet besimtarëve është edhe një siguri për paqen botërore. Sepse Feja islame ndërsa thekson vëllazërinë ndër-

mjet besimtarëve është shumë tolerante edhe me grupet e tjera jashtë saj.

Feja islame në iniciativën për të ndërtuar një shoqëri nuk ka marrë për bazë dallimet etnike apo sociale por ka marrë vlerat fetare dhe njerëzore. Kjo është arsyeja që me gjithë provokacionet e shumta për ti përçarë grupe të ndryshme etnike kanë jetuar në paqe dhe harmoni me njëri tjetrin për shekuj me radhë.

Islami i shikon të gjithë popujt mysliman si një bashkësi e vetme duke ushqyer dashuri, mëshirë dhe harmoni për njëri tjetrin pa bërë asnjë dallim. Për rrjedhojë një problem i një myslimani është problem i çdo myslimani. Prandaj identitetin islam duhet ta mbajmë lartë në çfarë do lloj situatë që të përballemi. Neve si besimtarë na kërkohet të ndihmojmë besimtarët pa kushte dhe parapëlqime përndryshe shndërrohemi në anëtarë të një organizate dhe kurrë një pjesëtarë të një bashkësie islame. Dashuria, mëshira dhe ndihma ndaj vëllezërve është tregues i një besimi të fortë.

MËSIMET QË NXJERRIM NGA HADITHI:

1. Besimtarët në dashuri, mëshirë dhe në ndihmë ndaj njëri-tjetrit duhet të jenë si një trup i vetëm.
2. Njerëzit duhet të ndajnë gëzimet dhe hidhërimet së bashku.
3. Bashkësia islame është si një trup i vetëm, kur sëmuret një organ shqetësohet i gjithë trupi.

Një Hadith



UDHËTIMI I PËRJETËSISË

- P J E S A I X -

MIRËSITË E VARRIT

Besimtarët e devotshëm të cilët e jetojnë jetën e kësaj bote në përputhje me urdhrat e Allahut të Madhëruar, duke e kthyer atë në kapitalin e jetës së përjetshme, në varr do të kenë mirësi të cilat i di dhe i dëshiron Vetë Allahu i Madhëruar.

Ata el-Horasanî ka thënë:

“Koha kur Allahu e mëshiron më tepër robin e Vet, është çasti kur ai vendoset në varr dhe të afërmit ndahen prej tij.” (Kurtubî, Tezkire, fq. 345.)

Lidhur me mirësitë që besimtari do të gëzojë në varr, mund të themi se:

Varrî i besimtarit do të zgjerohet, do të mbushet me mirësi dhe do të marrë formën e njërit prej kopshteve të Xhenetit. Po ashtu, besimtarit do t’i tregohet vendi i tij në Xhenet. Ndërsa profetët dhe shehidët (dëshmorët) do të furnizohen menjëherë me mirësitë e Xhenetit.

I Dërguari i Allahut, (a.s.), na ka bërë të ditur se profetët janë të gjallë në varr dhe aty falin namaz.¹ Profeti ynë (a.s.) thotë se gjatë Isras dhe Miraxhit i ka parë profetët Musa, Isa dhe Ibrahim (alejhiumu’s-Selam) duke falur namaz. Madje, kur ka ardhur koha e namazit, vetë Profeti (a.s.) ka dalë imam dhe u ka falur namazin të gjithë profetëve. (shih. Muslim, Iman, 278.)

Në hadithet fisnike thuhet:

“Profetët janë të gjallë në varret e tyre dhe aty falin namaz!” (Hejthemî, VIII, 211.)

1. shih. Muslim, Iman, 278. Krah. Ebu Nuajm, Hilje, II, 319; Ibnu’l-Xheuzi, Sifatu’s-Safue, III, 263.

“Natën e Israsë shkova tek Musai, i cili gjendej pranë kodrës së rërës së kuqe. Ai ishte ngritur prej varrit të tij dhe po falte namaz.” (Muslim, Fedail, 164.)

Gjithashtu ka edhe prej besimtarëve që kanë gëzuar të tilla mirësi. Shejban ibn Xhîr transmeton kështu prej babait të vet:

“Betohem në Allahun, përveç të Cilit nuk ka zot tjetër se, Sabit el-Bunanin (i cili ka qenë 40 vite nxënës i Enesit -r.a-) e kam varrosur unë vetë. Pranë meje ka qenë Humejd et-Tauili dhe dikush tjetër. Pjesën e sipërme të varrit e rregulluam me tulla. Në një moment, një tullë ra nga vendi i vet. Kur ç’të shoh! Sabiti po falte namaz në varrin e tij. Atij që kisha afër i thashë:

«Pa shiko!»

Ndërsa ai tha: «Hesht!»

Pasi rregulluam varrin, shkuam tek vajza e Sabitit dhe e pyetëm:

«Çfarë vepre ka bërë më shpesh babai juaj kur ka qenë gjallë?»

Ndërsa ajo na pyeti: «Çfarë patë?» Pasi i treguam atë që pamë, vajza e Sabitit tha:

«Babai im kishte 50 vite që ngrihej natën dhe falte namaz nafîle. Kur vinte koha e agimit bënte dua dhe thoshte:

O Allah! Nëse dikujt prej robërve të Tu i ke dhënë mundësinë që të falë namaz në varr, ma jep edhe mua!..» (Ebu Nuajm, Hilje, II, 319; Ibnu’l-Xheuzi, Sifatu’s-Safue, III, 263.)

Megjithëse për të vdekurin nuk mbetet më asnjë përgjegjësi, ky namaz që falin profetët dhe disa prej



robërve të devotshëm buron prej dashurisë ndaj adhurimit të Allahut të Madhëruar dhe kënaqësisë shpirtërore që ndihet nga falja e namazit.

Siç lajmërohem edhe në hadithe të ndryshme, i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë se ka parë disa profetë që kanë shkuar në haxh duke bërë telbije² dhe duke bërë tavaf Qabenë.³

Një prej mirësive të varrit do të shfaqet edhe si rezultat i angazhimit të njeriut me Kuranin në këtë botë. Lidhur me këtë, Ebu Said el-Hudri (r.a.) thotë:

“Kush lexon Kuran dhe ndërron jetë pa e mësuar përmendësh (megjithëse e ka dashur me gjithë shpirt), atij do t’i vijë një melek në varr dhe do t’ia mësojë. Në këtë mënyrë, ai njeri do të dalë para Allahut me Kuranin e mësuar përmendësh.”⁴

Ndërsa i nderuari Hasan Basriu thotë:

“Sipas një lajmi që më ka mbërritur, nëse një besimtar ndërron jetë pa e mësuar përmendësh Kuranin (megjithëse e ka dëshiruar shumë), melekët e memorizimit do të urdhërohen që t’ia mësojnë atij Kuranin në varr. Në këtë mënyrë, në ditën e Kiametit, Allahu i Madhëruar do ta ringjallë atë me njerëzit e Kuranit.”⁵

Po ashtu, sipas një transmetimi, ata që kalonin pranë varrit të Sabit el-Bunanit në kohën e agimit, kanë dëgjuar lexim Kurani.⁶

Duhet të theksojmë se ka mendime të ndryshme lidhur me entitetin që do të përfshijë në varr vuajtjet ose mirësitë, diskutimet lidhen me çështjen se a do t’i ndjejë njeriu ato me shpirt apo edhe me trup!

Megjithëse dijetarët selefë thonë se është e pamundur që jeta e varrit të vlerësohet siç duhet në aspektin e natyrës së saj, disa prej tyre mendojnë se jeta e varrit do të përfshijë vetëm me trup, e disa të tjerë mendojnë se do të përfshijë vetëm me shpirt.


Ibn-i Hazm dhe Ibn-i Kajjim el-Xheuzijje, mbrojnë mendimin se vuajtjen apo mirësinë në botën e varrit do ta perceptojë vetëm shpirti.

Sipas shumicës së dijetarëve të ehl-i sunnetit, llogaria, dënimi dhe mirësitë në varr do të përfshihen edhe me shpirt edhe me trup, sepse në disa hadithe fisnike na është bërë e ditur se gjatë llogarisë shpirti tashmë është kthyer në trup. (shih. Ebu Daud, Sunnet, 23.)

Shumica e dijetarëve Esh’ari dhe Maturidi thonë se në trupin e të vdekurit do të krijohet aq jetë, sa ai mund të ndjejë dhimbjen e dënimit dhe shijen e mirësive. Por ata kanë ngurrar të thonë se shpirti do t’i kthehet trupit në mënyrë të njëjtë siç ka qenë, duke theksuar se në lidhje me jetën e të vdekurit në varr është e pamundur të dihet diçka në

mënyrë të prerë. Ndërsa shkaku që mbi kufomën e të vdekurit nuk shihen gjurmët e dënimit apo mirësisë, është se shqisave tona nuk u është dhënë aftësi për të perceptuar botën e varrit.

Domethënë se natyra e jetës së varrit do të kuptohet në mënyrë të qartë vetëm kur të përfshijë. Të dhënat në lidhje me të, në Kuran dhe Sunnet, janë pasqyruar në bazë të botëkuptimit njerëzor me modele të kësaj bote. Kuptimi i natyrës së saj të vërtetë është përtej mundësive të mendjes së



Varri i besimtarit do të zgjerohet, do të mbushet me mirësi dhe do të marrë formën e njërit prej kopshteve të Xhenetit. Po ashtu, besimtarit do t’i tregohet vendi i tij në Xhenet. Ndërsa profetët dhe shehidët (dëshmorët) do të furnizohen menjëherë me mirësitë e Xhenetit.

2. Telbije: Shprehje që e thonë haxhinjtë që shkojnë në umre ose në haxh: Lebbejk Allahumme lebbejk, lebbejke la sherike leke lebbejk, innel hamde uenni’mete leke uel mulk, la sherike lek.

3. shih. Buhari, Libas, 68; Muslim, Iman, 268; Ahmed, I, 232; Hakim, II, 638/4123.

4. shih. Sujuti, Bushra’l-Keib bi Likai’l-Habib, Dimashk 1425, fq. 48.

5. shih. Sujuti, Bushra’l-Keib bi Likai’l-Habib, fq. 48; Bursevi, Ruhul-Bejan, [Nisa, 100.]

6. shih. Ebu Nuajm, Hilje, II, 322; Ibnu’l-Xheuzi, Sifatu’s-Safue, III, 263.

kufizuar njerëzore. Gjithsesi, detyra kryesore e besimtarit nuk është të hetojë rreth natyrës së botës së varrit por të merret me përgatitjen për atë botë. Shembull i kësaj, është rasti kur një sahab e pyeti Profetin (a.s.):

“Kur do të bëhet Kiameti?”, e ai iu përgjigj shkurt:

“Çfarë ke përgatitur ti për Kiametin?”⁷

Pra detyra kryesore e besimtarit, nuk është të merret me aspektin e natyrës së jetës së varrit dhe të Ahiretit, gjë e cila nuk është përgjegjësi e tij, por të merret me përgatitjen për atje, sepse kjo duhet t’i interesojë më shumë.

Derisa vjen në këtë jetë, njeriu kalon nëpër botë me natyra të ndryshme. Po kështu, me vdekjen ai do të lindë në një botë me natyrë plotësisht të ndryshme. Mbase edhe Ahireti do të jetë një botë me natyrë krejtësisht ndryshe nga ajo e varrit. E mbase, Zoti ynë i Madhëruar do të na japë edhe shqisa e aftësi kuptimi të ndryshme për çdo botë në të cilën kalojmë.

Shkurtimisht, lidhur me këto çështje, të cilat i kalojnë kufijtë e dijes dhe kuptimit njerëzor, është më e saktë të themi: “لَا يَعْلَمُ الْغَيْبَ إِلَّا اللَّهُ / Askush nuk e di të fshehtën përveç Allahut” dhe “الله أعلم بالصواب / Allahu e di më së miri të drejtën”.

ATYRE TË CILËVE NUK U PRISHET TRUPI NË VARR

Allahu i Madhëruar e ka krijuar njeriun prej dheut⁸ dhe gjatë gjithë jetës e ushqen dhe e zhvillon atë me ushqime që dalin prej tij. Po ashtu, edhe kur të vdesë, njeriu do të kthehet në tokë. Allahu i Madhëruar urdhëron:

“Ne ju kemi krijuar prej tokës, aty do t’ju kthejmë dhe nga ajo do t’ju nxjerrim edhe një herë tjetër.” (TaHa, 55.)

Kjo e vërtetë tregon se trupi i njeriut është i dënuar të jetë i përkohshëm me fazat që përjeton në dynja dhe gjendjet e tij personale. Dhe për shkak se struktura e tij materiale është prej dheut, trupi i njeriut në varr do të shndërrohet përsëri në dhe,

duke u kthyer kështu në origjinën e vet.

Mirëpo, Allahu i Madhëruar nuk do t’i prishë trupat e disa prej robërve të Tij në jetën e berzahut, por do t’i ruajë ata të freskët. Në krye të këtyre robërve vijnë profetët.

Sipas rrëfimit të Eus ibn Eus (r.a.), i Dërguari i Allahut, (a.s.) ka thënë:

“Dita më e virtytshme për ju është dita e Xhuma. Prandaj atë ditë lutuni shumë për mua për paqe e mëshirë, sepse lutjet tuaja më tregohen mua!”

Atëherë, sahabët e pyetën:

“O i Dërguari i Allahut, si do të tregohen lutjet tona pasi të vdesësh e të mos mbetet asnjë gjurmë nga ti?”

Profeti (a.s.), u përgjigj:

“Allahu i Madhëruar ia ka ndaluar tokës t’i kalbë trupat e profetëve!” (Ebu Davud, Salat, 201; shih. Nesai, Xhuma, 5)

Ndërsa në një transmetim tjetër thuhet:

“Po, edhe pas vdekjes sime do të më dërgohen salatet dhe përshëndetjet tuaja! Allahu i Madhëruar ia ka ndaluar tokës të hajë trupat e profetëve. Profeti i Allahut është i gjallë dhe furnizohet vazhdimisht.” (Ibn-i Maxhe, xhenaiz, 65.)

Po ashtu, ka pasur edhe dëshmi të gjalla se trupat e profetëve ruhen pa u prishur. Për shembull, në një kohë të afërt, atëherë kur po ndërtohej Hidrocentrali i Dixhles⁹, i cili ujit një pjesë të rëndësishme të Luginës Diyarbakir në Turqi, për shkak të përmytjes që do të ndodhte, varret e Eljesas (a.s.) dhe Dhulkiflit (a.s.), që ishte djali i xhaxhait të tij dhe pasardhësi i tij, u transferuan në një varr të ri në një kodër që ndodhej në atë zonë. Siç dëshmohej edhe prej atyre që u morën me procesin e transferimit të varreve, të dy trupat e profetëve ishin si të gjallë.¹⁰

Një kategori tjetër njerëzish, trupat e të cilëve nuk treten nga toka, janë shehidët/dëshmorët që kanë rënë në luftë për hir të Allahut. Sot, në vende

9. - Hidrocentral mbi një degë të lumit Tigër, në Diyarbakir të Tu - qisë.

10. shih. Altunoluk Dergisi, Temmuz 2014, sayı 341, fq. 48.

7. shih. Muslim, Birr, 163.

8. “Një prej shenjave të Tij është që Ai ju krijoi prej dheut...” (Rum, 20.)



të ndryshme rastisen trupa të shëhidëve, të cilët qëndrojnë të paprishur në varret e tyre.

Në Kuranin Fisnik urdhërohet:

“Kurrsesi mos i quani të vdekur ata që janë vrarë në rrugën e Allahut. Jo, janë të gjallë, duke u ushqyer te Zoti i tyre. Janë të gëzuar për çfarë u ka dhënë Allahu nga dhuntitë e Tij dhe gëzohen edhe për ata që ende nuk u janë bashkuar e që kanë ngelur pas tyre (dhe ende nuk kanë rënë martirë), sepse nuk do të frikësohen (për çfarë i pret) dhe nuk do të pikëllohen (për çfarë kanë lënë pas).” (Al-i Imran, 169-170.)

Por padyshim se gjallëria e profetëve, është më superiore në krahasim me atë të shëhidëve. Përveç profetëve dhe shëhidëve, është vërtetuar me argumente të transmetuara dhe dëshmi të gjalla se

“Dita më e virtytshme për ju është dita e Xhuma. Prandaj atë ditë lutuni shumë për mua për paqe e mëshirë, sepse lutjet tuaja më tregohen mua!”

toka nuk i tret as trupat e robërve të mirë, zemra e të cilëve është e mbushur me dashuri për Allahun dhe të Dërguarin e Tij, (a.s.), dhe që janë ruajtur gjatë gjithë jetës së tyre prej haramëve dhe gjërave të dyshimta, duke u ushqyer me kafshatë hallall dhe devotshmëri të lartë ndaj Allahut të Madhëruar. Ja disa shembuj prej kohës së myslimanëve të parë:

Në kohën e Uelid ibn Abdulmelikut, muri i dhomës së nënës sonë Aishe (r.a.), ishte shembur mbi varrin e Profetit tonë (a.s.) dhe shokëve të tij.¹¹ Gjatë punimeve për rindërtimin e murit u shfaq këmba e njërit prej të vdekurve. Të gjithë u frikësuan dhe pandehën se ishte këmba e bekuar e të Dërguarit të Allahut, (a.s.). Mirëpo Urue ibn Zubejri shkoi atje dhe vërejti:

“Jo, për Allahun kjo nuk është këmba e bekuar e Profetit (a.s.)! Kjo është këmba e Omerit (r.a.).” (Buhari, Xhenaiz, 96.)

Xhabir ibn Abdullah (r.a.), transmeton:

“Një natë para betejës së Uhudit, im atë më thirri pranë dhe më tha:

«Më duket se unë do të jem i pari nga sahabët e Profetit (a.s.) që do të bie dëshmor. Me përjashtim të të Dërguarit të Allahut, (a.s.), për mua ti je personi më i çmuar që do të lë pas. Kam borxhe; paguaji ato dhe sillu gjithmonë mirë me vëllezërit!»

Në mëngjes, im atë që personi i parë që ra dëshmor. E varrosa atë në një varr bashkë me një dëshmor tjetër. Pastaj desha ta varros më vete në një vend tjetër. E nxora nga varri gjashtë muaj më vonë, por ç’të shihja?! Përveç një pjese të njërit vesh, i gjithë trupi ishte si atë ditë kur e pata varrosur për herë të parë! Më pas e varrosa në një varr më vete!” (Buhari, Xhenaiz, 78)

Kjo pra është gjendja e veçantë e besimtarëve të sinqertë!..

Po ashtu, edhe dy prej dëshmorëve të Uhudit, Amr ibn Xhemuh dhe Abdullah ibn Amr (r.anhuma), ishin varrosur në një varr. Vendi kur ishin varrosur ishte pikërisht në rrjedhën e ujërave të përrënjeve.

11. - Varri i Profetit tonë (a.s.), gjendet pranë varreve të Ebu Bekrit dhe Omerit (r.anhuma), brenda Xhamisë së Profetit (a.s.), në Medinë.



Për këtë arsye ishte i nevojshëm ndërrimi i vendit të varreve. Kur u hapën varret, u vu re se trupat e këtyre dy dëshmorëve qëndronin të paprishur, sikur të ishin varrosur një ditë më parë. Madje, njëri prej tyre që ishte plagosur para se të binte dëshmor, kishte vënë dorën mbi plagë dhe në atë mënyrë ishte varrosur kur vdiq. Ata që po merreshin me zhvarrimin, u përpoqën t'ia shtrinin dorën, por ajo shkoi përsëri atje ku ishte. Mirëpo, që nga koha e betejës së Uhudit e deri në kohën e hapjes së varreve kishin kaluar dyzetegjastë vite.¹²

Trupat e shehidëve ishin të butë dhe kur u ngritën ata përkuleshin e përthyeshin si trupat e njerëzve të gjallë. Pra nuk ishin ngurtësuar aspak. Në një moment, lopata e njërit prej punonjësve goditi padashje këmbën e njërit prej dëshmorëve dhe prej saj filloi të rridhte gjak. (shih. Abdu'r-Razzak, Musannef, III, 547.)

Një shembull tjetër lidhur me faktin se toka nuk i tret trupat e robërve të devotshëm që kanë jetuar në përputhje me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar, është edhe ai i një muezini hafiz, i cili ka qenë një besimtar shumë i devotshëm, nga Adana e Turqisë. I nderuari Mahmud Sami Ramazanoglu (Allahu e mëshiroftë) tregon se gjatë punimeve për hapjen e një rruge në Adana, ka qenë dëshmitar okular në hapjen e varrit të një hafizi që kishte vdekur para 30 vitesh. Trupi i tij nuk ishte prishur aspak. Mbi të gjitha edhe qefini i tij ishte shumë i pastër.

Kjo ndodhi tregon se edhe njerëzit që janë angazhuar shumë me Kuranin dhe kanë qenë hafizë të vërtetë, do të gëzojnë shumë mirësi të Allahut të Madhëruar, si në këtë botë, ashtu edhe në botën tjetër.

Në lidhje me natyrën e begatisë së shërbimit të bërë ndaj Kuranit të Shenjtë, hoxha i nderuar Emin Saraç përcjell prej Abdylkadir Beklit, që ishte një prej njerëzve të nderuar të Medinës, një rrëfim plot kuptim dhe urtësi të shënuar edhe në Protokollet e Gjykatës Juridiko-fetare vendase:

Ishte sezoni i haxhit. Në Medinë u nxor në ankand një tekst i Kuranit të Shenjtë, i shkruar me një shkrim mjaft të bukur. Haxhinjtë e ardhur nga vende të ndryshme shihnin shkrimin e tij të hijshëm dhe ofronin nga një çmim. Ndërkohë, një haxhi turk afrohet me kureshtje tek teksti i Kuranit, pasi e sheh dhe e njeh shkrimin e tekstit, bërtet i mahnitur:

“Po ky është Kurani i Shenjtë i shkruar prej tim eti!”

Dhe shton:

“Mirëpo ne ia patëm vendosur Kuranin në varr, sipas amanetit që pati lënë ai vetë!”

Haxhiu turk u përpoq të zgjidhë misterin e kësaj ndodhie. Pasi kjo iu tregua personave përgjegjës që kishin pasur lidhje me ngjarjen, dolën në pah këto të dhëna:

Meqë në varrezën “Xhennetul Baki” të Medinës nuk kishte më vend, ishte bërë praktikë që herë pas here, në vendin e varreve të vjetra të bëheshin varrime të reja. Kështu që kur kishin hapur një varr, pak a shumë të vjetër, për të varrosur një person të porsavdekur, kishin vënë re se trupi i të vdekurit të mëparshëm kishte mbetur i paprishur fare dhe mbi të ndodhej një tekst i Kuranit. Të gjithë të pranishmit kishin mbetur të mahnitur! Personat e ngarkuar me këtë detyrë, e kishin hequr tekstin e Kuranit nga varri. Pasi ishin këshilluar me njëri-tjetrin, kishin vendosur ta nxirrnin shkrimin në ankand dhe paratë që do të përfitoheshin nga shitja, do t'i depozitonin në thesarin e shtetit me qëllim që të përdoreshin për shërbime publike.

Haxhiu turk u përlot nga lajmet dhe rrëfeu këtë ngjarje mësimdhënëse:


“Im atë ishte një kaligraf osman. Çdo vit shkruante një tekst Kurani dhe me të siguronte jetesën. Ndërkaq, ai ishte përqëndruar tek një tekst Kurani që e shkruante me kujdes dhe përkushtim të veçantë. Aq bukur ishte shkruar sa njeriu s'ngopej së pari. Im atë e shkruante atë pa u ngutur aspak, me një dëshirë dhe kënaqësi të papërshkrueshme, sikur dëshironte të shkrinte në të të gjithë aftësinë dhe mjeshtërinë e vet. Pas një kohe të gjatë të kaluar me durim, më në fund, doli në pah një kryevepër e mrekullueshme. Babai ynë, i tejmbushur me ndjenjën e falënderimit dhe gëzimit për suksesin që kishte arritur, na mblodhi ne, bijtë e tij, dhe na tha:

«Bijtë e mi! Unë e shkrova këtë tekst të Kuranit të Shenjtë që të më bëhet ndërmjetësues në jetën tjetër, në Ahiret! Porosia ime për ju është që pasi të vdes, ta mbështillni atë mirë e mirë dhe të ma vendosni mbi gjoks!»

Kur ai ndërroi jetë, ne ia përmbushëm porosinë!

Misteri i vërtetë i cili më gëzoi aq sa edhe më la të mahnitur, është fakti se megjithëse im atë që varrosur së bashku me Kuranin në Stamboll, vite më vonë u gjet në tokat e bekuara, në një varrezë të bekuar!”

12. shih. Muuatta, Xhihad, 29.



— Mr. Fatmir Hadri —

Kur hulumtojmë historinë e njerëzimit, shohim se feja ka lindur me qenie njerëzore. Andaj aty ku ka ekzistuar një shoqëri ka ekzistuar edhe një fe. Kjo ka bërë që prania e saj të ndihet në çdo fazë të epokave historike. Jo vetëm që u shfaq në jetën shoqërore, por gjithashtu luajti një rol të rëndësishëm në integrimin, solidaritetin dhe integrimin e njerëzve. Përveç këtyre efekteve pozitive dhe konstruktive në jetën shoqërore, feja si fenomen social, për fat të keq ka qenë ndonjëherë shkaktar i konflikteve, çrregullimeve dhe luftrave në shkallë të gjerë.

Njerëzit që jetojnë në shoqëri kanë disa detyra, përgjegjesi dhe të drejta ndaj njëri-tjetrit. Kurse këto, i rregullon feja. Prandaj, ekzistenca e një feje kudo që gjendet dhe jeton njeriu, është një fenomen natyror. Me fjalën fe, nënkuptojmë fenë në përgjithësi, qoftë primitive, qoftë njerëzore, universale apo hyjnore. Sepse kur definojmë përkufizimin e fesë, do të shohim se qeniet njerëzore gjithmonë kanë besuar në një forcë që ka tejkaluar veten e tyre, në një forcë superiore ndaj vetvetes dhe në emër të asaj force kanë ndërmarrë veprime. Kështu që veprimet e ndërmarra në emër të forcës së besimit, janë një fe me kuptimin e tyre më të gjerë.

Duke u nisur nga kjo, mund të themi se ekziston një marrëdhënie e ndërsjellë midis shoqërisë dhe fesë. Ashtu si feja që ka një ndikim në të gjitha fushat e shoqërisë, edhe shoqëria gjithashtu ndikon në aspektin e fesë.

Edhe ai person që thotë se nuk besoj në asnjë forcë nuk mund të mohojë ekzistencën e forcave abstrakte që tejkalojnë veten e tij. Prandaj, ne mbrojmë idenë se në çdo shoqëri ka një besim dhe për këtë arsye nuk mund të themi se ekzistonë ndonjë shoqëri pa fe.

STRUKTURA DHE VETITË E FESË DHE SHOQËRISË:

Sipas sociologjisë së fesë, feja qoftë hyjnore apo njerëzore, pa marrë parasysh se çfarë lloji feje është, ne shohim tri veti të përbashkëta në të gjitha ato.¹

1. Besim
2. Adhurim
3. Shoqëri

1. Prof. Dr. Mehmet Taplamacioglu, *Din Sosyolojisi*, Ankara 1975. P. 169-184,



BESIMI: Kjo është ana teorike e fesë. Besimi lun një rol të rëndësishëm në drejtim të forcimit të lidhjes shpirtërore midis individëve. E kjo shoqërinë e kthen ose drejton në të njëjtin drejtim. Prandaj pasi shoqëria përbëhet nga njerëz të bashkuar rreth mendimit të përbashkët, fitonë forcë dhe fuqi.

Forca në të cilën njeriu beson dhe për hirë të kësaj force superior ai bën veprime mund të jetë një pemë, një skulpturë, një kafshë ose një bimë e cila pranohet si ngjarje natyrore ose një fuqi që brenda saj fsheh superiotetin dhe apsolutetin e saj.

Në të gjitha fet hyjnore, ekzistenca e Krijuesit është pranuar bashkërisht si forca apsolute. Andaj Krijuesi i vetëm dhe sundimtari i tërë universit është Allahu², që forca dhe fuçia e tij është e pakufizuar.

Urdhërimet e Krijuesit u janë komunikuar ose transferuar njerëzve të tjerë nëpërmjet profetëve të Tij, që i ka zgjedhur midis popullit.

Siç shihet, feja njerëzit i ka sjell rreth një besimi, dhe ky besim ka formuar shoqërinë. Me fjalë të tjera, formohet një shoqëri që jeton së bashku në përputhje me ligjet e përbashkëta.

ADHURIMI: është përmbledhës i të gjitha bindjeve, ndjenjave e gjendjeve shpirtërore, fjalëve dhe veprave që bëhen emër të fuqisë që besohet ose duke ndjekur urdhrat që i pëlqen Krijuesi apsolut.

Në fetë primitive, dalin në pah situata të ndryshme që kanë të bëjnë me flijimin e njerezve për pushtet ose flijimi ndaj pushtetit madje edhe sakrifikimi i qenieve njerëzore në raste të ndryshme.

Në fet hyjnore dhe universale, vërehet se kafshët sakrifikohen në vend të njerëzve. Kjo do të thotë, se në çdo fe, ekzistojnë veprime të detyrueshme që njerëzit do t'i kryejnë pa dallim.

SHOQËRIA: Shoqëria përbëhet nga një grup njerëzish që mblidhen qoftë për adhurim, bised ceremoni fetare etj. Disa vende janë të rezervuara për këto takime dhe veprimet që duhet të ndërmerren në emër të fesë, kryhen kolektivisht në këto vende. Në fetë hyjnore këto vende përgjithësisht quhen vende të adhurimit. Në të vërtetë, në gjuhën tonë, vendet

e adhurimit të muslimanëve u quajten xhamia, të krishterëve Kisha kurse të çifutëve Havra.

Sipas kësaj mund të themi se njerëzit jetojnë së bashku në çdo rast. Kjo është për shkak se ka faktorë që detyrojnë njerëzit të bashkohen. Megjithatë këta faktorë janë të ndryshëm, mirëpo tri nga këto janë më të rëndësishëm.

1. Besimet të përbashkëta
2. Rreziqet e zakonshme
3. Përfitimet e përbashkëta³

Është shumë e vështirë këto të ndahen nga njëra tjetra. Sepse ekziston një besim i përbashkët në çdo shoqëri dhe anëtarët e saj gjithashtu ballafaqohen me rreziqe të përbashkëta dhe janë në përfitime të përbashkëta.

Kështu që, kur hulumtojmë strukturën dhe vetitë e fesë dhe shoqërisë, gjejmë se shoqëria nuk mund të izohet nga feja. Sepse përveç këtyre karakteristikeve, shoqëria gjithashtu ka kushtet që përmirësojnë strukturën e saj e që këto i obligon edhe feja.

Prandaj struktura e shoqërisë zhvillohet nën ndikimin e tre faktorëve: Faktori i parë; Fqinjësia Aktive. Ku, kjo bashkon territorin, harmonizon antarët e shoqërisë me njëri tjetrin.

Faktori i dytë është lidhja e gjakut. Mënyra më e vogël e lidhjes së gjakut është familja. Në familje ka një unitet pavarësisht aftësive të ndryshme.

Faktori i tretë është mendimi kolektiv, sjellja dhe bashkimi i punës. Shembulli më i mirë është uniteti i besimtarëve rreth një grupi fetar. Si rezultat i besimit kolektiv, adhurimit të përbashkët dhe jetës kolektive fetare, dallimet si pasuria, profesioni, gjendja sociale e humbasin rëndësinë e tyre. Muslimanët që migruan nga Meka në Medine u pritën nga Medinasit ku formuan një shoqëri të fortë pa dallim ndaj njëri-tjetrit.

MARRËDHËNIET NË MES FESË DHE SHOQËRISË

Ka disa hulmutues që dallojnë efektet pozitive dhe negative të fesë në shoqëri. Megjithatë, kur shihet mirë, feja gjithmonë ka pasur një ndikim pozitiv në shoqëri. Sepse feja ruan mirëdashjen, bukurinë,

2. Hashr: 24.

3. Prof. Mehmet Taplamacioglu, Din Sosyolojisi, Ankara 1963, f 25-40.



zellin, vetë-sakrificën, besueshmërinë, ndihmën dhe të gjitha parimet e tjera pozitive me vlerë. Ekzistojnë individët që nuk janë të interesuar për fenë ose që kundërshtojnë fenë në terma individualë, mirëpo është pothuajse e pamundur të ekziston një shoqëri tërësisht jobesimtare ose ateiste. Në këtë kontekst një nga filozofët e lashtë grekë, Plutargue ka thënë: “mund të shëtisim botëm dhe brenda saj mund të gjejmë qytete pa mure, pa letërsi, pa ligje dhe pa pasuri; por nuk do të gjejmë një qytet pa një tempull ose shenjtërore.”⁴ Në anën tjetër, M. Eliade, i cili konsiderohet si një historian i famshëm i feve, tha se njeriu i parë ishte “njeri i devotshëm (fetar)” dhe krijimi i një bote kuptimplote është e mundur vetëm përmes zbulimit të të shenjtës.⁵

Shprehja e këtij fakti në këtë mënyrë tregon se feja në thelb është një sistem arsimor, ku njerëzit zhvillohen duke u edukuar në përputhje me këtë dhe nga këtu fillon edukohet shoqëria. Për shembull, në Islam, edukimi/arsimi fillon me mësimin e ligjeve dhe rregullave të Kur’anit. Prandaj pa dyshim se edukimi/arsimi individual filloi me atë.⁶ Siç dihet, Allahu me fjalën e parë në Kur’an u është drejtuar njerëzve duke u thënë lexo⁷ ku fillimisht i është drejtuar Muhammedit a.s, e pastaj përmes tij tërë gjinisë njerëzore, të gjithë neve besimtarë dhe jobesimtarë, të gjitha moshave e profesioneve. Kështu që nga individi, edukim kalon në shoqëri.

Përveç kësaj, feja i jep individit liri të gjerë, me kusht që ai të mos e kufizojë lirinë e të tjerëve. Me fjalë të tjera, përveç fuqisë së dashurisë, askush nuk është superior dhe i privilegjuar për këdo, ata kanë të drejta të barabarta. Në veçanti, Islami e ka bërë të qartë se askush nuk mund të jetë superior ndaj ndonjë personi tjetër duke i dhënë një vlerë të madhe lirisë së personit dhe se kushdo që beson në Zot është i barabartë dhe seshoqëritë besimtare nuk mund të jenë superiore dhe të privileguara ndaj shoqërive tjera. Për shkak se bamirësia islame synon të edukojë shoqërinë me parimin e ndihmës së ndërsjellë dhe të tjetërsimit nga e keqja.⁸ Marrë-

dhënia/lidhja e njeriut me fenë është e fshehur në strukturën e tij natyrore. Për shembull, një antropolog katolik, Evans Pritchard, burimin e ndjenjës së fesë tek njeriu, e bazon në intuitën e zbulesës, dmth në intuitën hyjnore. Sipas tij, të gjithë njerëzit kanë një intuitë të zbulesës dhe fetë janë produkt i kësaj intuete. Në të njëjtën mënyrë, Max Müller argumenton se intuita e Krijuesit është e vendosur në natyrën e njeriut. Në fakt, intuita hyjnore që këta dy shkencëtarë të huaj e thonë në terminologjinë islame quhet “natyrshmeri”.⁹ Sepse sipas Islamit, të gjitha qeniet njerëzore vijnë në botë me një natyrë të pastër, pa mëkat, Prandaj njeriu është i drejtuar ka besimi, bindja dhe përkushtimi. Andaj qeniet njerëzore janë të afta të besojnë për shkak të krijimit të tyre.¹⁰ Në fakt, fenomeni i besimit është vetëm një ndjenjë njerëzore. Me fjalë të tjera, fenomeni i besimit dhe i fesë është një nga faktorët kryesorë që dallojnë njerëzit nga qeniet e tjera.

Prandaj kur shqyrtojmë fenë në kuptim e saj të gjerë, shohim se feja, si dhe efekti i saj mbi shoqërinë është dominues. Fetë hyjnore dhe universale përfshinin gjithashtu tradita, kultura dhe qytetërimi që nuk binin në kundërshtim me parimet e tyre themelore dhe i vlerësonin ato në kohë. Prandaj, feja dhe shoqëria janë në një marrëdhënie të ndërsjellë. Feja, e cila ndikon aq shumë në shoqëri, është një nga faktorët më të rëndësishëm në zhvillimin e saj. Zhvillimi i shoqërisë është nga injoranca tek dija, nga varfëria në pasuri, nga fuqia e një personi në fuqinë e unitetit, shteti dhe populli duhet të punojnë krah për krah dhe të kryejnë punën që ka filluar. Për të bashkuar përpjekjet e njerëzve me përpjekjet e Shtetit.

Integrimi i individëve në shoqëri më së miri ofrohet nga feja. Është e qartë se shoqëria e formuar nga njerëz që janë të lidhur me njëri-tjetrin me besim të përbashkët do të arrijnë qëllimin e përbashkët në mënyrën më të shpejtë dhe më të mirë. Ky qëllim është zhvillimi i shoqërisë, arsimi i përbashkët, qëllimi i përbashkët, kundër rreziqeve dhe përfitimeve të përbashkëta, natyrisht, do të zhvillohet shoqëria e njerëzve me ndërgjegje të përbashkët.

4. Ahmet Kahraman, Dinler Tarihi, istbull., 1984, f. 14.

5. Mircae Eliade, Dinin Anlamı ve Sosyal Fonksiyonu (Çev. M. Aydın), Konya, 1995, s.VI-1.

6. Dr. Hasan Küçük, islâm’da Kitle Egitimi, istanbul f. 198.

7. El-Alek, 1.

8. Muhammed Ebu Zehra, El Tekâful-ül içtimai Fl-I islâm, Kahire,

1960. f. 9.

9. Buhariut, 1385

10. Rrum, 30



EL-GAFUR

FALËSI I TË GJITHA GJYNAHEVE

Ilir Hoxha

Magfired

Fjala arabe “magfired”, që ka të njëjtën rrënjë me emrin Gafur, do të thotë, “*të mbulosh të gjitha të metat dhe gjynahet e diku*”. Një nga nevojat themelore për ne si njerëz, është edhe dinjiteti. Të gjitha kënaqësitë e tjera vijnë pas kësaj. Nëse shohim me kujdes në Kur’an dhe Sunnet, duket sikur të gjitha këto peripeci të kësaj bote, po i përfetojmë vetëm për të arritur magfiredin prej Zotit. (shih. Al-i Imran, 133; Fatir, 34.) Kaq synim i lartë është pra magfiredi! Nevoja që ndiejmë për mbulimin e të metave dhe gjynaheve, nuk përjashton as të bindurin, as të pabindurin. Nëse i pabinduri ka nevojë që t’i mbulohen gjynahet, i binduri ka nevojë t’i mbulohen mangësitë, sepse është e pamendueshme që një rob të jetë patëmeta.

Magfired nuk do të thotë vetëm falje, sepse falja nënkupton anulimin e dënimit. Ndërsa magfired do të thotë të anulosh edhe dënimin, edhe qortimin edhe përmendjen e fajit para fajtorit. Pra, do të thotë ta mbulosh plotësisht atë faj.

Nisur nga kjo, Zoti ynë i Madhëruar, i Cili është Gafur, i mbulon të metat dhe gjynahet kurdo që dëshiron. Madje, Ai bën që edhe vet robi ta harrojë gabimin vet dhe, kur ky rob të dalë para Allahut, nuk do të hidhërohet aspak prej të keqes së atyre që ka vepruar. Po ashtu, në sajë të harresës, ai nuk ndjehet as i shtypur nga presioni i gjynahut në ndërgjegjen e tij dhe i duket sikur nuk e ka bërë fare atë gjynah. Ja pra, kjo është falja absolute që shpreh emri Gafur.

Gafir, Gaffar dhe Gafur, janë tre emra që burojnë

prej rrënjës “Gufran”. Për shkak se Allahu i Madhëruar është i pastër nga përsëritjet e padobishme, dijetarët e refuzojnë idenë se brenda “Esma-i Husna / Emrave të bukur të Allahut”, gjenden emra me kuptime të njëjta dhe na tërheqin vëmendjen tek nuancat. Pra, ndërkohë që emri Gafir shpreh faljen në mënyrë absolute, emri Gaffar, shpreh faljen e një gjynahu sado që të jetë përsëritur. Kurse emri Gafur, do të thotë të falësh gabime e llojllojshme.

Emri Gafur në Kur’an

Një nga temat që na e shtojnë edhe më tepër respektin dhe falënderimin ndaj Allahut të Madhëruar, është edhe fakti se në Kur’an, emri Gafur shoqërohet më tepër me emrin Rrahim. Këto dy emra të cilat i shohim së bashku në 73 vende në Kur’an, tregojnë se kur mbulimi i gjynaheve është bashkë me mëshirën, ato shprehin përsosmëri. Kjo, sepse falja që bën Rrahim-i (Mëshiruesi), është një falje e cila bëhet pa e vrarë në ndërgjegje gjynahqarin. Po ashtu, edhe emri “Rabb”, që shpreh edukimin hyjnor, përdoret në më tepër se 10 vende së bashku me emrin Gafur, gjë e cila tregon për një mirësi tjetër të veçantë. Pra, rregullat dhe dënimet që përmban edukimi hyjnor, kanë si pikësynim mbulimin dhe faljen e gjynaheve. Nga kjo kuptojmë se ky edukim, nuk ka për synim vetëm të vendoset një mbizotërim mbi atë që i nënshtrohet edukimit, por tregon edhe dhembshurinë e Zotit tonë, i Cili gjithmonë kërkon arsye për t’i falur robërit e Vet. (shih. En’am, 145; Nahl, 119; Kehf, 58.)

Ndërsa aty ku emri Gafur përmendet së bashku me emrin Halim, është tërhequr vëmendja në

çështjet morale dhe sociale, ku më pas, duke përmendur këto dy emra, është theksuar se Zoti ynë i Madhëruar i mbulon gabimet, por, edhe kur nuk i mbulon, Ai nuk nxiton në ndëshkim, por i jep afat gjynahqarit. (shih. Bekare, 225, 235; Al-i Imran, 155; Maide, 101.)

Përveç këtyre, emri Gafur në Kur'an gjendet i shoqëruar edhe me emrat Aziz, Shekur dhe Afuu. Ashtu si çdo emër tjetër hyjnor, edhe këto emra mbështesin dhe përforcojnë kuptimin e emrit Gafur, duke e pasuruar atë dhe duke i shtuar dimensionet e reja. Për shembull, në ajetin 14 të sures Buruxh, ku emri Gafur shoqërohet me emrin Uedud, na bëhet e ditur se ndërkohë që Allahu i njeh të gjitha të metat dhe gjynahet tona dhe i mbulon ato, Atij nuk i pakësohet dashuria që ka ndaj nesh.

Shkaku që në Kur'an theksohet me qindra herë kërkimi i faljes, ka për qëllim kompensimin nga ana e njeriut të prapambetjes në arritjen e cilësive të përsosura që priten prej tij. Prandaj, pendimi dhe kërkimi i faljes, janë një mundësi ngritjeje për njeriun. (shih. Dharijat, 18; Enfal, 4; Muhammed, 15; Fussilet, 32; Fetih, 29.) Mirëpo, kjo kërkesë për falje, bën të domosdoshme që fjalët dhe veprat të mbështesin njëra-tjetrën. Kërkesa për falje, e cila nuk përmban pendesën dhe fazat e përmirësimit, nuk është shumë serioze. Këtë e tregon edhe fakti se shpesh herë, ajetet të cilat flasin për faljen, kanë edhe kushtin e pendesës dhe veprave të mira. (shih. Furkan, 70; Neml, 11; Tegabun, 18; Nur, 22.) Në të njëjtën kohë, ai që kërkon falje, duhet të dijë se nuk ekziston asnjë gjynah për të cilin nuk ka falje. (shih. Zumer, 53.) Pra, derisa t'i vijë shpirti në fyt, njeriu ka mundësinë t'i mbulohen gjynahet dhe të fillojë një jetë të re.

Manifestimi i emrit Gafur, ashtu si edhe emrat e tjerë të Zotit tonë, të cilat shprehin mbulimin e të

metave dhe faljen, varet nga veprimi i gjynaheve dhe kërkimi i faljes për to nga ana e njerëzve. Por, megjithëse është e pamundur të gjesësh një njeri pa të meta, Profeti ynë (a.s.), është shprehur se: *“Nëse nuk do të bënit asnjë gjynah, Allahu do t'ju zhdukte dhe në vendin tuaj do të sillte njerëz që do të bënin gjynahe dhe do të kërkonin falje.”* (Muslim, Teube, 9.)

Njerëzit tek të cilët manifestohet emri hyjnor Gafur, janë përherë optimistë, në përgjithësi i mbulojnë gabimet e të tjerëve, nëse kjo nuk është e mundur, ata falin me ndonjë arsyetim, nuk hetojnë të metat e të tjerëve, nuk urrejnë dhe nuk ankohen prej të tjerëve. Ata janë të vetëdijshëm se këto cilësi kanë të bëjnë plotësisht me karakterin e vet, e jo me botën jashtë tij. E në fakt, ai që e kushtëzon faljen dhe mëshirën me veprimet e të tjerëve ndaj tij, nuk është njeri i lirë. Ai është i varur nga të tjerët në lidhje me mirësinë.

Nëse dëshironi të ndjeni manifestimin e këtij emri hyjnor, më parë duhet të keni arritur vetëdijen që kur të shihni gabimet e të tjerëve, t'ju kujtohen menjëherë gabimet personale. Më pas, duhet të dimë se, pikësëpari, falja hyjnore varet nga sa i mbulojmë ne të metat e të tjerëve. (shih. Nur, 22.) Pra, ne kemi nevojë për faljen hyjnore dhe kjo varet nga falja që ne u ofrojmë të tjerëve! Kjo është formula... *“Kush e mbulon të metën e një myslimani dhe ia fal gabimin atij, Allahu do t'ia falë gabimet ditën e gjykimit.”* (Buhari, Medhalim, 3; Muslim, Dhikr, 38.)

Sipas dijetarëve, një tjetër manifestim i këtij emri të Allahut, është edhe vendosja e pengesave midis nesh dhe gjërave të dëmshme për ne. Pra, në këtë rast, Allahu i Madhëruar i mbulon rrugët e gabuara dhe nuk na i tregon ato. Në këtë mënyrë, Ai nuk na ruan vetëm prej ndëshkimit, por edhe prej vetë gjynahut.

A close-up photograph of a hand dropping a coin into another hand held palm up. The background is a soft, out-of-focus green with bokeh light effects. The word "ALTRUIZMI" is overlaid in large white capital letters.

ALTRUIZMI

— Sami Gëksyn —

Jemi në 10 ditët muajit Dhul Hixhe në të cilat përjetohet më shumë koha e përsëritshmërisë. Shpërblimet dhe sevapet po bien si shira të begatshëm. Të gjithë duhet të përqijemi të bëjmë vepra të mira dhe të përfitojmë sa më shumë të jetë e mundur nga kjo begati.

Edhe dhënia është njëra prej veprave të mira...

Allahu i Madhëruar i ka lavdëruar në Kuranin Fisnik ata të cilët japin duke thënë:

“Ata i ushqejnë të varfrit, jetimët dhe të zënë rob edhe pse vetë janë nevojtarë.” (Insan, 8)

Domethënë, në këtë dhënie ka ndjenjë altruizmi. Ka flijim. Edhe pse Aliu dhe Fatimja ishin agjërueshëm dhe nuk kishin asgjë, ushqimin e iftareve të tyre tri ditë rresht ia dhanë të varfrit, jetimit dhe robit që u erdhi te dera. Sigurisht se këtë vepër e bënë me këto ndjenja.

Prej sahabëve të të Dërguarit të Allahut (a.s.), kishte prej atyre që i linin fëmijët e tyre dhe vetë pa ngrënë asgjë dhe i jepnin mysafirët.

Ata bënë sakrificë të tilla, sepse ata patën dëgjuar se i Dërguari i Allahut (a.s.), ka thënë:

“Shtëpitë me bukuri të veçantë dhe madhështore të xhenetit janë për ata që flasin butë dhe ëmbël, që u japin për të ngrënë të tjerëve, që agjërojnë vazh-

dimisht dhe që falin namaz kur njerëzit janë në gjumë.” (Tirmidhi, Xhenet, 3, IV/673.)

Si besimtarë të devotshëm, sahabët e kuptuan shumë mirë këtë hadith fisnik dhe të tjerët të ngjashëm me të. Madje, jo vetëm që i kuptuan, por u bënë shembull edhe për ne duke i përjetuar. Edhe ata që i ndjekin sahabët, e kanë pranuar këtë gjendje si shkak i lumturisë dhe menjëherë kanë filluar ta zbatojnë.

Kjo gjendje është shumë e lartë dhe fisnike nga që siguron zhvillimin e qetësisë, paqes, bashkimit, unitetit, dashurisë dhe respektit në shoqëri.

Nisur nga kjo që thamë më sipër, myslimanët gjithmonë duhet të japin, duhet të jenë altruistë dhe të kenë moral të lartë. Nevojtarët duhet t'i pranojnë si amanet të tyre. Ata duhet t'i lartësojnë gradat e njerëzillëkut të tyre duke ua mundësuar edhe të tjerëve që të përfitojnë nga mirësitë që u ka dhuruar Allahu Teala. Kjo përpjekje duhet të vazhdojë duke u shtuar në kohë të përshtatshme dhe veçanërisht në këto ditë. Por të mos harrojmë se në të gjitha këto përpjekje dhe sakrificë, synimi duhet të jetë vetëm pëlqimi i Allahut (xh.sh.). Besimtarët nuk presin ndonjë shpërblim apo vlerësim prej atyre që i kanë ndihmuar si kundërvlerë për atë që u kanë dhënë. Ata nuk presin prej tyre as komplimente

dhe as lavdërime. Në ajetin e nëntë të sures Insan, Allahu i Lartësuar thotë duke na treguar për fjalët e robërve të Tij të veçantë të cilët japin për hir të Allahut:

“Ne ju ushqejmë vetëm për hir të Zotit. Për këtë, nuk duam shpërblim e as falënderim!” (Insan, 9)

Sakrificat e tyre nuk përbëheshin vetëm prej sofrave që shtroheshin herë pas here. Nëse do t'i hidhnim një shikim jetës së tyre, do të shohim se si e kanë sakrifikuar pasurinë, madje edhe shpirtin e tyre për të tjerët. Sa bukur i lavdëron Allahu Teala në Kuranin Fisnik muhaxhirët dhe ensarët që e shfaqën këtë sakrificë:

“Një pjesë e plaçkës i takon edhe mërgimtarëve të varfër, të cilët u përzunë nga vendlindja dhe pasuritë e tyre, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Allahut dhe duke ndihmuar Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Pikërisht ata janë besimtarët e singertë. Ndërsa ata që banojnë në Medinë dhe që e kanë pranuar besimin qysh më parë, i duan mërgimtarët që vijnë në Medinë dhe në zemrat e tyre nuk ndejnë kurrfarë rëndimi, për atë, që u është dhënë atyre, por duan t'u bëjnë më mirë mërgimtarëve sesa vetes, edhe pse vetë janë nevojtarë. Kushdo që ruhet nga lakmia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.” (Hashr, 8-9)

Këto ajete fisnike tregojnë se ensarët e nderuar kishin një moral sublim edhe në lidhje me këtë çështje. Muhaxhirët ishin në vështirësi, ndërsa ensarët e nderuar u lidhnin plagët. Në këtë mënyrë, ensarët shpëtuan që në këtë botë nga koprracia e egoizmi dhe fituan shpëtimin e shpërblimin hyjnor edhe në këtë botë, edhe në botën tjetër.

Në hadithin që përmendëm më sipër, i Dërguari i Allahut, (a.s.), shprehet se të folurit me butësi, ëmbëlsi dhe mirësi është një mundësi e vyer për të shkuar në xhenet dhe fituar shtëpitë madhështore të xhenetit.

I Dërguari i Allahut (a.s.), si në çdo çështje tjetër, edhe në çështjen e të folurit bukur është i vetmi udhërrëfyesi ynë që mund ta marrim për shembull. Atëherë, ne si myslimanë duhet të jemi të sjellshëm dhe të singertë në të folurin tonë dhe në jetën sociale. Në këtë mënyrë do të fitohen zemrat, do të dalë në pah dashuria dhe respekti, do të shtohen mirëkuptimet dhe do të shfaqet paqja e qetësia. Ne duhet ta dimë shumë mirë se nuk mund të arrijmë askund duke ua thyer zemrat njerëzve, duke i urreyer ata dhe duke shkakuar përçarje e prishje.

Fjalët e thëna me vend, me mënyrë të sjellshme dhe me urtësi, shkrimet domethënëse dhe të shkruara duke menduar thellë mbi to, influencojnë pozitivisht te shpirtrat, i joshin zemrat dhe na ndihmojnë në realizimin e qëllimit tonë.

Edhe Allahu i Lartësuar, në lidhje me këtë çështje, thotë kështu në shumë ajete të Kuranit Fisnik duke ua tërhequr vëmendjen njerëzve:

“...Thuajuni fjalë të ëmbla.” (Nisa, 8)

Besimtarët e singertë dhe të dëlirë i frikësohen Allahut Teala dhe gjithmonë përpiqen të thonë fjalë të vërteta, të dobishme, të ëmbla dhe të buta. Ata largohen nga fjalët e dëmshme dhe të padobishme. Në ajetin fisnik të mëposhtëm, Zoti (xh.sh.), na e shpreh këtë obligim duke thënë:

“O ju që keni besuar! Kini frikë nga Allahu dhe thoni fjalë të vërteta.” (Ahzab, 70)

Gjuha e ëmbël, të shprehurit e bukur, të sjellët me ndershmëri... Një zemër e fituar duke vepruar me këtë metodë, është më e vlefshme se e gjithë bota. Ja pra, në sajë të kësaj, rob i arrin lumturinë dhe shpërblimin e kësaj bote dhe të ahiretit. Në të kundërt, shejtani fut hipokrizi ndërmjet njerëzve, nxit të keqen, shton vështirësitë dhe e ndalon realizimin e qëllimeve që synojnë mirësinë. Kurani Fisnik na ka lajmëruar se shejtani është armiku i hapur i yni.

Allahu Teala na njofton haptazi:

“Kush flet më bukur se ai që i fton njerëzit drejt Allahut, bën vepra të mira dhe thotë: “Unë, me të vërtetë jam mysliman.” (Fussilet, 33)

Domethënë, robërit që flasin më bukur janë ata njerëz që përpiqen për t'i ftuar robërit e Allahut të Madhëruar për te Ai. Ata i ftojnë njerëzit për t'i bërë ibadet dhe për t'u bindur Allahut Teala. Ndërkohë, edhe vetë e praktikojnë atë që thonë dhe bëjnë vepra të mira. Ata bëhen shembull virtyti dhe sinqeriteti për njerëzit.

Fjala e myslimanëve të tillë të singertë është për Allahun dhe për shërbimin ndaj myslimanëve. Madje, edhe pasurinë dhe jetën e flijojnë duke shërbyer për këtë...

Myslimani duhet t'i gjejë nevojtarët kudo që mund të ndodhen në botën Islame, në mënyrë që t'u japë ushqim për të ngrënë, përse i përket çështjes së të ushqyerit. Po ashtu, edhe me përpjekjet e atyre që e kanë arrirë mirësinë e të folurit bukur, duhet të hapë puse uji në vendet e nevojshme, duhet të bëjë çezma, duhet të ndërtojë azile, duhet të ndërtojë kurse Kurani, duhet të bëjë shkolla dhe duhet t'u japë iftare nxënësve që mësojnë Kuranin. Në këtë mënyrë duhet të përpiqet vazhdimisht për t'ua plotësuar njerëzve nevojat e tyre materialo-shpirtërore.

Padyshim se ata që i bëjnë këto përpjekje, në botën tjetër do të arrijnë nderin për të parë në xhenet “xhemalullah / bukurinë e Allahut”.

Zoti (xh.xh.), na dhëntë sukses për të bërë vepra që na shpijnë në xhenet dhe që na japin nderin për të parë “bukurinë e Allahut”. Amin!..

KËNAQËSIA E Zotit

MBI ÇDO GJË TJETËR

— Ferit Piku —

Allahu (xh.sh) thotë në Kuranin fisnik: “Dijeni se miqtë e Zotit nuk tremben asnjëherë e as nuk mërziten. Janë ata që kanë besuar dhe janë të devotshëm përpara Zotit të tyre. Për ata ka sihariq në këtë botë dhe në botën tjetër. Ky është premtimi i Allahut e Ai nuk e thyen premtimin e Tij. Kjo me të vërtetë është fitorja më e madhe”.

Jeta e kësaj bote të bën një herë të qeshësh e tre herë të qash, një herë të ngre lart e shumë herë të ul poshtë. Ajo të mashtron, të thith e të josh, ndërsa ty të duket se botën e ke në dorë. Kush të tha ty, se njeriu që ka post medoemos është i dashur tek Zoti?! Kush të tha, se Zoti është i kënaqur me atë njeri që ka para, kush të tha, se njeriu që shpëton prej fatkeqësive, nuk e sprovon Zoti me siguri dhe ai është më i mirë se të tjerët tek Zoti?! A ekziston në këtë gjithësi diçka më e madhe se Zoti?! Kur je i bindur, se Zoti i gjithësisë të dha jetën, të ringjall e të llogarit, atëherë kush më shumë se ky Zot e meriton t’ia fitosh kënaqësinë!

Kush do të të japë kënaqësi tjetër veç Zotit! A mos vallë paraja, që sot e ke e nesër nuk e ke? Mos vallë shefi në punë, i cili sot për ty është mirë, ndërsa nesër mund të kthehet në armikun tënd? Mos vallë njerëzit, kushdo qofshin ata, të cilët kur vjen momenti i fundit të dorëzojnë në dhë, por me ty nuk futen?!

Kur profeti (a.s) shkoi në qytetin e Taifit për t’i ftuar këta njerëz në rrugë të Zotit, ata jo vetëm nuk e respektuan, por e fyen dhe e keqtrajtuan. Kur ai doli nga qyteti, i përgjakur në këmbët e tij, u ul nën hijen e një peme dhe me lot në sy ka bërë një lutje, e cila i lëviz zemrat prej vendi. Ai (a.s) tha: “O Allah! Ty të ankojem për dobësinë time, Ty të ankojem për pamundësinë time, Ty të ankojem për paaftësinë time përpara njerëzve. Ti je Zoti i atyre që janë të pafuqishëm, Ti je edhe Zoti im. Në dorë të kujt po

më le, në dorë të të huajit, që s’më njeh, apo në dorë të armikut që mbi mua ka pushtet. Nëse ti o Zot nuk je i zemëruar me mua, unë s’pyes për asgjë, por falja Jote është e rëndësishme për mua. Kërkoj mbrojtje me dritën Tënde, që i ndriçon të gjithë errësirat, që rregullon gjithë dynjanë dhe ahiretin, që të mos zbresësh zemërimin Tënd e të mos më përfshijë pakënaqësia Jote. Para Teje gjithmonë do të pendojem o Zot, derisa të kënaqesh me mua. Askush përveç Teje nuk e ndryshon gjendjen për mirë”. Pasi tha këto fjalë, i erdhi engjëlli i maleve dhe i tha: “O Muhamed! Jam urdhëruar prej Zotit dhe nëse ke dëshirë, unë i bashkoj këto dy male dhe i fshij këta njerëz nga faqja e dheut”. Por profeti (a.s) kishte ardhur për mëshirë dhe jo për dënim, kishte ardhur për falje dhe jo për hakmarrje. Ai (a.s) tha: “Jo, nuk e dua këtë! Por dua që nga pasardhësit e këtyre njerëzve të dalin fëmijë, që adhurojnë Zotin e nuk i bëjnë shok Atij”.

Për çdo ditë që lind dielli, ne dalin nga shtëpia me zemrën të mbushur plot me halle, me kokën të mbushur plot me plane, me frikën se mos na mërzitet filani apo fisteku, me stresin se çfarë i pëlqen shefit tonë, çfarë i pëlqen klientit tonë apo edhe bashkëshorteve tona. Ky është një shqetësim i madh për çdonjërin prej nesh. Ne çdo ditë themi shumë fjalë e bëjmë shumë lëvizje, por shumë pak njerëz ndalen dhe i thonë vetes: “O njeri! Ti që flet kaq shumë, që lëviz kaq shumë, sa përqind të këtyre punëve po i bën për hatër të Zotit? A është i kënaqur Zoti me ty me këto fjalë e punë që bën? Mos do t’i mbash në kurriz të gjitha këto fjalë e punë dhe do të japësh llogari para Zotit?”

Një grua e madhe me shpirt shumë të madh, e quajtur Rabija Adeuije, ajo kishte gjuhën e shpirtit e kur komunikonte me Zotin, thoshte fjalë që shkruhen me flori. Ja si e përshkruan ajo kënaqësinë e

Zotit: “O Zot! Vetëm Ti të ishe i kënaqur me mua, pa le të ishte e hidhur e gjithë kjo botë. Vetëm Ti të më pranoje pranë Teje, pa le të mërzhiteshin të gjithë në tokë. Vetëm mes Teje e meje të kishte jetë, pa le të ishte çdo gjë tjetër e shkretë. Nëse arrij dashurinë Tënde, s’ka më dhimbje, s’ka më dert, se çdo gjë që është mbi dhë, një ditë dhë do të jetë”. Me të vërtetë do të vijë një ditë, ku çdo gjë do të zhduket e do të mbetet vetëm Zoti i gjithësisë.

Gjëja më e madhe dhe më e lartë që mund të arrijë njeriu në këtë botë është, që Zoti të kënaqet me atë njeri. Vendosi vetes të gjitha objektivat që do, mbaro çdo universitet që të pëlqen, por dije se edhe nëse e ke rrogën me miliarda, mos kujto se ke arritur kulmin, pasi kjo arrihet vetëm atëherë, kur Zoti të jetë i kënaqur me ty. Nëse Zoti është i kënaqur me ty, ç’dëm mund të të bëjë bota?

Kënaqësia e Zotit nuk është me fjalë, por ajo ka shenjat e saj. Lusim Zotin të na japë kënaqësinë e Tij. Ja disa prej shenjave, të cilat tregojnë se Zoti është i kënaqur me ty:

1- Rehatia e zemrës dhe e shpirtit: Zoti thotë në Kuranin fisnik: “Atij njeriu që Allahu i ka futur Islamin në zemër, i hapet kraharori, i mbushet zemra”. Njeriu me të cilin Zoti është i kënaqur, e ka zemrën e madhe dhe ndihet rehat edhe sikur të jetë duke ngrënë bukë e kripë. Ndërsa ai person me të cilin Zoti nuk është i kënaqur, e ka shpirtin e zi dhe zemrën e ngushtë, edhe sikur gjithë botën t’ia vendosësh përpara. Kënaqësia hyn në shpirt dhe jo në bark, prandaj kush nuk arrin kënaqësinë e Zotit, do të mbetet gjithmonë i varfër.

2- Dashuria e Zotit: Në një hadith të shenjtë thuhet se kur njeriu përpiket që të fitojë kënaqësinë e ALLAHUT (xh.sh), vjen një moment që Zoti i thotë Xhibrilit (a.s): “O Xhibril, Unë e dua filanin, birin e filanit, prandaj duaje edhe ti”. Atëherë Xhibrili (a.s) e do atë njeri. Pastaj Xhibrili (a.s) thërret në qiell përpara melekëve të Zotit: “Zoti dhe unë e duam filanin, birin e filanit, prandaj duajeni edhe ju”. Atëherë edhe banorët e qiellit e duan atë njeri. Por Zoti jep më shumë se kaq, prandaj edhe njerëzit që janë në tokë, e duan dhe e respektojnë atë njeri, megjithëse mund të mos ketë post e para.

3- Rendja pas punëve të mira: Kur flitet për punë të mira, ti fluturon pas tyre, ndërsa kur dikush thërret për gjynahe, ti i ke këmbët e gozhduara përpara tyre. Kush e bën të mirën me kënaqësi dhe i largohet të keqes me lehtësi, kjo tregon se Zoti e do atë njeri.

Jeto sa të duash në këtë botë, por dije se një ditë do të vdesësh. Duaj kë të duash në këtë botë, dije se një ditë do ta lësh atë. Bëja qejfin kujt të duash, dije se një ditë do ta braktisë atë. Ç’do t’i themi Zotit, kur të dalim para Tij. Ja se çfarë i thotë Zoti njeriut, të cilin sapo e kanë varrosur: “Robi Im! Të gjithë ikën e të lanë, dhe me dhë të mbuluan. Askush nuk u fut në varr me ty, por edhe sikur të futeshin, nuk do të të bënë aspak dobi. Ku je sot robi Im? Unë kam qenë, jam e do të jem gjithmonë. Ia bëre qejfin gjithë botës, por një herë nuk të shkoi nëpër mend kënaqësia Ime. Sot s’ke asgjë tjetër veç Meje dhe punës tënde”. Zoti na mëshiroftë atë ditë, kur do të na mbulojnë me dhë.

Mos harroni: Do të vijë një ditë që do të vdesim dhe një ditë do të ringjallemi të gjithë, të zhveshur e të zbuluar, ashtu siç na lindën nënat tona. Atë ditë të gjithë njerëzit, mbretër e pushtetarë, profetë e njerëz të thjeshtë do t’i ulin kokat e tyre dhe askush nuk guxon ta shohë Zotin.

Do vijë një moment për të gjithë ne, i cili është më i vështirë se ky që përmenda deri tani. Një zë do të thërrasë përpara miliarda e miliarda krijesave: “O filan i biri i filanit! Dil përpara Zotit”. Aliu (r.a) thotë në lidhje me këtë: “Do ketë njerëz, të cilëve do t’iu bjerë mishi i fytyrës nga turpi, kur të dëgjojnë që iu thirret emri”. Nëse të thuhet: “Shko e tako filanin”, të dridhen këmbët. Vallë si do të ndihesh, kur të dalësh përpara Zotit?! Çfarë do t’i thuash Atij? Çfarë ke përgatitur për atë ditë? Allahu (xh.sh) do të thotë: “Robi im, të krijova pa i marrë leje askujt, të ushqeva, ta mora shpirtin, të ringjalla. Çfarë ke bërë për Mua? A të shkoi nëpër mend se do të vijë ky moment?”

Si përfundim themi se, nëse njeriu përpiket që të fitojë kënaqësinë e Allahut (xh.sh), do të vijë patjetër një ditë, që edhe njerëzit do të gëzohen me këtë njeri. Ndërsa nëse njeriu mundohet të fitojë kënaqësinë e njerëzve, duke zemëruar Zotin, do të vijë patjetër një ditë, që edhe njerëzit më të afërt të këtij personi do të zemërohen me të.

Zoti i pastroftë zemrat tona, na mundësoftë që fjalët dhe punët tona t’i bëjmë për hatër të Tij. Zoti na gjykoftë me mëshirën e Tij dhe jo me drejtësinë e Tij. Zoti i faltë gabimet tona, të voglat e të mëdhatë, ato që i mbajmë mend e ato që i di vetëm Ai. Zoti na mundësoftë që çdo punë që bëjmë, ta bëjmë për hatër të Zotit, se çdo gjë në botë do të mbarojë e do të mbetet vetëm Allahu (xh.sh).

Amin!..

**Jeta e kësaj
bote të bën një herë të
qeshësh e tre herë të qash,
një herë të ngre lart e
shumë herë të ul poshtë. Ajo
të mashtron, të thith e të josh,
ndërsa ty të duket se botën e
ke në dorë. Kush të tha ty,
se njeriu që ka post
medoemos është i dashur
tek Zoti?!**



TELEVIZORËT

dhe të vetmuarit

Tuba Sëkmen

Nëse shohim format dhe vendin që kanë uzurpuar sot në jetën tonë televizorët, të cilët ditët e para kur hynë në shtëpitë tona transmetonin vetëm në një orë të caktuar të ditës, një kanal të vetëm dhe bardhë e zi, mund të themi se janë zhvilluar shumë.... Më parë, ngaqë në një lagje vetëm disa shtëpi kishin televizorë, shumë familje mbledheshin bashkë dhe njerëzit socializoheshin. Ndërsa tani numri i televizorëve nëpër shtëpi është rritur dhe në të njëjtën mënyrë edhe vetmia e njerëzve.

Tashmë ndjekja e televizorit për familjet është bërë mënyra më e lirë dhe e lehtë për t'u argëtuar. Një produksion bën transmetime 24 orë në kanale të ndryshme, me lloj-lloj programesh që ndryshojnë sipas dëshirës së njerëzve dhe që ia vlen për secilin të ndiqen në çdo moment. Prandaj ekonomiksht, pjesa më dominuese e ekranit të bardhë po rritet çdo ditë e më shumë.

Programet televizive që përgatiteshin njëzet vite më parë ishin programe familjare që ndiqeshin edhe nga të rriturit, edhe nga të vegjlit. Të njëjtin program mund ta ndiqnin të gjithë, nga më i moshuari, deri te më i riu. Madje të dielën ekzistonte një program shumë i bukur dhe familjar. Ditën e diel uleshim, ndiqnim këtë program dhe bisedonim rreth tij. Kjo gjendje na bën të themi "Eh,

ikën ato ditë!"

Pronarët e kanaleve të cilët kërkojnë të sfidojnë ambientin konkurrues i cili është nxehur nga shtimi i numrit të kanaleve transmetuese, kanë filluar të formojnë masa ta veçanta objektive për veten e tyre. Për shembull programe që u interesojnë grave shtëpiake, fëmijëve të vegjël, dashamirësve të sportit, shikuesve të lajmeve, atyre që u pëlqen historia dhe udhëtimi... Në secilin grup që mund të bëni pjesë, ka programe televizive që janë përgatitur posaçërisht për grupin tuaj... Këtej në çdo çast që dëshironi, mund të gjeni prodhimin tuaj të preferuar...

Ky ndryshim dhe kjo larmi e programeve televizive, edhe pse synon të paraqesë argëtim për njerëzit, ka filluar të ngjallë impulsivitetin e pjesëtarëve të familjes për përdorimin e telekomandës së televizorit. Madje edhe më i vogli i shtëpisë i kërkon babait të hapë kanalin e filmave vizatimor ndërkohë që ai ndjek lajmet. Adoleshenti që ndjek lajmet sportive, është kureshtar për rezultatin e ndeshjes. Nëna që shkon e vjen në kuzhinë e ka mendjen te seriali (telenovela). Dikush tjetër thotë se tashmë kanë mbaruar reklamat te kanali i konkursit. Për fat të keq, tashmë pjesëtarët e familjes nuk janë të gjithë të lumtur në të njëjtën kohë ndërkohë që ndjekin televizor. Kjo sonancë e shumtë, e cila

vjen me shumë ngjyra, zakonisht ua ngjesh kokën prindërve.

Kjo gjendje patjetër që është në favor të prodhuesve të televizorëve dhe shitësve të tyre. Ata të cilët janë mërzitur nga lufta për të ndjekur programet e preferuara, zgjedhin rrugën e blerjes së televizorit të dytë, madje edhe atij të tretit për shtëpinë e tyre. Tashmë edhe televizorët i kanë holluar dhe bërë më elegantë dhe ngaqë montohen në mur, nuk zënë edhe shumë vend. Ofertat e shitjes u paraqesin konsumatorëve mundësi tërheqëse.

Ndërkohë që debatohet nëse televizori duhet apo nuk duhet të ekzistojë në shtëpi, tashmë familjet në shtëpitë e së cilëve ka televizor, kanë filluar ta shtojnë masën e kësaj makinerie duke e vendosur atë në dhomat e fëmijëve, madje edhe në kuzhinë. Pjesëtarët e familjes kanë filluar të qëndrojnë në dhoma të ndryshme, fëmijët nuk mësojnë më në dhomat e tyre, është ndërprerë edhe biseda në tavolinë, tashmë nuk i ka ngelur kuptim as ngrënies së ushqimit në të njëjtën tavolinë.

Bashkë me shtimin e numrit të televizorëve në shtëpi, shtohet edhe numri i telekomandave. Kjo gjendje në fillim i gëzon të gjithë, sepse secili ndjen se është i lirë të zgjedhë programin që dëshiron. Kështu zhduket detyrimi i sakrificës për pjesëtarët e tjerë të familjes. Zëri i sonancës shumëngjyrëshe ndërpritet dhe në të njëjtën shtëpi formohen botë të ndryshme. Dashamirësi i sportit ndjek vetëm kanalet sportive, dashamirësi i muzikës ndjek vetëm kanalet muzikore, kureshtari i lajmeve ndjek vetëm kanalet e lajmeve dhe në këtë mënyrë fushat e interesit dhe përzgjedhjet ndryshohen në mënyrën më radikale.

Ngaqë telekomandat bëhen pronë personale, rritet edhe më shumë koha e humbur përpara televizorit. Si përfundim brenda familjes formohen individë me forcë të njëanshme dhe shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri. Pjesëtarët e familjes largohen nga njëri-tjetri; po ashtu ata largohen nga njëri-tjetri edhe në shumë çështje të tjera si pikëpamjet e jetës, koncepti i vlerës, fushat e interesit, uniteti emocional dhe përzgjedhjet.



Në fakt debati i familjes për të rënë ose për të mos rënë në kompromisin e ndjekjes së bashku të një programi është një rrugë më cilësore komunikimi se sa tërheqja e secilit prej tyre në dhoma të ndryshme. Të jesh i vetëdijshëm për çështjet që interesohen pjesëtarët e tjerë të familjes edhe pse nuk të pëlqejnë, kjo gjë i shton fushat e përbashkëta të interesit dhe ndarjen reciproke.

Gjendja e shtëpive të atyre që kanë secili nga

një televizor dhe kompjuter, nuk quhet “liri”. Përdorimi në mënyrë të pakufizuar i burimit për të përballuar kërkesat dhe nënvlerësimi i interesave e nevojave të tjerëve nuk është liri, por egoizëm, sepse burimet jetësore në sipërfaqen e tokës janë të kufizuara. Askush nuk mund të posedojë çdo gjë. E vetmja rrugë për të qenë i lumtur me mundësi të kufizuara është arritja e pjekurisë për të bërë sakrificë reciproke. Duke e përdorur në këtë mënyrë televizorin, do të zhduket rreziku i varësisë dhe do të zvogëlohet koha që kalohet përballë tij.

Shpeshherë ndjekja e programeve televizive është humbje kohe për njerëzit. Çështja e parë që e ul sa më shumë dëmin, është shkurtimi i kësaj kohe sa më shumë të jetë e mundur, ulja bashkë me pjesëtarët e familjes për të ndjekur të njëjtin program dhe komunikimi i ndërsjellë. Në të vërtetë shkaqet e detyrueshme si ndryshimi i kushteve të jetesës, shkolla, puna dhe trafiku e kanë kufizuar jashtëzakonisht shumë kohën që pjesëtarët e familjes kalojnë së bashku. Humbja e kohës së mbetur përballë një makinerie pa ndjenja, nuk është gjë tjetër veç se “**Shpërdorim kohe**”.

Nëse akoma nuk e keni hequr televizorin nga shtëpia dhe keni akoma një të tillë në shtëpi, edhe ju jeni nga ata që përjetojnë debate në përzgjedhjen e kanaleve që do të ndiqen. Televizori i ri që do të sillni në shtëpi, vetëm do të zvogëlojë debatin për telekomandën, por bashkë me të do të sjellë shqetësime edhe më serioze dhe do të shfaqë vetmi mes kallaballëkut. Nëse në familjen tuaj ka më shumë se një televizor dhe nuk ka mirëkuptim mes pjesëtarëve të familjes, ndryshimin së pari duhet ta filloni duke shpëtuar nga gjërat e tepërta.



TË RINJTË NGUSHËLLOHEN ME ËNDRRA, TË MOSHUARIT ME KUJTIME

— Elif Menxhet —

Të rinjtë ngushëllohen me ëndrra, ndërsa të moshuarit ngushëllohen me kujtime. Kujtimet janë shtuar aq shumë, sa që edhe ne futemi në atë klasë...Më të mëdhenjtë na tregonin çdo herë kujtimet e tyre dhe ne ato na dukeshin si përralla. Kujtimet dhe këshillat që më parë nuk i vlerësonit, vjen një kohë që ju vjen menjëherë në mendje. Atëherë nuk i paskam dëgjuar me veshin e zemrës, por do të thotë se dashur pa dashur ato janë vendosur në vetëdijen time...

Më parë nuk kishte “familje bërthamë”; në çdo shtëpi jetonin gjyshërit, dajat, hallat, tezet. Ngaqë ishte familje e madhe, prindërit e rinj merreshin me punë, ndërsa fëmijët kalonin shumë kohë me

gjyshërit. I dëgjonin si një përrallë kujtimet e tyre të jetës me ndjenjën e dashurisë, lumturisë dhe sigurisë. Nuk kishte si në ditët e sotme televizor, internet, revista për fëmijë, madje nuk kishte as radio, por fëmijët nuk qëndronin kurrë pa njeri dhe nuk ngeleshin vetëm për vetëm me mendimet e botës së tyre të vogël, të cilat i bënin konfuzë dhe i fusnin në depresion. Shokët e lagjes dhe më të mëdhenjtë në shtëpi gjenin menjëherë një zgjidhje, për problemet e mëdha (!)...

Tani shikoj që fëmijët e vegjël kanë formuar një botë më vete në dhomën e tyre me ndikimin e rrymave negative përreth, sidomos interneti që është si thikë me dy tehe... Nëse nuk kontrollohen shpesh, në zemrat e tyre do të shfaqen humnera. Ka shumë të rinj të cilët nuk dinë të ndajnë me askënd asgjë të mirë apo të keqe dhe që për gjënë më të vogël negative, bien në depresion. Prindërit me universitet, gjenden ekonomike e kanë shumë të mirë, nëna ka dalë në pension, por fëmija bie herë pas here në depresion.

Qorton duke thënë:



“Pse nuk kam motër ose vëlla? Nëse do ta kisha, tani do ta ndaja çdo gjë me të. Gjatë fëmijërisë sime kam qenë gjithmonë i vetëm, sepse ju keni qenë të zënë me punë. Edhe në rrugë nuk më keni lënë të dilja, prandaj nuk kam shumë shokë!..”

Nëna thotë me shumë mërzë:

“Po të ishte mundësia, edhe unë do të kisha pasur dëshirë të kisha edhe një fëmijë. Ndoshta nuk do të kishim pasur kaq shumë pasuri, por fëmija im do të ishte i lumtur!..”

Më parë fëmijët loznin lloj-lloj lojërash në bahçe e në rrugë me shokët deri në mbrëmje, lodheshin dhe i harxhonin energjitë, pastaj ktheheshin në shtëpi, lanin duart e fytyrat, hanin ushqimin, bënin detyrat nëse shkonin në shkollë, përndryshe zhyteshin në gjumë të thellë. Sidomos nëse jetonit në qytezë, nuk ekzistonte shqetësimi i trafikut dhe të gjithë ishin të afërm ose fqinj me njëri-tjetrin.

Netët e gjata të dimrit, nëse kishte vende me distancë të mundshme për t’u vizituar nga të moshuarit, ata shkonin. Përndryshe preferonin të qëndronin në shtëpi me fëmijët. Ajo që më pëlqente më shumë në këto net, ishin përrallat që na tregonin më të mëdhenjtë.

Kur shkonim te të afërmit, nëse kishte rënë dëborë, flokët e borës shkëlqenin nga drita e hënës dhe ne mbushnim mushkëritë me ajër të pastër dhe gjallëroheshim... Zërat e dëborës nëpër këmbë, qeni apo macja e shtëpisë që na ngjitej pas, yjet që shkëlqenin si qelq, janë skena të paharrueshme të jetës sonë.

Një ditë në javë ishte teatri në radio. Atë ditë të gjithë të mëdhenj e të vegjël, mbaronin punët dhe uleshin e dëgjonin pa bërë zë sikur të ishin në teatër prej vërteti. Edicionet në radio nuk ishin aq të qarta, nganjëherë bënte zhurmë, por edhe pse mund të na ikte ndonjë gjë pa dëgjuar, përsëri dëgjonim me shumë vëmendje. Kur ishim ende të vegjël, nuk mund ta konceptonim se si realizoheshin edicionet e radios dhe bëheshim kureshtarë duke menduar: “Si vallë mund të hyjnë njerëzit në këtë gjë kaq të vogël?”. Përgjigjen e kësaj e merrnim me anë të shpjegimit të babait...

E çfarë është radioja? Në të ardhmen do të shpikej diçka që quhet televizor; i cili do të na tregojë të gjitha këto që flasin, qytetet, dhe ngjarjet!.. E shikoni hënën në qiell? Ja njerëzit do të shkojnë atje. Larg me shekuj, diçka që vetëm mund të imagjinohet...

Kishte aq pak ushqime të gatshme, sa mund të thuhej se nuk kishte. Qoftë i pasur apo i varfër, të gjithë ishin të detyruar ta përballonin vetë nevojën

e dimrit. Ngaqë komunikacioni nuk ishte i mjaftueshëm, nuk mund t’i blinin gjërat e nevojshme nga një vend tjetër. Të gjithë ishin të detyruar të shfrytëzonin produktet që prodhonin në zonën e tyre.

Qe luftë, prandaj në vitet e zisë së bukës, në çdo shtëpi sillnin nga një ose dy portokaj të cilët ndaheshin nga një thellë për çdo pjesëtar. Sigurisht që vinin me deve... Po ashtu, ekzistonte edhe pasioni për kafe. Ndonjëherë thoshim:

“Duam edhe ne!”

Na thoshin:

“Nuk pinë fëmijët, sepse nxihen!”

Ky ishte një shpenzim shtesë për familjet e mëdha dhe nuk ishte gjithmonë e mundur të sigurohej. Në çdo shtëpi vendosej soba dhe kjo e fundit ndizej sipas mundësisë me dru, qymyr ose plehra. Herët në mëngjes fshatarët i ngarkonin gomarët me kërcunj që i shkullnin nga malet dhe i sillnin për t’i shitur. Kur ndizej soba me qymyr, ngrohej i gjithë vendi rreth e rrotull. Sipër sobës vlonin çajnikët dhe në dhomë përhapej era e blirit të freskët.

Qetësimi që të jepte ngrohtësia, zëri që nxirrte uji na vinte si ninullë dhe kur ndikonte edhe era e çajit të blirit, zhyteshim në gjumin më të mirë. Sidomos me indiferentizmin që jepte fëmijëria, kalonim nga ëndrra në ëndërr dhe nuk e kuptonim madje se ishte bërë mëngjes...

Macja me qime të gjata flinte në jastëkun e veçantë prapa sobës sikur pothuajse kishte shtruar një qyrk. Ndërsa zëri i erës që frynte nga jashtë ishte një muzikë krejt tjetër. Në netët më të ftohta të dimrit familja mblidhej së bashku dhe ëmbëlsirat e sotme atëherë i bënin të gjithë bashkë në shtëpi. Shtrohej sofa, vendosej tepsia e madhe sipër saj, pastaj të gjithë prisnim me padurim ëmbëlsirën e cila po përgatitej.

Kur vinte mëngjesi, në çdo shtëpi fillonin përgatitjet për dimrin. Në të vërtetë, në Anadoll vera nuk mbante më shumë se tre muaj. Njerëzit atje thanin menjëherë pothuajse çdo perime, bëheshin salca, makarona shtëpie, turshi të ndryshme, lloj-lloj reçeli, marinade, djathëra, trahana, bullgur etj.. Pritej një lopë ose një dele, bëheshin suxhukë me makinë dore, vareshin në pe dhe thaheshin. Ndonëse jo gjithkush kishte vresht, të gjithë bënin pekmeze dhe suxhukë me arra. Rrush, ftoi, mushmolla vareshin në pe dhe ruheshin për në dimër. Të gjitha këto qëndronin me muaj dhe nuk prisheshin për një javë si tani. Shtëpitë kundërmonin erë ftoi dhe pjepr. Kishte shumë bereqet.



Të gjitha kafshët në kafazet e bahçes ushqeheshin me mbeturinat e shtëpisë ose grurë. Në çdo gjë kishte kënaqësi natyrore, ajër të pastër dhe ushqim të bollshëm. Babai im i ndjerë fundjavave merrte bukë nga furra, i hapte një vrimë në mes, e mbushte me vaj të pastër ulliri dhe sapo ftohej pak, e hanim. Bëhej aq e shijshme... Në dimër, kur prushi i qymyrit nxehej mirë, përgatiste menjëherë hellin dhe bashkë me të na servirte edhe sallatë qepe. Sidomos, kur vinin mysafirë, shkonte menjëherë te soba dhe na thoshte:

“Ju jeni fëmijë, ushqehuni mirë që të mos keni nevojë për mjek!”

Njohja ime me dëborën ka qenë shumë interesante. Unë kam lindur në Adana. Kur mbusha gjashtë vjeç, erdhëm në Keskin i cili mban veçori karakteristike të Anadollit të mesëm. Akoma nuk kisha filluar shkollën. Një mëngjes nëna më zgjoi duke më thënë:

“Ngrihu dhe shiko pak nga dritarja!..”

Shtëpia jonë ishte karakteristike e Anadollit të vjetër, me dy kate dhe me bahçe... Ngaqë ishte sipër arrës, kishte përballë malet, kodrat dhe rrugët e fshatit... Shtëpitë me rrugët e tyre kishin një fushëpamje të gjerë.

Kur shkova te dritarja, ngriva nga habia. Çdo anë pa asnjë boshllëk ishte mbuluar me të bardhë. Kjo ishte një panoramë e mrekullueshme!.. Çatitë e shtëpive, pemët, telat e telefonit, rrugët, çdo gjë dhe çdo vend pothuajse kishte ndryshuar formë.

Në shtëpi të gjithë më shikonin mua. Prisnin përgjigjen e pyetjes së tyre “Çfarë është kjo?” Çfarë mund të ishte? Deri më sot nuk ishte folur për të. Atëherë nuk kishte as televizor. Çfarë të thosha? U vështirësova shumë... Me çfarë gjëje nga bota ime e vogël mund ta përngjaja?..

“Miell!”, thashë.

“Si mund të jetë miell?”, thanë.

Atëherë thashë: “Sheqer pluhur...”

Më thanë: “Pse ta hedhin njerëzit sheqerin në rrugë?”

E vërtetë. Edhe kjo nuk qëndronte. Edhe pse nuk i ngjante, thashë “Hi!”.

“Pse i bardhë është hiri?” më thanë.

U bëra aq shumë kureshtar... Më në fund, u njoha me dëborën. Kush mund ta bënte një tablo kaq të bukur përveç Krijuesit?!

Një shoku im i tregon përralla nipit të tij që ta zërë gjumi, sepse tashmë fëmijët nuk flenë pa përralla. Një ditë i del një punë dhe i thotë gjyshit:

“Sot vëre ti të flejë, sepse mua më duhet të shkoj!..”

Erdhi koha që fëmija të flinte dhe ai i thotë gjyshit:

“Eja gjysh, më trego një përrallë!..”

Gjyshi i thotë:

“Po unë nuk di asnjë përrallë. Çfarë të të tregoj?”

Por fëmija këmbënguli “Dua përrallë!”

Pastaj gjyshi filloi:

“Atëherë të të tregoj fëmijërinë time!.. Ah more bir, kur ne ishim fëmijë, nuk kishim lodra. Luanim gjithmonë me makina prej teli apo kutie, me shtëpi prej rëre, ose bënim diçka vetë. Nuk kishim biçikletë ashtu siç ke ti. Rrobat na i qepte nëna ose vishnim të vëllezërve. Madje as çantë shkolle nuk kisha. Nëna më pati qepur një çantë prej lecke dhe me atë shkoja në shkollë. Që të mos më griseshin këpucët, nganjëherë ecja zbathur, nganjëherë i vishja ato. Kisha vetëm një laps dhe kisha shumë frikë se më mbarohej.”

Fëmija, pasi me shumë durim dëgjoi deri këtu, mori frymë thellë tha:

“Gjysh, mua nuk më pëlqeu aspak fëmijëria jote!..”

Unë u zhyta në të kaluarën time të vjetër, por mund të ketë edhe nga ata që nuk u pëlqen.

Thonë se tani kanë ndryshuar kohërat. Po, kanë ndryshuar shumë gjëra. Teknologjia çdo ditë prodhon gjëra të reja, mundëson lehtësime që nuk ta merr mendja. Ndërsa të moshuarit nuk mund ta ndjekin këtë teknologji përparuese. Kjo nga ana e fëmijëve dhe të rinjve konceptohet sikur “të moshuarit nuk dinë asgjë”... E vetmja gjë që nuk ndryshon



është... Fëmija gjithmonë është i pastër dhe naiv... Jemi ne të mëdhenjtë që i ndryshojmë ata...

Kurrë të mos themi: “Fëmijë janë, nuk kuptojnë gjë!”

Gjërat që ne na duken normale, në botën e tyre zënë një vend të tillë, saqë pas shumë vitesh të thonë: “Ti ke thënë kështu” ose: “U bë kështu”.

Kur përballem me një ngjarje, pas shumë vitesh më vijnë në mendje fjalët e gjyshes sime të ndjerë. Një fjalë e urtë thotë: “Dijet që merren në fëmijëri, janë si t’i kesh gdhendur në gurë. Ndërsa dijet që merret në pleqëri janë si fjalët e shkruara në rërë”. Kohë më parë dëgjova një kujtim të një të afërmit tonë biznesmen.

Ky biznesmen doli për turizëm në Lindjen e largët bashkë me gruan e tij. Me qëllim që të shëtisnin, të bënin Pazar dhe kur të ktheheshin nga pushimet të mburreshin përpara shokëve, hyjnë në një dyqan duke thënë: “Meqë erdhëm, të shëtisim nëpër dyqane dhe të shohim për pëlhura të ndryshme...”. Pëlhura që pëlqyen ishte shumë e shtrenjtë, por ngaqë u pëlqeu, ata kërkuan të bëjnë pazar. Pronari i dyqanit tha se nuk mund t’u bënte shumë zbritje. Ndërkohë që kjo çështje po zgjatej, pronari i dyqanit, i pyeti:

“Nga cili vend vini ju?”

Kur ata i thanë se vinin nga Turqia, pronari i dyqanit e preu menjëherë pëlhurën, e paktoi bukur dhe ia dha zonjës, duke thënë:

“Këtë e keni dhuratë nga ne!..”

Veprimi i këtij burri i cili pak më parë nuk pranonte të bënte as pazar, i habiti këta tanët. Ai tha:

“Meqë ju vini nga Turqia, ju jeni nipër Osmanësh, prandaj ne nuk marrim para nga ju. Ju lutem pranojeni!..”

Kur ai filloi të pyeste: “Në cilin hotel qëndroni?

Ku do ta falni nesër namazin e xhumasë?”, burri u habit edhe më shumë, por nuk mundi të thoshte “çfarë namazi, çfarë xhumaje?”.

Kishte vite që nuk i kishte

rënë në mendje të shkonte në xhami e jo më të falte namazin e xhumasë. Jeta e kësaj bote e kishte mbërthyer aq fort atë, saqë papritur nuk diti çfarë të thoshte.

Tregohet një anekdotë e Nastradin hoxhës. Një ditë e pyesin hoxhën. “Hoxhë, cila ditë e Ramazanit është sot?” Nastradin hoxha e shikon se nuk po e gjente fillin dhe përgjigjet:

“Bir unë jam i huaj në këtë qytet!..”

Ashtu si Nastradin hoxha edhe ai i përgjigjet:

“Unë sapo kam ardhur dhe nuk e di se cila xhami është më afër!”

Pronari i dyqanit i thotë:

“Më jepni adresën e hotelit dhe unë do të dërgoj nesër shoferin t’ju marrë!..”

Edhe pse burri i tha: “Ju lutem, mos u mundo-ni!..”, pronari i dyqanit këmbënguli duke thënë:

“Nuk mund t’ju lë, ju jeni mysafirët tanë!..”

Këta tanët largohen nga aty me falënderime. Në mëngjes vjen makina dhe shkojnë në xhami. Burri shkon menjëherë dhe flet me imamin. Pastaj vjen me xhubbe (manteli i imamit) në dorë drejt mysafirit dhe i thotë:

“Urdhëroni zotëri, na e falni ju namazin e xhumasë!..”

Edhe pse ai, duke menduar se tregohet modest, tha: “Si ta fal unë ndërkohë që është hoxha?”, ata e vunë të falte namazin e xhumasë duke i thënë:

“Ne na vjen turp të bëhemi imamë për ju, ndërkohë që jeni ju nipërit e Osmanëve, nipërit e Fatihut! Ju lutemi!..”

“Ja, aty dhashë provimin më të vështirë”, thoshte i afërmi ynë... Pastaj i shprehu ndjenjat dhe mendimet’ duke thënë:

“O Zot, çfarë do të bëj? U bënë vite që unë nuk e kam vënë kokën në sexhde. Pastaj i kërkova ndihmë Allahut të Lartësuar, sepse nuk dija çfarë të bëja me aq shumë njerëz pas që më prisnin mua... Të lutem më ndihmo o Zot, nuk do t’i lë më namazet!.. Të lutem mos më lër të turpërohem! Nuk dija shumë lutje. Kur isha i vogël, shkoja me gjyshin në xhami. Dija vetëm ato që më kishin ngelur në mendje që nga ajo kohë... Zoti m’i solli në memorie, por nuk di se si e fala atë namaz?! Të gjithë vijnë në vendin tonë dhe mësojnë fenë, ndërsa unë shkova dhe mësova në një vend tjetër.”

Asgjë e bukur që i mëson fëmijës nuk shkon dëm. Allahu na dhëntë bukuri në zemër, gjuhë dhe përreth nesh. Amin!



Rregullat e ngrënies dhe pirjes në masën profetike

— Nexhla Bash —

Dietat e llojllojshme, trajtimet dhe ilaçet e dobësimit nuk janë gjë tjetër përveç se vuajtje në emër të ushqyerjes së shëndetshme.

Mbipesha në ditët e sotme është problem për shumë njerëz... Thelbi i kësaj është ushqyerja e pashëndetshme dhe zakoni i të ngrënit pa masë. Njerëzit që nuk bëjnë kujdes ndaj peshës së tyre e kërkojnë zgjidhjen te këshillat e dietologëve, kurat bimore, tabletat e dobësimit ose te këshillat e miqve. Ku është në fakt zgjidhja?

Në të vërtetë zgjidhjen e gjejmë te vetja jonë, duke u bërë “doktorë të vetes”... Vetëm nëse jetojmë në një regjim që zbaton këshillat në lidhje me mjekësinë mbrojtëse, mund t’i japim hakun shëndetit të trupit. Përveç sëmundjes, e cila është sprovë nga Allahu Teala...Prandaj është parë e pëlqyer që njeriu të dijë disa gjëra nga mjekësia sa për t’u larguar nga gjërat e dëmshme për shëndetin. Ne mund të jetojmë të shëndetshëm përgjatë gjithë jetës duke u mbështetur në masat profetike në lidhje me këtë çështje. Disa prej specifikave me rëndësi jetike nga masat profetike, mund t’i radhisim kështu:

MOSNGRËNIA PA PASUR URI

Edhe në shkrimet e mëparshme, jemi shprehur se i Dërguari i Allahut, (a.s.), ka thënë:

“Biri i Ademit nuk ka mbushur enë më të keqe se stomakun e tij. Birit të Ademit, i mjaftojnë disa kafshata për të qëndruar në këmbë. Por, nëse do ta mbushë stomakun, të paktën ta ndajë atë në tri pjesë. Një të tretën për ushqimin, një të tretën për ujin dhe një të tretën për frymën...” (Tirmidhi, Zuhd, 47.)

Nëse bëjmë kujdes, i Dërguari i Allahut, (a.s.), përdor një shprehje në formën: *“Nëse do ta mbushë stomakun...”* Edhe nëse e mbush stomakun, Ai (a.s.), thotë se stomaku duhet të ndahet në tri pjesë. Për fat të keq, siç nuk ia dalim mbanë për ta ndarë stomakun në tri pjesë në çdo vakt të ngrënies, kemi filluar të përballemi me sëmundje në moshë të re, ngaqë e mbushim tejet plot stomakun dhe ushqehemi në mënyrë të çrregullt. Madje kjo gjendje, e përfshin edhe të gjithë sistemin e tretjes dhe e bën njeriun të ketë nevojë për mjekim. Transmetohet se i Dërguari i Allahut, (a.s.), në lidhje me këtë çështje ka thënë:

“Mos e vrisni zemrën tuaj duke ngrënë dhe duke pirë shumë, sepse zemra është si të mbjellat. Nëse të mbjellave u hidhet shumë ujë, ai i dëmton ato.”

Të hash pa pasur uri, do të thotë se në trup hyn më shumë energji, edhe pse ai nuk ka nevojë për atë energji. Kjo energji e tepërt, depozitohet si dhjamë dhe njeriun fillon të shëndoshet. Koha e mjaftueshme ndërmjet dy vakteve të ngrënies, ia mundëson trupit që së pari të përdorë lëndën energjetike të depozituar në muskuj e në mushkëritë e zeza si vakt ndërmjetës dhe pastaj dhjamërat e depozituar. Në saj të kësaj, arrihet kontrolli i kileve të shëndetshme.

Njeriu ndjen dy lloj urie: Atë “fiziologjike” dhe atë “psikologjike”. Gjatë urisë fiziologjike, nga nevoja e trupit për ushqim, ndihen dhimbje të lehta stomaku. Ndërsa gjatë urisë psikologjike bëhet fjalë për kushtëzimin. Urisë psikologjike ke ndryshe i thonë edhe “Uri e rreme”. Gjatë urisë fiziologjike, dhimbjet ndihen 12-24 orë me ndërprerje. Ndërsa uria psikologjike ndihet në një kohë më të shkurtër se 12 orë. Edhe pse caktohen dhe zbatohen oraret e ushqimit, pas 5-7 ditësh trupi i përshtatet kësaj dhe kur vjen ora, njeriu e ndjen veten të uritur. Kjo gjendje i ngjan gjendjes së atij njeriu që është mësuar të bëjë mëngjes dhe ta hajë drekën në punë. Ja kjo gjendje quhet **“uri e rreme”**. Për të larguar këtë uri, duhet të pihet ujë në mënyrë të ngadaltë.

Kur fillon muaji i Ramazanit dhe pasi kalojnë disa ditë, ushqimi i drekës harrohet dhe njeriun nuk e merr uria. Ky është një tjetër presion kushtëzimi e urisë psikologjike. Ndërsa uria fiziologjike është ajo uri që ndjehet me dhimbjet e urisë në orën 20:00 nëse ke bërë mëngjes në orën 8:00. Prandaj përveç rasteve të sëmundjes së diabetit, për të shëndetshmit rekomandohen dy vakte në ditë për t’iu përshtatur urisë fiziologjike.

Edhe Pejgamberi, (a.s.), hante dy vakte në ditë. Madje edhe atë shumicën e rasteve s’e gjente. Në lidhje me këtë Abbasi, (r.a.), ka thënë:

“Kishte raste kur Pejgamberi, (a.s.), flinte me net të tëra pa ngrënë asgjë. Madje, Ai dhe pjesëtarët e familjes nuk kishin asgjë në sofër për të ngrënë për darkë. Ndërsa buka që hanin ishte prej elbi.”



Nëse hamë pa na marrë uria, i japim trupit ushqim të ri pa i dhënë kohë të tretet ushqimit që kemi ngrënë më parë. Ndërsa ushqimi që akoma nuk është tretur, kur përzihet me ushqimin e ri, vështirësohet tretja e të dyve së bashku. Për më tepër i gjithë ushqimi merr erë, formohen pllaka në zorrë, ç’ekuilibrohet flora në zorrë, formohet kapsllëku, zhvillohen mangësitë e përthithjes, papastërtia e gjakut, strukturës dhe shumë sëmundjeve të tjera.

TË MOS E TEJMBUSHËSH STOMAKUN

Kapaciteti i një stomaku normal është përcaktuar 1-1.5 litra. Nëse zbatohet hadithi fisnik në të cilin shprehet se një e treta e stomakut duhet të ndahet për ushqim, në një vakt në stomakun tonë duhet të hyjë një masë ushqimi prej 333-350 mlt. bashkë me ujin kjo masë shkon 600-1000 mlt. Kjo në zorrën dymbëdhjetëgjishtore me diametër 4-5 cm dhe gjatësi 20-25 cm është e barabartë me afërsisht 700-1570 cm³.

Nëse personi nuk ngrihet nga tavolina pa u ngopur dhe dëshiron të hajë shumë ushqim, zorrët e kanë kapacitetin ta kompensojnë këtë. Pra pjesa e mesme e zorrës së hollë, edhe pse kapacitetin e ka 4 lt, ka një veçori të gëlltisë deri në 10 lt. Allahu me madhështinë dhe mëshirën e Tij ua ka dhënë aftësinë kompensuese sistemit të zorrëve atij që ha shumë. Megjithatë Pejgamberi, (a.s.), ka shprehur një masë ideale ushqyerjeje me hadithin:

*“Nje besimtar ha sa për të ngopur një zorrë, ndër-
sa jobesimtari ha aq sa për të ngopur shtatë zorrë.”*
(Buhari, Et’ime, 12.) Me një përkufizim të përafërt, në një vakt në stomak duhet të futen dy grushta ushqim, një masë ujë dhe pjesa tjetër duhet të lihet për ajër.

GJATË USHQYERJES KAFSHATAT TË PËRTYPEN MIRË

Ky hadith fisnik, i cili i përshtatet jetës së kësaj kohe e cila kalon më ngutshmëri, këshillon që të mos nxitohemi madje edhe kur ushqehemi:

“Merrini kafshatat sipas gojës dhe gëlltitini ato pasi t’i keni përtypur mirë.”

Kur hani ushqim është shumë e rëndësishme gjatësia e kohës së vaktit. Ushqimi duhet përtypur dhe bluar mirë në gojë, gjë e cila është dera e sto-

makut. Sa më e gjatë të jetë koha e përtypjes dhe sekrecionet, aq shumë ndihet masa e ndjenjës së ngopjes.

Përtypja e mirë e kafshatave mundëson ngopjen e shpejtë. Ndjenja e ngopjes nuk ka lidhje me masën e ushqimit, por me kohë e përtypjes së tij në gojë. Për të vërtetuar këtë janë bërë edhe eksperimente.

Kafshët, 20-40 minuta pasi e hëngrën ushqimin, nuk treguan interes për ushqimin tjetër u vunë përpara dhe nuk e hëngrën atë. Nga kjo kuptohet se për ndjenjën e ngopjes, përveç sasisë dhe përmbajtjes së ushqimit, e rëndësishme është edhe koha e përtypjes në gojë. Sidomos ata që mbajnë dieta, duke bërë kujdes në këtë çështje, duhet t'i përtypin mirë në gojë ushqimet me kalori të ulët dhe të qëndrojnë të paktën 20 min në tavolinë duke bërë që të ndihen të ngopur.

MOSNGRËNIA E USHQIMEVE TË NDRYSHME NË TË NJËJTIN VAKT

Sofra e një familjeje me të ardhura më të pakta mendoj se është më e pasur se sofra e sahabëve të nderuar. Është e vërtetë se në sofrën e ditëve të sotme nuk shihet vetëm një lloj ushqimi në sofrën e një vakti, por të paktën sallatë, ëmbëlsirë ose supë në të njëjtën kohë. Ose lista zgjatet kur themi edhe pjata kryesore, aperitivi etj.

Gjëra të tilla e dëmtojnë stomakun e trupin, janë harxhim i padobishëm kohe dhe kanë të tjera anë negative të cilat ndjekin njëra-tjetrën. Kështu, duke konsumuar shumë ushqime së bashku, tretja e së cilave mund të jetë e pamundur në të njëjtën kohë, rrezikojmë shëndetin.

Aplikimi më praktik në këtë çështje është mospërdorimi në të njëjtën kohë i drithërave me ushqimet shtazore. Ndërsa perimet të shihen si ushqime të cilat mund të konsumohen qetësisht bashkë me çdo lloj ushqimi tjetër. Ushqimet që nuk mund të treten plotësisht, bëhen shkak për pllakat e zorrëve dhe daljen e shumë problemeve të njëpasnjëshme si dhe shkaktimin e shumë sëmundjeve.

1.5-2 ORË PAS NGRËNIES TË PIHET UJË ULUR

Pirja në sasi të shumtë e ujit gjatë ushqimit dhe

pas
tij ho-
llojnë pësh-
tymën, lëngun e sto-

makut dhe enzimat e zorrëve, po ashtu, duke ulur rendimentin tretës, e lodh më shumë stomakun. Nëse gjatë ngrënies ose pas saj pihet shumë ujë, stomaku fryhet. Kjo gjendje bëhet shkak për hollimin e lëngut të stomakut si dhe pakëson lëvizjet e tij. Të dy shkaqet çojnë në çrregullimin e tretjes në stomak. Kjo gjendje bëhet shkak për pllakat e zorrëve dhe daljen e shumë problemeve të njëpasnjëshme si dhe shkaktimin e shumë sëmundjeve.

Nëse ushqimi është shumë i fortë, gjatë ngrënies mund të pihet nga pak ujë në gllënjka të vogla. Njeriun zakonisht e merr etja kur stomaku boshatiset dhe ai merr ujin që i duhet trupit. Pra, kur kemi nevojë për ujë, trupi na njofton. Koha më e përshtatshme për të pirë ujë është 2 orë para ushqimit ose 2 orë pas ushqimit.

Këshillën e Pejgamberit, (a.s.), që uji të pihet ulur dhe me tre gllënjka, nga ana e shëndetit mund ta përkufizojmë kështu: Kur një njeri e pi një lëng në këmbë, ai lëng shkon drejt e në zorin dymbëdhjetëgjishtore. Nëse e pi ulur, së pari shkon në stomak, pastaj në zorrën dymbëdhjetëgjishtore. Kur lëngjet shkojnë së pari në stomak, mikrobet që gjenden në lëngje, me ndikimin e acideve të stomakut, vdesin. Kështu mund të mbrohem nga shumë sëmundje.

TË MOS HAHEN USHQIME SHUMË TË NXEHTA OSE SHUMË TË FTOHTA

Pejgamberi, (a.s.), këshillon e thotë:

“Mos e hani ushqimin shumë të nxehtë ose shumë të ftohtë!”

Ushqimet duhet t'i zgjedhim të ngrohta apo të ftohta sipas shijes së gjuhës ose sipas dëshirës. Veçanërisht mjekët bëjnë të qartë se ngrënja e ushqimit të vakët është e rëndësishme në çështjen e shëndetit të stomakut. Për më tepër, ushqimet e nxehta ose të ftohta ndikojnë negativisht te dhëmbët dhe shkaktojnë çrregullime të tjera.

Nga kërkimet e bëra është vërtetuar se burimi

i kancerit të stomakut dhe ulcerës mbështetet te ushqimet e nxehta. Veçanërisht në Japoni, ngaqë ushqimet konsumohen të nxehta, raporti i kancerit të stomakut është shumë i lartë.

TË MOS HAHEN USHQIME TË SHPEJTA TË CILAT SHPEJTOJNË PLAKJEN

Ndodh që goja jonë të mos jetë bosh edhe në kohën kur nuk jemi të uritur. Sidomos zakoni i ngrënies herë pas here ushqime të shpejta përmban shumë dëme për shëndetin. Pra, të hash vazhdimisht diçka, duke filluar me sistemin tretës, ua shton barrën të gjitha sistemeve, si atij të jashtëqitjes, sistemit imunitar, sistemit nervor dhe sistemeve të tjera. Po ashtu, nuk lejon që procesi të kryhet ashtu siç duhet. Kjo gjendje mundëson rritjen e toksinave në trup. Në këtë mënyrë, trupi sëmuret dhe procesi i plakjes shpejtohet.

VIRTYTET E AGJËRIMIT DHE URISË

Llukmani, alejhisselam, e këshillon kështu të birin e tij: “Nëse mbushet stomaku, meditimi zhytet në gjumë dhe gjymtyrët nuk mund të bëjnë adhurim.” Dijetarët kanë thënë se agjërimi dhe uria kanë dhjetë cilësi të bukura. Ata i radhisin këto dhjetë cilësi si më poshtë:

1. Në agjërim zemra argëtohet, shpirti përulet përpara Allahut Teala dhe syri është i mprehtë. Ndërsa ngopja shkakton dembelizëm dhe e verbon largpamjen.

2. Gjatë urisë zemra bëhet më e ndjeshme. Si përfundim i kënaqësisë së zemrës, njeriu fillon të kuptojë shijen e lutjes dhe shikon ndikimin e adhurimeve.

3. Në agjërim njeriu bëhet modest dhe largohet nga ai llastimi.

4. Kur është në agjërim njeriu nuk i harron ata që kanë rënë në fatkeqësi, të dëmtuarit dhe të mjerët. Ndërsa të ngopurit i harrojnë të uriturit dhe nuk e kuptojnë gjendjen e të dobëtve e të varfrit.

5. Uria e largon gjumin, i cili e poshtëron njeriun. Ndërsa ai që ha shumë, fle shumë dhe ai që fle shumë bëhet i pakujdesshëm.

6. Uria i thyen të gjitha dëshirat e mëkatit dhe e mposht nefsin i cili vazhdimisht të shtyn drejt së keqes.

7. Gjatë urisë lehtësohet vazhdimësia e

adhurimeve. Ndërsa ngopja e vështirëson adhurimin dhe vazhdimësinë e tij.

8. Gjatë urisë trupi dhe gjymtyrët janë të shëndetshme; largohen sëmundjet, sepse shkaku i sëmundjeve është e ngrëna e tepërt, pirja e tepërt, gjumi i tepërt dhe gjaku i tepërt.

9. Ai që e bën zakon të ngrënës e pakët, mjaftohet me pak pasuri dhe kalon një jetë të thjeshtë e pa shqetësime.

10. Kur je i uritur e jep me zemër të qetë sadakanë.

Si përfundim, Muhammed bin el-Haris, rahmetullahi alejh, thotë:

“Pesë grupeve, u bëra pesë pyetje. Të gjithë më dhanë të njëjtën përgjigje. I pyeta doktorët: ‘Cili është mjekimi më shëruës?’ Më thanë: ‘Uria dhe të ngrënës e pakët.’ I pyeta dijetarët e fesë: ‘Cila gjë të ndihmon më shumë në adhudhimin ndaj Allahut?’ Më thanë: ‘Uria dhe të ngrënës e pakët.’ I pyeta asketët: ‘Çfarë e forcon më shumë asketizmin?’ M’u përgjigjën: ‘Uria dhe të ngrënës e pakët.’ I pyeta dijetarët: ‘Cila gjë e ndihmon më shumë mësimin e dijes?’ Më thanë: ‘Uria dhe të ngrënës e pakët.’ I pyeta sulltanët: ‘Cila është zgjidhja e të qenit gjithmonë i kujdesshëm dhe ushqimi më i shijshëm?’ U përgjigjën: ‘Uria dhe të ngrënës e pakët.’”

Jahja bin Muadh, (r.a.), ka thënë: “Nëse uria do të ishte diçka që shitej në treg, kërkuesi i ahiretit nuk do të kishte nevojë të blinte asgjë tjetër përveç urisë.”





KOS I KULLUAR

për Stomakun, Osteoporozën dhe Tensionin e Gjakt

Kosi është një nga ushqimet që nuk mungon kurrë në frigoriferin e një amvise shqiptare.

Shumë amvisa e zënë kosin vetë një herë në dy ose tre ditë për t'u siguruar që ky produkt nuk do të mungojë asnjëherë.

Kosi është një produkt mirëbërës për të rritur dhe për fëmijë.

Ai prodhohet nga fermentimi i qumështit dhe është i pasur me proteina, kalçium, vitaminë B6, B12 dhe probiotikë.

Kosi i zënë në shtëpi është më i hollë se ai i industrializuar, megjithatë ai mund të kullohet duke ofruar një kos më të trashë dhe të përqendruar në vlera.

Më poshtë do të gjeni një mënyrë shumë të thjeshtë dhe praktike për përgatitjen e kosit të kulluar në kushtet e shtëpisë.

Ju mund të merrni kosin e zënë, ta hidhni nëpër napa të pastra duke u dhënë formën e trastës dhe t'i lini të kullojnë për 10-12 orë.

Kjo është një mënyrë e ngjashme me atë të përgatitjes së salcës së kosit e cila pasurohet më pas me kripë, vaj ulliri, arra ose majdanoz.

Kosi i kulluar është shumë i trashë dhe i dendur.

PËRGATITJA:

Marrim kosin dhe e transferojmë në një napë të pastër të cilës i japim formën e një traste të thjeshtë.

Trasta varet në një vend të caktuar në kuzhinë dhe lihet të kullojë për 12 orë. Vendosni një enë poshtë nëse nuk keni një vend ku të rrjedhë lëngu.

Pasi kosi ka kulluar plotësisht, hapeni trastën e napës dhe hidhni masën e përqendruar të kosit në një enë qelqi.

Kosi duhet ngrënë rregullisht sepse ofron një larmi vlerash shëndetësore të cilat i gjeni më poshtë.

SHËNDETI I STOMAKUT

Kulturat e gjalla tek kosi janë efikase kundër konstipacionit, diareisë, inflamacionit të zorrëve, kancerit të zorrës së trashë e të tjerë.

Këto probiotikë përforcojnë imunitetin dhe mbrojnë stomakun nga infeksionet.

OSTEOPOROZA

Brishtësia e kockave vjen si pasojë e ndryshimeve hormonale dhe mungesës së vitaminave D dhe kalçiumit.

Kosi është i pasur me kalçium dhe konsumimi i

rregullt i tij përmirëson strukturën e kockave.

TENSIONI I GJAKUT

Studimet kanë konfirmuar se produktet e bulmetit kanë aftësinë të rregullojnë tensionin e gjakut.

Me sasinë e duhur të produkteve me pak yndyrë, rreziku i tensionit të lartë të gjakut bie me 50 përqind.

PESHA

Kosi është ideal për të kufizuar kaloritë. Ai shuan urinë dhe nepsin për ushqime të ëmbla.

Pasi përthithet, kalçiumi nga kosi ndikon që qelizat e yndyrës të ulin prodhimin e kortizolit ndërkohë që amino acidet djegin yndyrën e tepërt.

Rekomandimet gjithnjë vlejnë për kosin me pak yndyrë.

Tre ushqime që pastrojnë rrënjësisht MUSHKËRITË

Mushkëritë luajnë një rol thelbësor në sistemin e frymëmarrjes.

Ato marrin oksigjenin dhe filtrojnë jashtë organizmit toksinat.

Ruajtja e shëndetit të mushkërive dhe funksioneve të tyre është thelbësore.

Mushkëritë e shëndetshme garantojnë që i gjithë organizmi të ushqehet siç duhet me oksigjen.

Një mënyrë për të përmirësuar shëndetin e mushkërive është që të konsumoni ushqime me aftësi pastruese.

Sigurisht që aktiviteti fizik, mospirja e duhanit dhe shmania e ndotjes janë gjithashtu mënyra të mira për të garantuar shëndetin e mushkërive.

Ushqimet luajnë një rol kryesor për mirëqenien e këtij organi.

Barishtet, hudhra, agrumet, frutat e pyllit dhe xhenxhefili janë ndër ushqimet më të rekomanduara për shëndetin e mushkërive.

Në këtë artikull do të mësoni për tre ushqimet më të mira që pastrojnë mushkëritë.

FISTIKËT

Fistikët janë shumë të rëndësishëm për shëndetin e mushkërive.

Sipas informacioneve, fistikët përmbajnë një lloj të veçantë të vitaminës E, e cila ofron mbrojtje ndaj disa formave të sëmundjeve të mushkërive.

Fistikët ndihmojnë në uljen e kolesterolit dhe të ngopin lehtë e pa kalori, të cilat janë përgjegjëse për shtimin në peshë.

SPECI DJEGËS

Speci djegës është një erëz shumë e fuqishme dhe mirëbërëse për organizmin.

Ai ofron me dhjetëra përfitime për shëndetin e njeriut.

Speci djegës ndihmon në shuarjen e kollës që irriton fytin në vazhdimësi.

Ekspertë thonë se speci djegës parandalon problemet me të ftohurën dhe gripin.

Kjo erëz shpërbën sekrecionet dhe rekomandohet për gjithëkënd që vuan nga bronshiti apo problemet me rrugët e frymëmarrjes.

USHQIMET E PASURA ME OMEGA-3


Acidet yndyrore omega-3 ndihmojnë në pastrimin e mushkërive dhe efikasitetin e sistemit të frymëmarrjes.

Salmoni, sardelet, farat, arrorët dhe vezët janë shumë të pasur me acide yndyrore omega-3.

Këto ushqime kanë gjithashtu aftësinë të shmangin inflamacionin në organizëm dhe të përmirësojnë shëndetin mendor.



SI I PERCEPTON TRURI AROMAT?



Identifikohen qarqet e trurit që lejojnë gjitarët të dallojnë aromat.

”Ato janë të njëjta në lloje të ndryshme qeniesh të gjalla, nga macet tek njerëzit, dhe janë ruajtur gjatë zhvillimit të evolucionit”, sipas studimit të botuar në revistën ”Current Biology” nga Instituti Amerikan i Studimeve Biologjike.

Duke përdorur teknika të ndryshme mikroskopike,



studiuesit identifikuan tre komponentë themelorë të qarqeve të nuhatjes dhe fakti se ato janë të ruajtura në së paku gjashtë lloje të ndryshme të gjitarëve është një shenjë e rëndësisë së tyre.

Elementet e para janë receptorët e hundës të pranishme në hundë, ku molekulat që përcjellin aromat janë të lidhura me njëra-tjetrën.

Receptorët pastaj transmetojnë stimujt nervorë të shoqëruar me aromat edhe në pjesën frontale të trurit.

”Numri i qelizave të nuhatjes në hundë është i lidhur me atë të dy komponentëve të tjerë të qarkut. Në këtë mënyrë duke ditur numrin e receptorëve në hundë është e mundur që të rindërtohet indikativisht ajo e dy rajoneve të trurit të përfshirë në perceptimin e aromave”, shpjegon një nga studiuesit.

LIDHJA NË INTERNET DO TË BËHET PËRMES DRITËS

Në të ardhmen do të mjaftojë thjesht një llambë LED për të qenë gjithnjë të lidhur në internet me kompjuterin, tabletën dhe smartfonin, ky është revolucion i ”Li-Fi”, një ”Wi-Fi” prej drite që do të mundësojë transmetimin e shpejtë të sasive të mëdha të të dhënave duke garantuar një mbrojtje më të madhe të komunikimit.

”Ndërsa Wi-Fi përdor valët radio, Li-Fi përdor ato elektromagnetike”, shpjegon Michele D’Amico doktor i ”Wireless and Mobile Propagation” në Politeknikun e Milanos.

Për të krijuar lidhjen në internet do të mjaftojë vetëm një llambë LED me ndriçim normal.

Drita e dukshme e ndryshuar në shpejtësi të lartë transmeton të dhëna drejt pajisjes së përdoruesit,

kompjuter apo smartfon, që duhet të jetë i pajisur me një aparaturë që transformon ndryshueshmërinë e ndriçimit të LED në sinjale elektrike.

”Mes pikave të forta të Li-Fi është rrezja optike, që garanton mbrojtjen e ndërhyrjeve nga sistemet e tjera dhe një mbrojtje më të lartë nga përgjimet. Për më tepër, meqenëse nuk përdor frekuencat radio, Li-Fi mund të përdoret në avionë dhe spitale”, thekson eksperti i Politeknikut.

”Megjithatë kjo teknologji e re ka edhe limite. Li-Fi nuk tejkalon pengesat si muret për pasojë duhet të instalohet një pajisje në çdo ambient ku dëshiron të lidhesh në internet. Për më tepër duhet që dritat të mbeten gjithnjë ndezur, edhe ditën”, shpjegon D’Amico.



DIELLI KA "PERSONALITET" TË DYFISHTË

Dielli ka një "personalitet" të dyfishtë pasi fusha e jashtme magnetike e tij ndjek një ritëm të ndryshëm nga ajo e brendshme, sipas studimit të Universitetit amerikan të Kolorados, i paraqitur në konventën e Shoqatës Astronomike Amerikane që po zhvillohet në SHBA, Saint Louis.

Fizikanët Loren Matilsky dhe Juri Toomre kanë zhvilluar një simulim kompjuterik për të studiuar brendësinë e Diellit, të cilin dy studiuesit e krahasojnë me "një enë sferike me ujë të valuar".

Ata gjetën, çuditërisht, se ylli ynë ndonjëherë tregon devijime nga sjellja e tij normale, në formën e dallimeve në mes të fushës magnetike të jashtme dhe të brendshme, sikur të kishte një lloj

"egoizmi".

Për autorët e hulumtimit, ky zbulim mund të ndihmojë në kuptimin e mekanizmave që rregullojnë orën e brendshme diellore. Në fakt, ylli ynë ndryshon periudhat e aktivitetit intensiv, të karakterizuar nga shfaqja e pikave diellore karakteristike, me periudha të qetësisë relative.

"Ne nuk e dimë se çfarë rregullon këtë cikël dhe pse, për shembull, disa cikle janë më të dhunshëm se të tjerët. Ajo që mund të bëjmë është të monitorojmë aktivitetin e Diellit dhe të përpiqemi ta riprodhojmë atë në laborator nëpërmjet superkompjuterave, në një përpjekje për të bërë parashikime rreth sjelljes së tij", shpjegon fizikani Matilsky.

NË MARS ZBULOHEN MIJËRA VULLKANE PREJ BALTE

Në Mars është një zonë prej 12 000 kilometrash katrorë e mbushur me mijëra vullkane prej balte, pra struktura të krijuara nga ngritja e ujit nga thellësia, sedimenteve dhe gazit dhe jo nga dalja e llavës.

Të zbuluara nga një kërkim italian, i kryer nga Universiteti i Padovas dhe të përshkruar në revistën "Scientific Reports", vullkanet janë të hershëm dhe hapin skenarë të rinj në lidhje me praninë e ujit në nëntokën e planetit të kuq.

Krijimi i vullkaneve të baltës ka ndodhur rreth 370 milionë vite më parë, në një epokë shumë të hershme për kohën gjeologjike marsiane dhe ky zbulim është mjaftueshëm për të vënë në dyshim shumë njohuri mbi planetin e kuq.

"Ky është një zbulim që vë në dyshim aktivitetin e planetit dhe hap një kapitull të ri pyetjesh në lidhje me sasinë e ujit që ka mbetur e bllokuar në thellësi të planetit", thekson Barbara De Toffoli, e departamentit të Gjeoshkencave.

Nga ky studim dalin të dhëna që ndihmojnë në kuptimin e evolucionit të planetit dhe proceset që e kanë formësuar atë.



Ju ofron:
Kushte bashkëkohore,
ushqim cilësor dhe të kontrolluar,
staf të kualifikuar.

Ju mirëpresim!



Lagja Perash, Bulevardi Mehmet Pashë Plaku,
Pranë Xhamisë Perash, Shkodër

+355 67 47 39389

1 Staf arsimor cilësor

2 Kushte arsimore sipas standarteve të larta

3 Aktivitete sociale, kulturore dhe sportive

4 Klasa dhe laboratorë të kompletuar

5 Ambiente familjare në konvikt dhe cilësi në ushqim



CIKLI FILLOR

(djem dhe vajza)

NGA KLASA E **1**-RË
DERI NË KLASËN E **5**-TË

“...Sot jua përsosa
fenë tuaj,
e plotësova
dhuntinë Time
ndaj jush
dhe zgjodha
që Islami
të jetë feja juaj...”

(Maide, 3)